

Marrës AV shumëkanalësh

Udhëzimet e përdorimit

Lexoni së pari manualin e konfigurimit të shpejtë që vjen me marrësin. Në këtë mënyrë mund të kuptoni më lehtë lidhjet dhe ciklin e veprimeve të marrësit.

VINI RE

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit, mos e mbulonit hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazeta, mbulesa tavoline, perde etj.

Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të pambrojtura (për shembull qirinj të ndezur).

Mos e instaloni pajisjen në hapësira të kufizuara si p.sh. në raftet e librash apo në mobilie inkaso.

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit ose të goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi pajisje nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëngje, si p.sh. vazo.

Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, futeni njësinë në priza elektrike që mund të arrihen lehtë. Nëse vini re një anomali në njësi, shkëputni menjëherë prizën kryesore nga priza e rrymës së drejtpërdrejtë.

Mos i ekspozoni bateritë ose pajisjet me bateri të instaluar ndaj nxehtësisë së tepruar si p.sh. drita e diellit dhe zjarri.

Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është futur në prizë, edhe nëse vetë njësia është e fiksuar.

Presioni i tepruar i zërit nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.



Ky simbol njofton përdoruesin për sipërfaqe të nxehta, e cila mund të jetë e tillë nëse preket gjatë punës normale.

Kjo pajisje është testuar dhe rezultoi në përputhje me kufijtë e përcaktuar në direktivën për pajtueshmërinë elektromagnetike me kabllot lidhjeje nën 3 metra.

Njoftim për klientët: informacioni i mëposhtëm vlen vetëm për pajisjet e shitura në shtete ku ndiqen direktivat e BE-së.

Ky produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japan. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian do t'i adresohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, drejtoju adresave që jepen në dokumentet e posaçme të shërbimit ose të garancisë.



Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (për Bashkimin Evropian dhe vende të tjera evropiane me sistem të diferencuar grumbullimi)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.



Hedhja e baterive të përdorura (për Bashkimin Evropian dhe vende të tjera evropiane me sisteme të diferencuara grumbullimi)

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketimin tregon se bateria që vjen me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivë ose 0,004% plumb. Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të

mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie.

Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkorporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzoheni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzoheni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura. Për të dhëna më të hollësishme mbi riciklimin e këtij produkti ose të baterisë, kontaktoni me bashkinë, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Breth manualit

- Udhëzimet në manual janë për modelin STR-DA2800ES (marrësi). Kontrolloni numrin e modelit në këndin e djathtë të poshtëm të panelit të përparmë.
- Udhëzimet në manual përshkruajnë kryesisht komandimin e marrësit me anë të telekomandës së dhënë. Mund të përdorni gjithashtu edhe butonat ose çelësat e marrësit nëse kanë emra të njëjtë ose të ngjashëm me ato të telekomandës.

Breth të drejtave të autorit

Marrësi vjen i integruar me Dolby* Digital dhe Pro Logic Surround dhe DTS** Digital Surround System.

* Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby, Pro Logic, Surround EX dhe simboli me dy „D“ janë marka tregtare të Dolby Laboratories.

** Prodhuar me licencë nën patentat amerikane numër: 5,956,674, 5,974,380, 5,978,762, 6,487,535, 6,226,616, 7,212,872, 7,003,467, 7,272,567, 7,668,723, 7,392,195, 7,333,929, 7,548,853 dhe patenta të tjera amerikane dhe të shteteve të tera të marra dhe në pritje. DTS-HD, simboli dhe DTS-HD e simboli bashkë janë marka të regjistruara tregtare dhe DTS-HD Master Audio është markë tregtare e DTS, Inc. Produkti përfshin softuerin. © DTS, Inc. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

HDMI

Marrësi vjen i integruar me teknologji High-Definition Multimedia Interface (HDMI™).

Termet HDMI dhe HDMI High-Definition Multimedia Interface dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të HDMI Licensing LLC në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera.

Lloji i shkrimit (Shin Go R) të instaluar në këtë marrës ofrohet nga MORISAWA & COMPANY LTD. Këta emra janë marka tregtare të MORISAWA & COMPANY LTD. dhe e drejta e autorit për llojin e shkrimit i përket gjithashtu MORISAWA & COMPANY LTD.

iPhone, iPod, iPod classic, iPod nano dhe iPod touch janë marka tregtare të Apple Inc. të regjistruara në SHBA dhe në shtete të tjera.

Të gjitha markat e tjera tregtare dhe të regjistruara tregtare janë të pronarëve përkatës. Në manual nuk përcaktohen markat TM dhe ®.



„Made for iPod“ dhe „Made for iPhone“ do të thonë se aksesori elektronik është krijuar për t'u lidhur posaçërisht e përkatësisht me iPod ose iPhone dhe është certifikuar nga prodhuesi për funksionimin në standardet e performancës së Apple. Apple nuk mban përgjegjësi për përdorimin e kësaj pajisjeje ose pajtueshmërinë e saj me standardet rregullatore dhe të sigurisë. Kini parasysh se përdorimi i këtij aksesori me iPod ose iPhone mund të ndikojë në performancën e lidhjes me valë.



DLNA™, logoja DLNA dhe DLNA CERTIFIED™ janë marka tregtare, marka shërbimi ose marka certifikimi të Digital Living Network Alliance.

Teknologjia e audiokodimit MPEG Layer-3 dhe patentat të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.

„BRAVIA“ Sync është markë tregtare e Sony Corporation.

„x.v.Color“ dhe logoja „x.v.Color“ janë marka tregtare të Sony Corporation.

„PlayStation®“ është markë e regjistruar tregtare e Sony Computer Entertainment Inc.

„AVCHD“ dhe logoja „AVCHD“ janë marka tregtare të Panasonic Corporation dhe Sony Corporation.

Windows Media është markë e regjistruar tregtare ose markë tregtare e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose në shtete të tjera. Produkti përmban teknologji që u nënshtrohen të drejtave të caktuara të pronësisë intelektuale të Microsoft. Ndalohet përdorimi ose shpërndarja

e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencën(at) e duhur(a) nga Microsoft. Zotëruesit e të drejtave të materialeve përdorin teknologji Microsoft PlayReady™ të shfrytëzimit të materialeve për mbrojtjen e pronës së tyre intelektuale, duke përfshirë materialet me të drejta autori. Kjo pajisje përdor teknologji PlayReady në shfrytëzimin e materialeve të mbrojtura me PlayReady dhe/ose me WMDRM. Nëse pajisja nuk arrin të vendosë siç duhet kufizimet mbi përdorimin e materialit, zotëruesit e të drejtave të materialit mund t'i kërkojnë Microsoft t'i heqë pajisjes mundësinë e shfrytëzimit të materialit të mbrojtur me PlayReady. Heqja e mundësisë nuk prek materialet e pambrojtura apo materialet e mbrojtura me teknologji të tjera shfrytëzimi të materialit. Zotëruesit e të drejtave të materialit mund t'ju kërkojnë të përmirësoni PlayReady për të shfrytëzuar materialet e tyre. Nëse refuzoni përmirësimin, nuk do të jeni në gjendje të shfrytëzoni materialet që kanë nevojë për përmirësim.

„WALKMAN“ dhe logoja „WALKMAN“ janë marka të regjistruara tregtare të Sony Corporation.

„Android“ është markë e regjistruar tregtare ose markë tregtare e Google Inc.

InstaPrevue™ është markë tregtare ose markë e regjistruar tregtare e Silicon Image, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera.

Produkti përmban softuer që i nënshtrohet GNU General Public License („GPL“) ose GNU Lesser General Public License („LGPL“). Këto përcaktojnë se klientët kanë të drejtën të blejnë, modifikojnë dhe rishpërndajnë kodin burimor të softuerit në fjalë, sipas kushteve të GPL ose të LGPL.

Për hollësi rreth GPL, LGPL dhe licencave të tjera të softuerit drejtoju „System Settings“ → „Software License“ në menynë „Settings“ të marrësit.

Kodi burimor për softuerin e përdorur në produkt i nënshtrohet GPL dhe LGPL, dhe ofrohet në internet. Për ta shkarkuar, hyni si më poshtë:

URL-ja: <http://www.sony.net/Products/Linux>

Kini parasysh se Sony nuk mund t'u përgjigjet kërkesave të mundshme në lidhje me përmbajtjen e këtij kodi burimor.

Funksionet kryesore të marrësit

Mbështet një sërë lidhjesh dhe formatesh

Funksioni	Përshkrimi	Faqe
7.2 kanale	Marrësi mund të nxjerrë deri në 7.2 kanale. Marrësi mbështet lidhje me dy amplifikatorë të altoparantit të përparmë.	22, 24
Pajtohet me një sërë standardesh	Marrësi mbështet një sërë standardesh audioje, si p.sh. Dolby TrueHD, DTS-HD Master Audio, DSD, PCM lineare shumëkanalëshe, FLAC etj.	20
HDMI (dalje 8 në 2 + dalje zone 1)	Marrësi është i pajisur me 8 fole hyrëse HDMI (prej të cilave dy, HDMI IN 2 dhe IN 3, janë fole „for AUDIO“ që marrin parasysht cilësinë e zërit) në panelin e pasmë. Mund të lidhni një sërë pajisjesh me anë të lidhjes HDMI.	26, 28, 30, 31, 35
	Marrësi pajtohet me një sërë standardesh HDMI si p.sh. Deep Color, „x.v.Color“ ose 4K* dhe transmetim 3D Audio Return Channel (ARC) etj. * Foletë HDMI IN 1 dhe IN 2 mbështesin transmetimin 4K.	34, 72
	4K Marrësi mund të nxjerrë sinjale 4K nga foletë dalëse HDMI.	19, 34
	Fast View Ju mund të zgjidhni një mënyrë hyrëse HDMI më të shpejtë se zgjedhja normale (Fast View). Foletë HDMI IN 1, IN 2, IN 3 dhe IN 4 mbështesin funksionin Fast View.	96
	Control for HDMI Marrësin dhe pajisjet e tjera mund t'i komandoni të ndërlidhura me anë të funksionit të komandimit për HDMI.	68, 96
Pamje paraprake për HDMI	Marrësi mundëson shikimin e një pamjeje paraprake figurë-në-figurë të sinjalit hyrës HDMI të lidhur në marrës. Dritaret e pamjes paraprake do të shfaqen vetëm për hyrjet HDMI IN 1/IN 2/ IN 3/IN 4. Çdo pamje paraprake të sinjalit hyrës HDMI mund ta zgjidhni me anë të telekomandës. (Funksioni mundësohet nga teknologjia Silicon Image InstaPrevue™.)	75
Rrjet	Marrësi është i pajisur me katër fole LAN që kanë funksione ndërçelësi rrjeti.	39
	Marrësi mbështet videotransmetime nga interneti.	51
	Marrësi mundëson luajtjen e materialeve në rrjete shtëpie me anë të funksionit që mbështet DLNA për rrjete shtëpie.	49
USB	Fole USB e vlefshme për iPod/iPhone Mund të luani lehtësisht materiale për iPod/iPhone nëpërmjet marrësit, me anë të lidhjes USB.	48
	Mund të luani lehtësisht materiale të pajisjeve USB/WALKMAN nëpërmjet marrësit, me anë të lidhjes USB.	47

Funksioni	Përshkrimi	Faqe
Shumëzonësh	Përveç dhomës kryesore, në dhomat e tjera mund të luani muzikë dhe video të ndryshme nga dhoma kryesore.	62
	Mund të nxirrni sinjale HDMI nga foletë HDMI IN drejt folesë HDMI ZONE 2 OUT.	19, 62, 65

Cilësi më e mirë figure dhe zëri

Funksioni	Përshkrimi	Faqe
Konvertim për zmadhim figure	Marrësi zmadhon ose zvogëlon rezolucionin e figurës në sinjalet video analoge. Sinjalet mund të zmadhohen deri në 4k me anë të folesë dalëse HDMI. Marrësi gjithashtu zmadhon ose zvogëlon rezolucionin e figurës së sinjaleve video analoge për zonën 2.	19
Funksioni Digital Cinema Auto Calibration (D.C.A.C.)	Marrësi është i pajisur me funksion Digital Cinema Auto Calibration (D.C.A.C.). Ky funksion mundëson kalibrimin dhe caktimin automatik të parametrave të zërit për audio optimale.	85, 86
Fushat zanore	Mund të zgjidhni nga një sërë modalitetesh fushash zanore sipas lidhjeve të altoparlantëve ose të burimeve hyrëse të zërit. Marrësi vjen gjithashtu me opsionin e mëposhtëm zanor: – Tri modalitete për riprodhimin e veçorive zanore të sallave të mirënjohura muzikore: „Berlin Philharmonic Hall“, „Concertgebouw Amsterdam“ ose „Musikverein Vienna“.	57, 59
Ngritja e zërit të altoparlantit qendror në lartësinë e duhur (Center Speaker Lift Up)	Me përdorimin e altoparlantëve lart përballë, mund të ngrini në ekran zërin e altoparlantit qendror në nivelin e duhur. Ky funksion (Center Speaker Lift Up) mundëson dëgjim me zë natyral dhe pa sjellë shqetësime.	87
Riprodhim cilësor i skedarëve audio të kompresuar	Skedarët audio të kompresuar mund t'i luani në cilësi të lartë me anë të funksionit D.L.L. (Digital Legato Linear).	89

Funksione të dobishme

Funksioni	Përshkrimi	Faqe
Veprime të lehta dhe me hapje të shpejtë	Marrësi është i pajisur me GUI (Graphical User Interface). Marrësin mund ta komandoni në mënyrë intuitive me anë të menysë që shfaqet në ekranin e televizorit.	44
	Cilësimet bazë të marrësit mund t'i caktoni me lehtësi me anë të Easy Setup.	41
	Bashkë me marrësin jepet edhe një telekomandë për përdorimin e pajisjeve të lidhura dhe funksionin shumëzonësh.	15
	Cilësimet e ndryshme të marrësit mund t'i hapni të gjitha njëherësh me shtypjen e butonit EASY AUTOMATION.	76
Funksione praktike	Funksioni Sound Optimizer optimizon nxjerrjen e zërit sipas nivelit të volumnit.	60
	Funksioni A/V Sync rregullon intervalin kohor midis daljes së zërit dhe figurës.	91
	Funksioni Pass Through nxjerr sinjalet HDMI drejt televizorit, edhe nëse marrësi është në modalitet pritjeje.	71

Të tjera

Funksioni	Përshkrimi	Faqe
Funksioni promjedisor	Funksioni Auto Standby kalon automatikisht marrësin në modalitet pritjeje nëse nuk e përdorni për një kohë të caktuar ose nëse nuk ka hyrje sinjali drejt marrësit.	101
Të tjera të dobishme	Marrësin mund ta komandoni me anë celulari inteligjent me aplikacion „ES Remote“.* * Mbështet celularë iPod touch/iPhone dhe Android	76

Pasqyra e lëndës

Funksionet kryesore të marrësit	5
Përshkrimi dhe vendndodhja e pjesëve	10

Fillimi

Lexoni sa më poshtë përpara se të lidhni pajisjet e ndryshme	18
1: Instalimi i altoparlantëve	22
2: Lidhja e monitorit	26
3: Lidhja e pajisjeve video	28
4: Lidhja e pajisjeve audio	35
5: Lidhja me rrjetin	39
6: Përgatitja e marrësit dhe e telekomandës	40
7: Konfigurimi i marrësit me anë të Easy Setup	41
8: Konfigurimi i pajisjes së lidhur	43
9: Përgatitja e kompjuterit për përdorim si server	44
Udhëzim për komandat që shfaqen në ekran	44

Përjetimi audiovizual

Përjetimi audiovizual nga pajisjet e lidhura	46
Pajisje USB/WALKMAN	47
iPod/iPhone	48
Home Network (DLNA)	49
Video nga interneti	51
FM/AM	52

Shijimi i efekteve zanore

Zgjedhja e fushave zanore	56
Përdorimi i funksionit Sound Optimizer	60
Rregullimi i balancuesit	61

Përdorimi i funksioneve shumëzonëshe

Çfarë mund të bëni me funksionin shumëzonësh	62
Kryerja e një lidhjeje shumëzonëshe	62
Konfigurimi i altoparlantëve në zonën 2	65
Konfigurimi i daljes HDMI në zonën 2	65
Përdorimi i marrësit nga një zonë tjetër (Veprimet për ZONE 2)	66

Përdorimi i veçorive të tjera

Përdorimi i veçorive të „BRAVIA“ Sync	68
Ndërrimi i monitorëve që nxjerrin sinjale videoje HDMI	71
Nxjerrja e sinjaleve HDMI edhe kur marrësi është në modalitet pritjeje (Pass Through)	71
Kalimi mes audios dixhitale dhe analoge	72
Përdorimi i foleve të tjera të hyrjes video/audio	73
Pamje paraprake për HDMI	75
Përdorimi i marrësit me anë të një celulari smartphone	76
Ruajtja e cilësimeve të ndryshme të marrësit dhe rikthimi i njëkohshëm i të gjitha atyre cilësimeve (Easy Automation)	76
Përdorimi i kohëmatësit të fjetjes	78
Regjistrimi me anë të marrësit	78
Ndërrimi i modalitetit të komandës së marrësit dhe telekomandës	78
Përdorimi i një lidhjeje me dy amplifikatorë	80
Kthimi në cilësimet e parazgjedhura të fabrikës	81

Rregullimi i cilësimeve

Përdorimi i menysë së cilësimeve	82
Easy Setup	85
Speaker Settings	85
Audio Settings	89
Video Settings	92
HDMI Settings	95
Input Settings	97
Network Settings	98
Internet Services Settings	99
Zone Settings	100
System Settings	101
Network Update	102
Përdorimi pa përdorur GUI	103

Përdorimi i telekomandës


Përdorimi i pajisjes me anë të telekomandës	110
Fikja e të gjitha pajisjeve të lidhura (SYSTEM STANDBY)	111
Programimi i telekomandës	111
Pastrimi i memories së telekomandës me shumë funksione	115

Informacion shtesë

Masat paraprake	116
Zgjidhja e problemeve	117
Specifikimet	128
Indeksi	132

Përshkrimi dhe vendndodhja e pjesëve

Paneli i përparmë



1 I/ON/STANDBY

Fik ose ndez marrësin.

Llamba mbi buton ndizet si më poshtë:

I gjelbër: Marrësi është i ndezur;

Portokalli: Marrësi është në modalitet gatishmërie; dhe

– „Control for HDMI“ (faqe 96) ose „Network Standby“ (faqe 98) është caktuar në „On“.

– „Pass Through“ (faqe 96) është caktuar në „On“ ose „Auto“.

– Marrësi në zonën 2 është i ndezur.

Llamba fiket kur marrësi është në modalitet gatishmërie dhe nëse cilësimet e mësipërme janë joaktive.

2 INPUT SELECTOR (faqe 46) INPUT MODE (faqe 72)

3 Sensori i telekomandës

Merr sinjal nga telekomanda.

4 Dritarja në ekran (faqe 11)

5 DISPLAY MODE (faqe 109)

6 DIMMER

Shtypni vazhdimisht DIMMER për të rregulluar ndriçimin e dritares së ekranit.

7 MASTER VOLUME (faqe 46)

8 SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) (faqe 42)

9 Foleja PHONES

Lidhet me kufjet.

10 MEMORY/ENTER, TUNING MODE, TONE MODE, TONE/TUNING +/-

Shtypni vazhdimisht TONE MODE për të zgjedhur altoparlantin dhe nivelin. Më pas shtypni TONE/TUNING +/- për të rregulluar nivelin e frekuencave të ulëta/ të larta të altoparlantit.

11 2CH/A.DIRECT, A.F.D., MOVIE/ HD-D.C.S., MUSIC (faqe 56, 57)


12 Foleja AUTO CAL MIC (faqe 85)

Lidhni në këtë fole mikrofonin e dhënë të optimizuesit për „Auto Calibration“.

13 iPod/iPhone (porta (USB) dhe foleja VIDEO IN) (faqe 33, 47, 48)

14 Foletë VIDEO 2 IN (faqe 33)

Treguesit në ekran



1 SW

Ndizet kur lidhet(n) altoparlanti(ët) dhe nga foleja(të) SUBWOOFER del sinjali audio.

2 ZONE 2 (faqe 62)

3 Treguesi INPUT

Ndizet për të treguar sinjalin aktual hyrës.

HDMI

COAX

OPT

ARC (faqe 72)

4 Treguesi Dolby Digital Surround

Ndizet me një nga treguesit e posaçëm kur marrësi dekodon sinjalet përkatëse të formatit Dolby Digital.

DD

Dolby Digital

DD+

Dolby Digital Plus

DD EX

Dolby Digital Surround EX

5 DD TrueHD

Ndizet kur marrësi dekodon Dolby TrueHD.

6 HDMI OUT A/B (faqe 71)

7 SLEEP (faqe 78)

8 Treguesi i kanalit të luajtjes

Tregon altoparantit që është përcaktuar për të nxjerrë zërin. Tregon në ç'mënyrë marrësi ul apo ngre numrin e kanaleve të zërit burim, sipas cilësimeve të altoparantit.

L

Përballë majtas

R

Përballë djathtas

C

Qendër

LH

Majtas lart

RH

Djathtas lart

SL

Shumëkanalësh majtas

SR

Shumëkanalësh djathtas

SBL

Rrethues i pasmë majtas

SBR

Rrethues i pasmë djathtas

SB

Rrethues i pasmë

Shembull:

Formati i regjistrimit: 5.1

Motivi i altoparlantëve: 3/0.1

Fusha zanore: A.F.D. Auto

SW

L C R

9 LFE

Ndizet kur sinjalet hyrëse që po luhen përbajnë kanal LFE (Low Frequency Effects).

10 Treguesi Dolby Pro Logic

Ndizet me një nga treguesit e posaçëm kur marrësi bën përpunim Dolby Pro Logic. Kjo teknologji dekodimi matricë e zërit rrethues mund të përforcojë sinjalet hyrëse.

□□PL

Dolby Pro Logic

□□PLII

Dolby Pro Logic II

□□PLIIx

Dolby Pro Logic IIx

□□PLIiz

Dolby Pro Logic IIz

11 Treguesi i sistemit të altoparlantëve (faqe 42)

12 BI-AMP (faqe 80)

13 D.L.L. (faqe 89)

14 D.C.A.C. (faqe 85)

Ndizet kur zbatohen rezultatet e matjes së funksionit „Auto Calibration“.

15 EQ

Ndizet kur aktivizohet balancuesi.

16 RDS (faqe 55)

Marrja e stacionit të të dhënave radiofonike

17 S.OPT.

Ndizet kur aktivizohet funksioni i optimizuesit të zërit (faqe 60).

18 MEM

Ndizet kur aktivizohet funksioni i paracaktuar i memories.

19 Treguesi DTS-HD

Ndizet kur marrësi dekodon DTS-HD.

DTS-HD

Ndizet në mënyrë të vazhdueshme me një nga treguesit e mëposhtëm.

MSTR

DTS-HD Master Audio

HI RES

DTS-HD High Resolution Audio

20 NEO:6

Ndizet kur aktivizohet dekodimi DTS Neo:6 Cinema/Music.

21 D.RANGE

Ndizet kur aktivizohet kompresimi dinamik i gamës.

22 A.P.M. (faqe 86)

Ndizet kur aktivizohet funksioni A.P.M. (Automatic Phase Matching).

23 Treguesi i sintonizimit

Ndizet kur marrësi sintonizohet në një stacion radioje.

ST

Marrja stereo

24 Treguesi DTS(-ES)

Ndizet kur ka marrje të sinjaleve DTS ose DTS-ES.

DTS

Ndizet kur marrësi dekodon sinjale DTS.

DTS-ES

Ndizet me një nga treguesit e mëposhtëm, në varësi të formatit të dekodimit të sinjalit hyrës.


96/24

Dekodim DTS 96/24 (96 kHz/24 bit)

25 LPCM

Ndizet kur ka marrje të sinjaleve PCM (Pulse Code Modulation) lineare.

Paneli i pasmë



1 Seksioni DIGITAL INPUT/OUTPUT



Foletë OPTICAL IN
(faqe 26, 30, 31)



Foletë COAXIAL IN
(faqe 29, 36)



Foletë HDMI IN/OUT*
(faqe 26, 28, 30, 31)

2 Seksioni ANTENNA



Foleja AM ANTENNA
(faqe 38)




Foleja FM ANTENNA
(faqe 38)

3 Portat LAN (ndërçelësa) (faqe 39)



4 Foleja RS232C



Përdoret për mirëmbajtje dhe shërbim.

5 Foletë e komandimit për Sony dhe pajisje të tjera të jashtme



Foletë IR REMOTE IN/OUT
(faqe 62)

Lidhni një repetitor infra të kuq (nuk jepet) me IN për të përdorur funksionin shumëzonësh.

Lidhni IR blaster (nuk jepet) te OUT. Hyrja e sinjaleve në IN do të nxirret nga OUT.



Foletë TRIGGER OUT
(faqe 100)

Lidhni për të kyçur gjatë ndezjes/fikjes furnizimin me energji të pajisjeve të tjera të pajtueshme 12V TRIGGER.

6 VIDEO/AUDIO Seksioni INPUT/ OUTPUT (faqe 26, 29, 30, 31, 32, 36)



Foletë AUDIO IN/OUT



Foletë VIDEO IN/OUT*



Foletë AUDIO OUT

Foleja

VIDEO OUT (faqe 62)



Foletë SUBWOOFER

Lidheni me nën-vufer të jashtëm.


7 COMPONENT VIDEO Seksioni INPUT/ OUTPUT (faqe 26, 29, 31)



Foletë Y, P_B, P_R IN/OUT*



8 Seksioni SPEAKERS (faqe 24)



* Duhet të lidhni folenë HDMI OUT ose MONITOR OUT me televizorin për të parë figurën e zgjedhur hyrëse (faqe 26).

Telekomanda (RM-AAP082)


Përdorni telekomandën e dhënë për të komanduar marrësin dhe pajisjet e tjera.

Shënim

Mos e ekspozoni sensorin e telekomandës ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit ose aparaturave që lëshojnë dritë. Përndryshe mund të shkaktoni defekt.

Këshillë

Kur marrësi nuk i përgjigjet më telekomandës, zëvendësoni të gjitha bateritë me të reja.



1 I/⏻ (ndezur/në gatishmëri)

Fik ose ndez marrësin.

2 AV I/⏻ (ndezur/në gatishmëri)

Ndez ose fik pajisjet video/audio të caktuara për t'u komanduar nga telekomanda.

3 ZONE (faqe 62)

4 AMP

Aktivizon funksionimin e marrësit për zonën kryesore.

5 → (Zgjedhja e hyrjes)

Shtypni TV (22) dhe shtypni → (zgjedhja e hyrjes) për të zgjedhur sinjalin hyrës (televizor ose video).

⏻ (Fiksime i tekstit)

Në modalitet teksti: Fikson faqen aktuale.

6 ≡ (Guida)

Shtypni SHIFT (23), pastaj shtypni ≡ (Guida) për të shfaqur guidën e programeve në ekran.

7 D.TUNING (faqe 53)

Shtypni SHIFT (23) dhe shtypni D.TUNING për të hyrë në modalitet sintonizimi të drejtpërdrejtë.

8 ENT/MEM

Shtypni SHIFT (23) dhe shtypni ENT/MEM për të futur vlerën ose për të gjurmuar me anë të butonave numerike (25), ose shtypni ENT/MEM dhe shtypni butonat numerike (25) për të zgjedhur një numër të paracaktuar të cili është ruajtur stacioni gjatë përdorimit të sintonizuesit.

9 SEN

Hap faqen kryesore të Sony Entertainment Network (SEN), një shërbim rrjeti që ofrohet nga Sony.

10 WATCH, LISTEN (faqe 46)

11 SOUND FIELD +/- (faqe 56, 57, 59)

12 Butonat me ngjyra

Punon sipas guidës në ekranin e televizorit.

13 AMP MENU (faqe 103)

14

Shtypni     për të zgjedhur artikujt e menysë. Më pas shtypni  për të futur zgjedhjen.

15 TOOLS/OPTIONS (faqe 45, 52, 55)

Shfaq dhe zgjedh artikuj nga menya e opsioneve.

16 HOME (faqe 45)

Shfaq menyë kryesore në ekranin e televizorit.

17 1), 1), 1), 1) 2), 1)

Shtypni butonat për të komanduar luajtësit për DVD, Blu-ray Disc, CD, MD, kaseta dhe pajisjet e lidhura në portën  (USB) ose në rrjet, ose pajisje për video nga interneti etj.

TUNING +/-

Shtypni SHIFT () dhe shtypni TUNING +/- për të zgjedhur stacionin.

PREVIEW (HDMI) (faqe 75)

Shtypni PREVIEW (HDMI) për të hapur ekranet figurë-në-figurë për shikim paraprak të sinjalit hyrës nga katër foletë HDMI IN.

Shtypni   për

- luajtjen sërish të skenës së fundit ose për të përshpejtuar përpara skenën aktuale.
- kapërcimin në albumin tjetër ose të mëparshëm kur përdorni një iPod/ iPhone.

18 PRESET + 2)/–

Zgjedh stacionet e paracaktuara.

PROG + 2)/–

Shtypni TV () dhe shtypni PROG +/- për të komanduar sintonizuesin televiziv, satelitor etj.

2)/

Në modalitet teksti: Zgjedh faqen para ose prapa.

19 EASY AUTOMATION 1, 2 (faqe 76)

(Tekst)

Shtypni TV () dhe shtypni  (Tekst) për të shfaqur informacione për tekstin.

20 RM SET UP (faqe 78)

21 FAVORITES (faqe 51)

22 TV

Ndërron funksionin e butonit të telekomandës me atë me ngjyrë të verdhë për të aktivizuar përdorimin e televizorit.

23 SHIFT

Ndërron funksionin e butonit të telekomandës për të aktivizuar butonat me ngjyrë rozë.

24 Butonat hyrës

Shtypni një nga butonat për të zgjedhur pajisjet që dëshironi të përdorni. Marrësi ndizet kur shtypni një nga butonat e hyrjes.

25 Butonat numerikë

Shtypni SHIFT () dhe shtypni butonat numerikë për të futur numra. Shtypni butonat numerikë për të zgjedhur numrat e kanaleve të televizorit.

26 -/--

Shtypni SHIFT () dhe shtypni -/-- për – të zgjedhur numrat mbi 10 të këngëve në luajtësit CD, DVD, Blu-ray Disc ose MD.
– zgjedhur numrat mbi 10 të kanaleve televizive, satelitore ose të videos.

27 SOUND OPTIMIZER (faqe 60)

28 HDMI OUTPUT (faqe 71)

29 DISPLAY

Shfaq pultin e komandave në ekranin e televizorit gjatë luajtjes së materialeve nga video interneti apo rrjete shtëpie.

, (Informacion, zbulim i tekstit)

Shfaq informacione si p.sh. numri aktual i kanalit dhe modaliteti i ekranit. Në modalitet teksti: Zbulon informacione të fshehura (p.sh. përgjigje ndaj gjëzave).

30 RETURN/EXIT

Kthehet në menyë e mëparshme ose del nga menya.

31 **(Volume) +/- (faqë 46)**

⌂ (Heshtja) (faqë 46)

Pas shtypjes së TV (**22**), mund të rregulloni gjithashtu volumnin e televizorit dhe të çaktivizoni përkohësisht zërin e televizorit.

32 **SLEEP (faqë 78)**

TOP MENU

Hap ose mbyll menynë kryesore të BD-ROM-it ose të DVD-së.

AUDIO

Shtypni SHIFT (**23**) dhe shtypni AUDIO për të zgjedhur formatin audio/këngën.

33 **DIMMER**

Rregullon ndriçimin e dritares së ekranit.

POP UP/MENU

Hap ose mbyll menynë e posaçme të BD-ROM-it ose menynë e DVD-së.

SUBTITLE

Shtypni SHIFT (**23**) dhe shtypni SUBTITLE për të zgjedhur gjuhën e titrave kur regjistrohen titrat shumëgjuhëshe në BD-ROM/ DVD VIDEO.

¹⁾Shikoni pasqyrën në faqe 110 për informacione rreth butonave që mund të përdorni për të komanduar secilin lloj pajisjeje.

²⁾Butonat kanë një pikë të prekshme (5/VIDEO 2, , PRESET +). Përdoreni si pikë reference për përdorimin.

Shënim

Shpjegimet e mësipërme shërbejnë si shembuj.

Lexoni sa më poshtë përpara se të lidhni pajisjet e ndryshme

Përpara lidhjes së kablllove, sigurohuni të shkëputni kordonin elektrik (rrjeti elektrik).

Instalimi i altoparlantëve

Shihni „1: Instalimi i altoparlantëve“ (faqe 22).

Lidhja e monitorit


Shihni „2: Lidhja e monitorit“ (faqe 26).

Lidhja e pajisjeve video

Cilësia e figurës varet nga foleja ku bëhet lidhja. Shihni ilustrimin në të djathtë. Zgjidhni lidhjen sipas foleve të pajisjeve.

Marrësi ka funksion konvertimi të videos. Për hollësi shihni „Funksion për konvertimin e sinjaleve video“ (faqe 19).

Shihni „3: Lidhja e pajisjeve video“ (faqe 28).



Figurë e cilësisë së lartë

Lidhja e pajisjeve audio

Shihni „4: Lidhja e pajisjeve audio“ (faqe 35).

Përgatitja e marrësit dhe e telekomandës

Shihni „6: Përgatitja e marrësit dhe e telekomandës“ (faqe 40).

Konfigurimi i marrësit

Shihni „7: Konfigurimi i marrësit me anë të Easy Setup“ (faqe 41).

Konfigurimi i daljes së zërit në pajisjet e lidhura

Shihni „8: Konfigurimi i pajisjes së lidhur“ (faqe 43).

Për hollësi në lidhje shumëzonëshe shihni faqe 62.

Për hollësi rreth lidhjes me dy amplifikatorë shihni faqe 80.

Funksion për konvertimin e sinjaleve video

Marrësi është i pajisur me funksion për konvertimin e sinjaleve video.

- Sinjalet video të përbërëa mund të nxirren si video HDMI dhe si sinjale video komponent.
- Sinjalet video komponent mund të nxirren si video HDMI dhe sinjale video.

Si cilësim i paracaktuar nga fabrika, hyrja e sinjaleve video nga pajisjet e lidhura nxirret në foletë HDMI OUT ose MONITOR OUT siç tregohet në tabelën më poshtë.

Rekomandojmë ta caktoni funksionin e konvertimit të videos në përputhje me rezolucionin e monitorit që po përdorni.

Për hollësi në lidhje me funksionin e konvertimit të videos shihni „Video Settings“ (faqe 92).

Foleja INPUT \ Foleja OUTPUT	Funksion			
	HDMI OUT A/B (deri në 4K)	COMPONENT VIDEO MONITOR OUT (deri në 1080i)	MONITOR VIDEO OUT	VIDEO 1 OUT
HDMI IN	○	–	–	–
VIDEO IN	○*	○**	○**	○
COMPONENT VIDEO IN	○*	○**	○**	–

○ : Nxirren sinjalet video.

– : Nuk nxirren sinjalet video.

* Kur zgjidhet „Auto“ në „Resolution“, aktivizohet 4K zmadhimi i rezolucionit.

Për sinjale 4K, duhet lidhur monitor që mbështet 4K.

** Sinjalet video mund të mos nxirren, në varësi të cilësimit në „Resolution“ (faqe 92).

Shënim për konvertimin e sinjaleve video

Sinjalet video për të cilat është konvertuar rezolucioni mund të mos nxirren njëkohësisht nga foletë COMPONENT VIDEO MONITOR OUT ose HDMI OUT. Nëse i lidhni pajisjes dhe në foletë COMPONENT VIDEO MONITOR OUT dhe në foletë HDMI OUT, përparësi ka dalja nga foletë HDMI OUT.

Shënim për daljen e videos HDMI të Zonës 2

Vetëm sinjalet hyrëse HDMI IN mund të nxirren nga foleja HDMI ZONE 2 OUT.

Për të shfaqur titra ndihmëse (CC)

Caktoni „Resolution“ në „Direct“ në menynë Video Settings kur merrni sinjal që mbështet titra ndihmëse (CC).

Përdorni të njëjtat lloje kabllosh për sinjalet hyrëse/dalëse.

Për të lidhur pajisje regjistrimi

Kur regjistroni, lidhni pajisjen e regjistrimit në foletë VIDEO OUT të marrësit. Lidhni kabllosh për sinjalet hyrëse dhe dalëse në fole të të njëjtit lloj, pasi foletë VIDEO OUT nuk kanë funksion konvertimi me rritje rezolucioni. Foletë HDMI OUT dhe MONITOR OUT nuk mund të përdoren për regjistrim.

Formatet dixhitale të audios të mbështetura nga marrësi

Formatet dixhitale të audios që mund të dekodojë marrësi varen nga foletë hyrëse të audios në pajisjet e lidhura.

Marrësi mbështet formatet e mëposhtme audio.

Lidhja midis pajisjeve luajtëse dhe marrësit

Formati audio	Numri maksimal i kanaleve	COAXIAL/ OPTICAL	HDMI
Dolby Digital 	5.1-kanalësh	○	○
Dolby Digital EX 	6.1-kanalësh	○	○
Dolby Digital Plus* 	7.1-kanalësh	–	○
Dolby TrueHD* 	7.1-kanalësh	–	○
DTS 	5.1-kanalësh	○	○
DTS-ES 	6.1-kanalësh	○	○
DTS 96/24 	5.1-kanalësh	○	○
DTS-HD High Resolution Audio* 	7.1-kanalësh	–	○
DTS-HD Master Audio* 	7.1-kanalësh	–	○
DSD* 	5.1-kanalësh	–	○
PCM lineare shumëkanalëshe*	7.1-kanalësh	–	○

* Sinjalet audio nxirren në format tjetër nëse pajisjet luajtëse nuk përkojnë me formatin. Për hollësi, drejtojeni udhëzimeve të përdorimit të pajisjeve luajtëse.

Lloji i materialit	Formati i skedarit	Prapashtesat
Muzikë	WAV ⁶⁾	„wav“
	WMA ^{1) 2) 5)}	„wma“
	MP3	„mp3“
	AAC ^{1) 2) 5)}	„m4a“
	FLAC ⁶⁾	„flac“
Video	MPEG-1 Video/PS ^{1) 2)} MPEG-2 Video/PS, TS ^{1) 3)}	„mpg“, „mpeg“, „m2ts“, „mts“
	MPEG-4 AVC ^{1) 2)}	„mkv“, „mp4“, „m4v“, „m2ts“, „mts“
	WMV9 ^{1) 2)}	„wmv“, „asf“
	AVCHD ²⁾	4)
	Xvid	„avi“
Foto	JPEG	„jpg“, „jpeg“, „mpo“
	PNG	„png“
	GIF	„gif“

- 1) Marrësi nuk luan skedarë të koduar si p.sh. DRM.
- 2) Marrësi mund të mos e luajë një skedar të këtij formati në server DLNA.
- 3) Marrësi mund të luajë vetëm video në definicion standard në server DLNA.
- 4) Marrësi luan skedarë AVCHD që janë regjistruar me një kamera dixhitale video, etj.
- 5) Marrësi nuk mund të luajë skedarë të enkriptuar si p.sh. skedarë me ngjeshje pa humbje cilësie.
- 6) Frekuenca e pajtueshme e modulimit/numri i biteve: Maksimumi 192 kHz/24 bit


Shënime

- Disa skedarë mund të mos luhen në varësi të formatit të skedarit, kodimit të skedarit, kushteve të regjistrimit ose kushteve të serverit DLNA.
- Disa skedarë të redaktuar në kompjuter mund të mos luhen.
- Marrësi mund të njohë skedarët ose dosjet e mëposhtme në pajisje USB:
 - deri në dosje në nënrenditjen e 3-të
 - deri në 500 skedarë në një nënrenditje
- Marrësi mund të njohë skedarët apo dosjet e mëposhtme të ruajtura në server DLNA:
 - deri në dosje në nënrenditjen e 18-të
 - deri në 999 skedarë në një nënrenditje
- Në lidhje me formatet e përcaktuara në udhëzimet për DLNA, serverit nuk i kërkohet të ofrojë materiale të cilave u është shtuar siç duhet informacioni i formatit të përcaktuar në udhëzimet për DLNA.

1: Instalimi i altoparlantëve

Marrësi mundëson përdorimin e fonisë deri në 7.2-kanalëshe (7 altoparlantë dhe dy nën-vufer).

Shembuj konfigurimesh të sistemit të fonisë



Foni 7.1-kanalëshe me altoparlantë të pasmë rrethues

Mund të përjetoni riprodhim të besnikërisë së lartë të DVD-ve ose audio të regjistruar me softuer nga Blu-ray Disc në format 6.1-kanalësh ose 7.1-kanalësh.

- A** Altoparlanti majtas i përparmë
- B** Altoparlanti djathtas i përparmë
- C** Altoparlanti qendror
- D** Altoparlanti majtas rrethues
- E** Altoparlanti djathtas rrethues
- F** Altoparlanti i pasmë majtas rrethues
- G** Altoparlanti i pasmë djathtas rrethues
- J** Nën-vuferi

Foni 7.1-kanalëshe me altoparlantë të lartë të përparmë

Mund të shijoni efekte zanore vertikale (p.sh. modalitet Pro Logic IIz).

- A** Altoparlanti majtas i përparmë
- B** Altoparlanti i përparmë djathtas
- C** Altoparlanti qendror
- D** Altoparlanti majtas rrethues
- E** Altoparlanti djathtas rrethues
- H** Altoparlanti lart majtas
- I** Altoparlanti lart djathtas
- J** Nën-vuferi

Foni 5.1-kanalëshe


Për të shijuar në tërësi audio rrethuese shumëkanalëshe kinemaje duhen pesë altoparlantë (dy të përparmë, një qendror dhe dy shumëkanalësh rrethues) dhe një nën-vufer (foni 5.1-kanalëshe).

- A** Altoparlanti majtas i përparmë
- B** Altoparlanti djathtas i përparmë
- C** Altoparlanti qendror
- D** Altoparlanti majtas rrethues
- E** Altoparlanti djathtas rrethues
- J** Nën-vuferi


Pozicionimi i rekomanduar i altoparlantëve

Foni 7-kanalëshe

- Këndi **A** që tregohet në figurë duhet të jetë njësoj.




- Nëse nuk mund t'i vendosni altoparlantët në këndin optimal, ndajini siç duhet altoparlantët rrethues dhe altoparlantët e pasmë rrethues dhe sistemojini në mënyrë sa më simetrike të jetë e mundur.
- Instaloni altoparlantët e lartë të përparmë në të njëjtin kënd me të altoparlantëve të përparmë. Pozicioni duhet të jetë në lartësinë apo mbi lartësinë e zgjatimit të diagonales së ekranit të televizorit apo të monitorit.



Foni 6-kanalëshe

- Vendoseni altoparlantin e pasmë rrethues mbrapa vendit ku uleni.




Këshillë

Duke qenë se nën-vuferi nuk nxjerr sinjale tepër orientuese, mund ta vendosni ku të dëshironi.

Lidhja e altoparlantëve

Përpara lidhjes së kablove, sigurohuni të shkëputni kordonin elektrik (rrjeti elektrik).



- A** Kablo audioje mono (nuk jepet)
- B** Kablo altoparlantësh (nuk jepet)

- A** Altoparlanti i përparmë A (L)
- B** Altoparlanti i përparmë A (R)
- C** Altoparlanti qendror
- D** Altoparlanti rrethues (L)
- D** Altoparlanti rrethues (R)
- F** Altoparlanti i pasmë rrethues (L)²⁾
- G** Altoparlanti i pasmë rrethues (R)²⁾
- H** Altoparlanti lart i përparmë (L)³⁾
- I** Altoparlanti lart i përparmë (R)³⁾
- J** Nën-vuferi⁴⁾

¹⁾ Kur nuk përdorni altoparlantë të pasmë rrethues: Nëse keni foni tjetër, lidhjeni me terminalet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2. Mund të zgjidhni sistemin e altoparlantëve të përparmë që po përdorni me SPEAKERS në panelin e përparmë (faqe 10).

²⁾ Nëse lidhni vetëm një altoparlant të pasmë rrethues, lidhjeni me terminalet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 L.

³⁾ Nëse përdorni altoparlantët të përparmë të lartë, lidhjeni me terminalet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2.

- 4) Kur lidhni nën-vufer me funksion pritjeje automatike, çaktivizohen funksionin kur shikoni filma. Nëse është aktiv, funksioni i gatishmërisë automatike të nën-vuferit do të kalojë automatikisht në modalitet gatishmërie në varësi të nivelit të sinjalit që dërgohet te nën-vuferi dhe mund të mos ketë dalje zëri.
Te marrësi mund të lidhni dy nën-vufer.
Të njëjtat sinjale nxirren nga secila fole e SUBWOOFER.

Lidhja ZONE 2


Vetëm nëse nuk përdorni altoparlantë të pasmë rrethues dhe altoparlantë të përparmë të lartë, mund të vendosni terminalet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 L dhe R në altoparlantët e zonës 2. Vendosni terminalet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 në „Zone2 Speakers“ në „Speaker Connection“ në menynë Speaker Settings (faqe 86). Shihni „Përdorimi i funksioneve shumëzonëshe“ (faqe 62) për hollësi rreth lidhjeve dhe përdorimit në zonën 2.

Lidhja e altoparlantit të përparmë B

Kur nuk përdorni altoparlantë të pasmë rrethues dhe altoparlantë të përparmë të lartë, mund të caktoni terminalet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 L dhe R te altoparlanti i përparmë B. Vendosni terminalet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 në „Front B“ në „Speaker Connection“ në menynë Speaker Settings (faqe 86). Mund të zgjidhni altoparlantët e përparmë me SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) në pjesën e përparme të marrësit.

2: Lidhja e monitorit

Mund të shihni figurën e zgjedhur hyrëse kur lidhni foletë HDMI OUT ose MONITOR OUT në televizor. Marrësin mund ta komandoni me anë të GUI (Graphical User Interface) që shfaqet në ekran.



Nuk është e nevojshme të lidhen të gjitha kabllot. Lidhni kabllot sipas foleve të pajisjeve.

- A** Kablo dixhitale optike (nuk jepet)
- B** Kablo audio (nuk jepet)
- C** Kablo video (nuk jepet)
- D** Kablo video Component (nuk jepet)

- E** Kablo HDMI (nuk jepet)
Rekomandojmë të përdorni kablo Sony HDMI.

TV type	Audio Return Channel (ARC)	Kabllloja e kërkuar (kordoni)	
		Video	Audio
Me HDMI	I pajtueshëm*	E	–
	I papajtueshëm	E	A ose B **
Pa HDMI	–	D ose C	A ose B **

* Zërin e televizorit mund ta nxirrni (zë rrethues shumëkanalësh) nga marrësi vetëm nëse e lidhni televizorin me kabllo HDMI.

** Nëse dëshironi të nxirrni zë rrethues shumëkanalësh nga marrësi, përdorni **A** për lidhjen audio.

Shënime


- Nëse e lidhni televizorin me marrësin me anë kabllloje video, caktojini „Playback Resolution“ në „480i/576i“ (faqe 94).
- Kur lidhni kabllo dixhitale optike, futini fishat drejt derisa të puthiten duke bërë „klik“.
- Mos i përthyeri ose lidhni kabllot dixhitale optike.

Këshillë

Zëri i televizorit nxirret nga altoparlantët e lidhur në marrës nëse e lidhni folenë dalëse të audios së televizorit në foletë TV IN të marrësit. Në këtë konfigurim, caktoni folenë e daljes së zërit të televizorit në „Fixed“, nëse mund të ndërrohet midis „Fixed“ dhe „Variable“.

Filimi

Lidhjet që nevojiten për të luajtur videolojëra



Nuk është e nevojshme të lidhen të gjitha kabllot. Lidhini kabllot sipas foleve të pajisjeve.

- A** Kabllo HDMI (nuk jepet)
B Kabllo dixhitale optike (nuk jepet)
C Kabllo audio (nuk jepet)
D Kabllo video (nuk jepet)

* Kur lidhni pajisje me një fole dixhitale optike, fole analoge audio, ose fole video Composite, vendosni „Audio Input Assign“ dhe „Video Input Assign“ në menyën Input Settings (faqe 73).

Lloji i videolajës	Kabllloja e kërkuar (kordoni)	
	Video	Audio
Me HDMI*	A	–
Pa HDMI	D	B ose C**


* Zërin e videolajës mund ta nxirrni (zë rrethues shumëkanalësh) nga marrësi vetëm nëse e lidhni videolajën me kabllo HDMI.

** Nëse dëshironi të nxirrni zë rrethues shumëkanalësh nga marrësi, përdorni **B** për lidhjen audio.

Shënime

- Kur lidhni kabllo dixhitale optike, futini fishat drejt derisa të puthiten duke bërë „klik“.
- Mos i përthyeri ose lidhni kabllo dixhitale optike.

Lidhjet e kërkuara për të parë kanale të transmetimit satelitor ose të televizioneve kablore



Nuk është e nevojshme të lidhen të gjitha kabllot. Lidhni kabllot sipas foleve të pajisjeve.

A Kablo HDMI (nuk jepet)

B Kablo dixhitale optike (nuk jepet)

C Kablo audio (nuk jepet)

D Kablo video (nuk jepet)

E Video Component (nuk jepet)

Tipi sintonizues satelitor/dekoder kabllo	Kabloja e kërkuar (kordoni)	
	Video	Audio
Me HDMI*	A	–
Pa HDMI	E ose D	B ose C **


* Zërin e sintonizuesit satelitor/dekoderit kabllo mund ta nxirrni (zë rrethues shumëkanalësh) nga marrësi vetëm nëse e lidhni sintonizuesin satelitor/dekoderin kabllo me kablo HDMI.

** Nëse dëshironi të nxirrni zë rrethues shumëkanalësh nga marrësi, përdorni **B** për lidhjen audio.

Shënime



- Kur lidhni kablo dixhitale optike, futini fishat drejt derisa të puthiten duke bërë „klik“.
- Mos i përthyeri ose lidhni kabllo dixhitale optike.

Lidhjet e kërkuara për shikimin e materialeve të regjistruara në videokasetë



A Kablo audio (nuk jepet)

B Kablo video (nuk jepet)



- A** Kabllo video/audio (nuk jepet)
- B** Kabllo HDMI (nuk jepet)

Funksionet HDMI

- Sinjalet audio dixhitale të transmetuara nga HDMI mund të nxirren nga altoparlantët. Sinjali mbështet Dolby Digital, DTS, DSD dhe PCM lineare. Për hollësi shihni „Formatet dixhitale të audios të mbështetura nga marrësi“ (faqe 20).
- Sinjalet video analoge që hyjnë në folenë VIDEO ose foletë COMPONENT VIDEO mund të nxirren si sinjale HDMI. Sinjalet audio nuk nxirren nga foletë HDMI OUT gjatë konvertimit të figurës.
- Megjithatë, hyrja video analoge nuk mund të nxirren nga foletë HDMI OUT në zonën 2.
- Marrësi mbështet High Bitrate Audio (DTS-HD Master Audio, Dolby TrueHD), Deep Color, „x.v.Color“ dhe transmetime 3D ose 4K.
- Foletë HDMI të marrësit mbështesin funksionin e komandimit për HDMI. Sakaq, foleja HDMI OUT B dhe foletë HDMI ZONE 2 OUT nuk mbështesin funksionin e komandimit për HDMI.
- Për figurë 3D, lidhni pajisje video dhe televizive që mbështesin 3D (luajtës Blu-ray Disc, regjistruer Blu-ray Disc, PlayStation 3 etj.) të marrësi me anë të kablllove High Speed HDMI, vendosni syzet 3D dhe luani materiale që mbështesin 3D.
- Marrësi mbështet nxjerrjen e sinjaleve 4K nga foletë dalëse HDMI. Sinjalet video hyrëse analoge mund të shkallëzohen deri në 4K. Sinjalet hyrëse 4K nga HDMI IN 1/IN 2 mbrapa nga luajtës që mbështet 4K nxirren siç janë si sinjale 4K. Për figurë 4K, lidhni projektorin ose televizorin që mbështet 4K në foletë dalëse HDMI.
- Sinjalin hyrës HDMI IN 1/IN 2/IN 3/IN 4 mund ta shikoni në dritare të shikimit paraprak figurë-në-figurë.

Shënime për lidhjen e kablllove


- Përdorni kabllo High Speed HDMI. Nëse përdorni kabllo Standard HDMI figura 4K, 1080p, Deep Color ose 3D mund të mos shfaqet siç duhet.
- Sony rekomandon përdorimin e kablllove të autorizuar HDMI ose të kablllove Sony HDMI.

Shënim për përdorimin e kablllove konvertuese HDMI-DVI

Nuk rekomandojmë përdorimin e kablllove konvertuese HDMI-DVI. Kur lidhni kabllo konvertuese HDMI-DVI në pajisje DVI-D, zëri dhe/ose figura mund të mungojë. Lidhni kabllo të posaçme audio ose kabllo të dixhitale të lidhjes, pastaj caktoni „Video Input Assign“ dhe „Audio Input Assign“ në menynë Input Settings nëse zëri nuk del siç duhet.

Për të lidhur pajisje me fole të ndryshme nga HDMI

Nuk është e nevojshme të lidhen të gjitha kabllo. Lidhni kabllo sipas foleve të pajisjeve.



A Kablo dixhitale koaksiale (nuk jepet)

B Kablo audio (nuk jepet)

* Kur lidhni pajisje me një fole dixhitale koaksiale, vendoseni „Audio Input Assign“ në Input Settings në menyën (faqe 73).

Këshillë

Të gjitha foletë e audios dixhitale mbështesin frekuenca modulimi 32 kHz, 44,1 kHz, 48 kHz, 88,2 kHz dhe 96 kHz. Fole të COAXIAL IN mbështesin gjithashtu frekuencë modulimi 192 kHz.

Shënim për luajtjen e Super Audio CD në luajtës Super Audio CD


Nuk ka zë kur luani Super Audio CD në luajtës Super Audio CD të lidhur vetëm me folenë COAXIAL e marrësit. Kur luani Super Audio CD, lidhjeni luajtësin te foletë SA-CD/CD IN ose lidhjeni luajtësin që mund të nxjerrë sinjale DSD nga foleja HDMI te marrësi me anë kabloje HDMI. Drejtojuni udhëzimeve të përdorimit që vijnë me luajtësin Super Audio CD.

Nëse dëshironi të lidhni disa pajisje dixhitale, por nuk mund të gjeni hyrje të lirë

Shihni „Përdorimi i foleve të tjera të hyrjes video/audio“ (faqe 73).

Lidhjet e kërkuara për dëgjimin e radios

Antenë qarkore AM (ajrore)
(jepet)



Shënime


- Për të parandaluar interferencat, mbajeni antenën qarkore AM (ajrore) larg marrësit dhe pajisjeve të tjera.
- Sigurohuni që të zgjatni plotësisht antenën FM me tel (ajrore).
- Pasi të lidhni antenën FM me tel (ajrore), mbajeni në pozicion sa më horizontal.

5: Lidhja me rrjetin

Nëse keni lidhje në internet, mund ta lidhni marrësin me internetin.

Shembull konfigurimi

Ilustrimi më poshtë është shembull konfigurimi rrjeti shtëpiak me marrës, një kompjuter. Rekomandojmë të përdorni lidhje me kablo.



Shënim

Lidhni ruterin në një nga foletë 1 deri në 4 të marrësit me vetëm një kablo LAN. Mos e lidhni të njëjtin ruter në marrës me më shumë se një kablo LAN. Mund të shkaktohet defekt.

Kërkesat e sistemit

Nevojitet sistemi i mëposhtëm për të përdorur funksionin e rrjetit të marrësit.

Linjë me brez të gjerë

Nevojitet lidhje brezi të gjerë me internetin për të shfrytëzuar video nga interneti apo për të përdorur funksionin e përditësimit të softuerit në marrës.

Modemi

Kjo është pajisja që lidhet me linjën e brezit të gjerë për të komunikuar me internetin. Disa nga këto pajisje janë integruar me ruterin.

Ruteri

- Përdorni ruter që mbështet 100 Mbps për të shfrytëzuar më mirë materialet në rrjetin shtëpiak.
- Rekomandojmë të përdorni ruter me server DHCP (Dynamic Host Configuration Protocol) të integruar. Ky funksion cakton automatikisht adresa IP në rrjetin LAN.
- Marrësi nuk mbështet lidhje rrjeti me shpejtësi transmetimi 1 Gbps e lart.


Kabloja LAN (CAT5)

- Rekomandojmë të përdorni këtë lloj kabllaje për LAN me kablo. Disa kabllaje për LAN ndikohen lehtë nga interferencat. Rekomandojmë të përdorni kabllaje normale.
- Nëse marrësi përdoret në mjedis ku ka interferenca nga produkte elektrike ose në mjedise rrjeti me interferenca, përdorni kabllaje LAN të izoluar.

6: Përgatitja e marrësit dhe e telekomandës


Lidhja e kordonit të rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik)

Futni mirë kordonin e dhënë elektrik në terminalin AC IN të marrësit, pastaj futeni në prizë.



Midis spinës dhe panelit të pasmë lihet pak hapësirë kur kordoni elektrik futet mirë. Kordoni duhet të lidhet qëllimisht në këtë mënyrë. Ky nuk është defekt.

Ndezja e marrësit



Shtypni I/O për të ndezur marrësin.

Marrësin mund ta ndizni gjithashtu me anë të I/O në telekomandë.

Kur fikni marrësin, shtypni sërish I/O.

„STANDBY“ pulson në dritaren në ekran. Mos e shkëputni kordonin elektrik gjatë pulsimit të „STANDBY“. Kjo mund të shkaktojë defekt.

Për të kursyer energji në modalitet pritjeje

Vendosni „Control for HDMI“ (faqe 96), „Pass Through“ (faqe 96), „Network Standby“ (faqe 98), dhe „RS232C Control“ (faqe 102) në „Off“ ose „Auto“ (vetëm për „Pass Through“) dhe shkëputni rrymën për zonën 2.


Nëse „Control for HDMI“ (faqe 96), „Pass Through“ (faqe 96), ose „Network Standby“ (faqe 98) është vendosur në „On“, ose rryma për zonën 2 është aktivizuar, llamba mbi I/O ndizet në ngjyrë portokalli.

Shënim

Pjesa e sipërme e marrësit mund të nxehtet kur ky është në modalitet gatishmërie. Kjo ndodh pasi në qarqet e brendshme të marrësit kalon korrent. Kjo nuk tregon defekt.

Futja e baterive në telekomandë

Futni dy bateri R6 (madhësia-AA) në telekomandën RM-AAP082. Ruani polaritetin e duhur gjatë vendosjes së baterive.



RM-AAP082

Shënime

- Mos e lini telekomandën në vende të nxehta apo me shumë lagështirë.
- Mos përdorni bateritë e reja së bashku me të vjetrat.
- Mos përzieni bateri me mangan me lloje të tjera baterish.
- Nëse nuk do ta përdorni telekomandën për një periudhë të gjatë, hiqini bateritë për të shmangur dëmtimet e mundshme nga rrjedhja dhe gërryerja e baterive.

7: Konfigurimi i marrësit me anë të Easy Setup

Cilësimet bazë të marrësit mund t'i caktoni lehtësisht duke e komanduar marrësin sipas udhëzimeve në ekranin e televizorit. Kalojeni hyrjen e televizorit të hyrja në të cilën është lidhur marrësi.

Kur ndizni marrësin për herë të parë, në ekranin e televizorit shfaqet EULA (licenca e përdorimit). Pranoni licencën për të vijuar me ekranin e Easy Setup, pastaj konfiguroni marrësin sipas udhëzimeve në ekranin e Easy Setup.

Me anë të Easy Setup mund të konfiguroni funksionet e mëposhtme.

- Network Settings
- Input Settings
- Speaker Settings

Këshillë


Në të djathtë të çdo artikulli funksioni që keni konfiguruar do të shfaqet një shenjë miratimi.

Shënime mbi Speaker Settings (Auto Calibration)

Futni fishën e mikrofonit të optimizuesit deri në fund në folenë AUTO CAL MIC.

Konfirmoni konfigurimin e nën-vuferit aktiv

- Kur lidhet nën-vuferi, ndizeni dhe ngrijini volumnin përpara se ta aktivizoni. Rrotulloni çelësin LEVEL deri pak përpara mesit.
- Nëse e lidhni nën-vuferin me funksionin e frekuencës kalimtare, caktojini vlerën në maksimum.
- Nëse lidhni nën-vuferin me funksionin e gatishmërisë automatike, caktojini në fikur (joaktiv).



Shënime

- Në varësi të karakteristikave të nën-vuferit që përdorni, vlera e konfigurimit të largësisë mund të jetë e ndryshme nga pozicioni aktual.
- Nëse bëni „Speaker Settings (Auto Calibration)“ me anë të Easy Setup, rezultatet e matjes do të mbishkruhen dhe do të ruhen në pozicionin e zgjedhur aktualisht („Pos.1“ zgjidhet si cilësimi i paracaktuar nga fabrika).

Këshilla

- Në varësi të pozicionit të nën-vuferit, rezultatet e matjeve të polaritetit mund të ndryshojnë. Megjithatë, nuk do të ketë asnjë problem edhe nëse vazhdoni ta përdorni marrësin me atë vlerë.
- Në varësi të altoparlantëve, mund të shfaqet „Out Phase“ edhe nëse nuk ka problem me lidhjen e altoparlantit. Kjo shkaktohet nga specifikimet e altoparlantit dhe nuk do të ketë asnjë problem edhe nëse vazhdoni t'i përdorni altoparlantët.

Kur lidhni dy nën-vuferë të marrësi

Në varësi të mjedisit, mund të mos merrni rezultate të sakta matjeje të funksionit „Auto Calibration“ ose nëse dëshironi të bëni rregullime të imëta, mund t'i konfiguroni nën-vuferët manualisht. Për hollësi shihni „Speaker Setup“ në menynë Speaker Settings (faqe 87).


Shënime mbi impedancën e altoparlantëve

- Nëse nuk jeni të sigurt për impedancat e altoparlantëve, drejtojeni udhëzimeve të përdorimit që vijnë me altoparlantët. (Këto informacione jepen shpesh në pjesën e pasme të altoparlantëve.)
- Kur lidhni altoparlantët e përparmë në të dy терминалет FRONT A dhe SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 lidhni altoparlantët me impedancë nominale prej 8 om e lart.

Për të zgjedhur altoparlantët e përparmë

Mund të zgjidhni altoparlantët e përparmë që dëshironi të komandoni.

SPEAKERS (OFF/A/B/A+B)



Shtypni vazhdimisht SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) për të zgjedhur sistemin e altoparlantëve të përparmë që dëshironi të komandoni.

Mund të konfirmoni se cili grup terminalesh (A ose B) zgjidhet duke shënuar treguesit në ekranin e shfaqur.

Treguesit	Altoparlantët e zgjedhur
SP A	Altoparlantët e lidhur në терминалет FRONT A.
SP B	Altoparlantët e lidhur në терминалет SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2.
SP AB	Altoparlantët e lidhur në të dyja терминалет FRONT A dhe SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 (lidhje paralele). „SPEAKERS OFF“ shfaqet në dritaren në ekran. Nuk nxirren sinjale audio nga терминалет e altoparlantëve.

Shënim

Për të zgjedhur një altoparlant të përparmë B, duhet të caktoni терминалет SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 duke përdorur „Speaker Connection“ të menysë Speaker Settings.

Për të anuluar procesin e matjes

Procesi i matjes anulohet nga veprimet e mëposhtme.

- Fikja
- Ndryshimi i volumit
- Ndërrimi i hyrjeve
- Ndryshimi i cilësimit të SPEAKERS (OFF/A/B/A+B)
- Lidhja e kufjeve

Veprime të tjera ndryshe nga më lart nuk lejohen gjatë procesit të matjes.

Për të konfiguruar manualisht marrësin

Shihni „Rregullimi i cilësimeve“ (faqe 82).

8: Konfigurimi i pajisjes së lidhur

Për daljen e audios dixhitale shumëkanalëshe, kontrolloni konfigurimin e daljes së audios dixhitale në pajisjet e lidhura.

Për luajtës Sony Blu-ray Disc, kontrolloni që „Audio (HDMI)“, „DSD Output Mode“, „Dolby Digital/DTS“, „Dolby Digital“ dhe „DTS“ të jenë caktuar përkatësisht në „Auto“, „On“, „Bitstream“, „Dolby Digital“ dhe „DTS“ (nga 1 gushti, 2012).

Për PlayStation 3, pas lidhjes së marrësit me kabllo HDMI zgjidhni „Audio Output Settings“ në „Sound Settings“ dhe zgjidhni „HDMI“ dhe „Automatic“ (me version softueri sistemi 4.21).

Për hollësi, drejtojuni udhëzimeve të përdorimit që vijnë me pajisjet e lidhura.

9: Përgatitja e kompjuterit për përdorim si server

Serveri është pajisje që u dërgon materiale (muzikë, foto dhe video) pajisjeve DLNA në një rrjet shtëpie.


Materialet e ruajtura në kompjuter rrjeti
shtëpie mund t'i luani në marrës nëpërmjet
rrjetit pasi të keni instaluar aplikacionin*
me funksion që mbështet DLNA.

* Nëse përdorni kompjuter me Windows 7, përdorni Windows Media® Player 12 që vjen me Windows 7.

Nëse përdorni kompjuter me Windows 8, sistemi i ri i ndërfaqes mund të mos e njohë marrësin. Nëse ndodh diçka e tillë, ndërrojeni cilësimin në „Desktop UI“.

Udhëzim për komandat që shfaqen në ekran

Mund të shfaqni menyën e marrësit në ekranin e televizorit dhe të zgjidhni funksionin që dëshironi të përdorni në ekran duke shtypur /// dhe  në telekomandë. Kur filloni të përdorni marrësin, sigurohuni që fillimisht të shtypni AMP në telekomandë. Përndryshe, veprimet pasuese mund të mos jenë për marrësin.




Përdorimi i menysë

1 Kalojeni hyrjen e televizorit te hyrja në të cilën është lidhur marrësi.

2 Shtypni AMP.

3 Shtypni HOME.

Menyja kryesore shfaqet në ekranin e televizorit.



4 Shtypni vazhdimisht $\leftarrow/\rightarrow$ për të zgjedhur menynë që dëshironi dhe shtypni $\oplus$ për të hyrë në modalitetin e menysë.

Lista e artikujve të menysë shfaqet në ekranin e televizorit.

Shembull: Kur zgjidhni „Watch”.



Këshillë

Kur „OPTIONS“ shfaqet djathtas në pjesën e poshtme të ekranit, mund të nxirrni listën e funksioneve duke shtypur TOOLS/OPTIONS dhe duke zgjedhur funksionin përkatës.

Për t'u kthyer në ekranin e mëparshëm

Shtypni RETURN/EXIT $\rightarrow$.

Për të dalë nga menyja


Shtypni HOME për të shfaqur menynë kryesore dhe shtypni përsëri HOME.

Pamje e përgjithshme e menysë kryesore

Menyja	Përshkrimi
Watch	Zgjedh burimin e videos ose të fotos që do të hyjë në marrës ose materialin video apo foto që do të dërgohet nga foleja USB ose rrjeti i shtëpisë (faqe 46).
Listen	Zgjedh burimin e muzikës që do të hyjë në marrës, ose materialin muzikor që do të dërgohet nga video interneti ose rrjeti i shtëpisë (faqe 46). Mund gjithashtu të përdorni radion FM/AM të marrësit të integruar.
Favorites	Shfaq materialet nga interneti që ruhen në Favorites List. Mund të ruani deri në 18 artikuj të preferuar material nga interneti (faqe 51).
Easy Automation	Mundëson ruajtjen e një sërë cilësimesh të marrësit dhe rihapjen e të gjitha cilësimeve njëherësh (faqe 76).
Sound Effects	Mundëson dëgjimin e audios së procesuar të ofruar nga teknologji ose funksione të ndryshme të patentuara nga Sony (faqe 56).
Settings	Mundëson rregullimin e cilësimeve për marrësin (faqe 82).

Përjetimi audiovizual

Përjetimi audiovizual nga pajisjet e lidhura



1 Zgjidhni „Watch“ ose „Listen“ nga menja kryesore dhe shtypni .

Lista e artikujve të menysë shfaqet në ekranin e televizorit.

2 Zgjidhni pajisjen që dëshironi dhe shtypni .

3 Ndizni pajisjen dhe nisni luajtjen.

4 Shtypni +/- për të rregulluar volumen.

Për të zgjedhur burimin hyrës

Mund të aktivizoni numeratorin INPUT SELECTOR në marrës ose shtypni butonat e hyrjes në telekomandë për të zgjedhur pajisjen që dëshironi.

Për të zgjedhur burimin e hyrjes për zonën 2, shtypni ZONE në telekomandë për të zgjedhur zonën 2 në fillim (“ZONE 2 [input name]” shfaqet në dritaren në ekran).

Këshilla

Mund ta rregulloni volumen ndryshe me anë të çelësit MASTER VOLUME në marrës ose butonit  +/- në telekomandë.

- Për të ngritur ose ulur shpejt volumen
 - Rrotullojeni shpejt çelësin MASTER VOLUME.
 - Shtypni dhe mbani butonin  +/-.
- Për të bërë rregullime të imëta
 - Rrotullojeni me ngadalë çelësin MASTER VOLUME.
 - Shtypni dhe lëshoni menjëherë butonin  +/-.

Për të aktivizuar funksionin e heshtjes

Shtypni  në telekomandë. Për të anuluar, shtypni sërish  në telekomandë ose shtypni  + për të ngritur volumen. Nëse e fikni marrësin gjatë heshtjes së zërit, zgjedhja e heshtjes do të anulohet.

Për të shmangur dëmtimin e altoparantëve


Përpara se të fikni marrësin, sigurohuni që të ulni nivelin e volumnit.

Pajisje USB/WALKMAN

Në pajisjen e lidhur USB mund të luani skedarë video/muzikorë/fotografikë. Për llojet e luajtshme të skedarëve shihni „Rrjet/USB“ (faqe 21).

1 Lidhni pajisjen USB në fole të (USB) në marrës.

Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes USB përpara se të lidheni.



2 Zgjidhni „Watch“ ose „Listen“ nga menyja kryesore dhe shtypni (+/-).

3 Zgjidhni „My Video“, „My Music“ ose „My Photo“ dhe shtypni (+/-).

Shënim

Nëse nuk ka dalje të figurës, ndryshoni cilësimin për „Playback Resolution“ (faqe 94).

4 Zgjidhni „USB device (front)“ dhe shtypni (+/-).

Skedarët video/muzikorë/fotografikë dhe dosjet renditen në ekranin e televizorit.

5 Shtypni ↑/↓/←/→ dhe (+/-) për të zgjedhur skedarin që dëshironi të luani.

Figura ose zëri nga pajisja USB luhet në marrës.

Shënime

- Mos e shkëputni pajisjen USB gjatë punës. Për të shmangur dëmtimin e të dhënave ose të pajisjes USB fikni marrësin kur shkëputni pajisjen USB.
- Nëse lidhni WALKMAN me marrësin, komandojeni WALKMAN me anë të telekomandës së marrësit, njësoj siç do të bënit gjatë lidhjes së pajisjeve të tjera USB me marrësin. Nuk do të mund të përdorni komandat mbi WALKMAN.
- Disa pajisje USB mund të mos punojnë me këtë marrës.
- Marrësi mund të njohë pajisje të kategorisë për ruajtje masive (MSC), (si memoriet USB ose HDD) (vetëm foleja e përparme USB).

iPod/iPhone


Nëpërmjet marrësit mund të hapni muzikë/ video/foto dhe të karikoni baterinë e iPod/iPhone.

Për hollësi rreth modeleve iPod/iPhone që mbështesin këtë funksion shihni faqe 48.

Shënim

Nuk mund t'i përdorni kufjet gjatë luajtjes.

1 Lidhni iPod/iPhone në folenë ➡ (USB) të marrësit.



2 Zgjidhni „Watch” ose „Listen” nga menyja kryesore dhe shtypni ⏏.

3 Zgjidhni „My Video”, „My Music” ose „My Photo” dhe shtypni ⏏.

Shënim

Nëse nuk ka dalje të figurës, ndryshoni cilësimin për „Playback Resolution” (faqe 94).

4 Zgjidhni „iPod (front)” dhe shtypni ⏏.

Skedarët video/muzikorë renditen në ekranin e televizorit.

Nëse zgjidhni „iPod (front)” në „My Photo”, zgjidhni një skedar fotografik me anë të komandave në iPod/iPhone (nuk është e nevojshme të kaloni në hapin 5).

5 Shtypni ⏏/⏏/⏏/⏏ dhe ⏏ për të zgjedhur skedarin që dëshironi të luani.

Figura ose zëri nga iPod/iPhone luhet në marrës.

iPod/iPhone mund ta komandoni me anë të butonave në telekomandë.

Për të dhënat e përdorimit të iPod/iPhone, drejtojeni gjithashtu udhëzimeve të përdorimit të iPod/iPhone.

Prodhuar për modelet iPod/iPhone

Modelet e përshtatshme iPod/iPhone janë si më poshtë. Përditësoni iPod/iPhone me softuerin më të ri përpara se ta përdorni me marrësin.

Modelet e përshtatshme janë si më poshtë:

- iPod touch
iPod touch (4th generation)/iPod touch (3rd generation)/iPod touch (2nd generation)
- iPod nano
iPod nano (6th generation)/iPod nano (5th generation) (video camera)/iPod nano (4th generation) (video)/iPod nano (3rd generation) (video)
- iPod
iPod classic
- iPhone
iPhone 4S/iPhone 4/iPhone 3GS/iPhone 3G

Për të komanduar iPod/iPhone me anë të telekomandës

iPod/iPhone mund ta komandoni me anë të butonave në telekomandë. Tabela e mëposhtme tregon një shembull të butonave që mund të përdoren. (Në varësi të modelit të iPod/iPhone, komandimi mund të jetë i ndryshëm.)

Për „My Video“/„My Music“

Shtypni	Përdorimi
▶	Fillon luajtjen.
II	Vendos luajtjen në pauzë.
■	Ndalon luajtjen.
◀ ose ▶▶	Shpejt prapa ose përpara.
◀◀ ose ▶▶▶	Kalon në skedarin ose kapitullin para/prapa (nëse ka).

Për „My Photo“

Shtypni	Përdorimi
▶, II	Nis/vendos në pauzë luajtjen.
■	Vendos luajtjen në pauzë.
◀ ose ▶▶	Shpejt prapa ose përpara.
◀◀ ose ▶▶▶	Kalon në skedarin para/prapa.

Shënime

- Nga ky marrës nuk mund të transferoni këngë drejt iPod/iPhone.
- Sony nuk mund të pranojë përgjegjësi në rast kur të dhënat e regjistruara në iPod/iPhone humbasin apo dëmtohen gjatë përdorimit të iPod/iPhone të lidhur me marrësin.
- Ky produkt është krijuar konkretisht për të punuar me iPod/iPhone dhe është certifikuar për plotësimin e standardeve të performancës së Apple.
- Mos e shpëputni iPod/iPhone gjatë punës. Për të shmangur dëmtimin e të dhënave ose të iPod/iPhone, fikeni marrësin gjatë lidhjes ose shkëputjes së iPod/iPhone.
- Gjatë lidhjes së iPod që nuk mbështet funksion të daljes së videos dhe zgjedhjes së „iPod (front)“ në „My Video“ ose „My Photo“, do të shfaqet një mesazh sinjalizues në ekranin e televizorit.

Këshilla

- iPod/iPhone ngarkohet kur lidhet me marrësin ndërkohë që ky është i ndezur.
- Marrësi mund të njohë deri në 3000 skedarë (duke përfshirë dhe dosjet).

Home Network (DLNA)

Mund të luani skedarë video/muzikorë/fotografikë në pajise të tjera të certifikuar nga DLNA duke i lidhur në rrjetin shtëpiak. Marrësi mund të përdoret për luajtje dhe pasqyrim.

- Serveri: Ruan dhe dërgon skedarë.
- Luajtësi: Merr dhe luan skedarë nga serveri.
- Pasqyruesi: Merr dhe luan skedarë nga serveri dhe mund të komandohet nga pajisje tjetër (komanduesi).
- Komanduesi: Komandon elementin pasqyrues.

Përgatitja për përdorimin e funksionit DLNA

- Lidhni marrësin me rrjetin e shtëpisë (faqe 39).
- Përgatitni pajisje të tjera të certifikuar nga DLNA. Për hollësi, drejtojeni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes.

1 Zgjidhni „Watch“ ose „Listen“ nga menja kryesore dhe shtypni .

2 Zgjidhni „My Video“, „My Music“ ose „My Photo“ dhe shtypni .

Shënim

Nëse nuk ka dalje të figurës, ndryshoni cilësimin për „Playback Resolution“ (faqe 94).

3 Zgjidhni ikonën e serverit DLNA dhe shtypni .


Skedarët video/muzikorë/fotografikë dhe dosjet renditen në ekranin e televizorit.

4 Shtypni , , dhe për të zgjedhur skedarin që dëshironi të luani.

Figura ose zëri nga serveri DLNA luhet në marrës.

Për të luajtur skedarë në largësi me anë të marrësit (pasqyruesi) nga komandues DLNA

Marrësin mund ta komandoni me komandues të certifikuar nga DLNA, si p.sh. Windows Media[®] Player 12, gjatë luajtjes së skedarëve të ruajtur në server DLNA.



Komandojeni marrësin me anë komanduesi DLNA.

Për hollësi të komandimit, shikoni udhëzimet e përdorimit të komanduesit DLNA.

Shënim

Mos e përdorni marrësin me telekomandën e dhënë dhe komandues DLNA në të njëjtën kohë.

Këshillë

Marrësi mbështet funksionin „Play To“ të Windows Media[®] Player 12 që vjen si standard me Windows 7.

Video nga interneti

Me anë të marrësit mund të luani një larmi materialesh interneti.

- 1 Lidheni marrësin me rrjet (faqe 39).**
- 2 Zgjidhni „Watch“ ose „Listen“ nga menyja kryesore dhe shtypni .**
- 3 Zgjidhni „Internet Video“ ose „Internet Music“ dhe shtypni .**
Shfaqet ekrani i materialeve të internetit.

Shënim

Nëse nuk ka dalje të figurës, ndryshoni cilësimin për „Playback Resolution“ (faqe 94).

- 4 Zgjidhni ikonën e kompanisë që ofron materiale interneti dhe shtypni .**
Nëse nuk gjendet lista e materialeve nga interneti, ajo do të përfaqësohet nga ikona e mosgjetyes ose nga një ikonë e re.


Shënim

Materialet nga interneti mund të pezullohen apo të ndryshojnë pa paralajmërim.

Për të përdorur panelin e kontrollit

Paneli i kontrollit shfaqet kur fillon të luajë skedari video. Artikujt e shfaqur mund të ndryshojnë, në varësi të ofruesve të materialeve në internet.

Për t'i shfaqur sërish, shtypni DISPLAY.



- 1** Ekrani i kontrollit
Shtypni /// ose  për komandimin e luajtjes.
- 2** Shiriti i gjendjes së luajtjes
Shiriti i gjendjes, kursori tregues i pozicionit aktual, koha e luajtjes, kohëzgjatja e skedarit video
- 3** Treguesi i gjendjes së rrjetit
- 4** Shpejtësia e transmetimit të rrjetit
- 5** Emri i skedarit video të radhës
- 6** Emri i skedarit video të zgjedhur aktualisht

Regjistrimi i materialeve të preferuara

Mund t'i regjistroni materialet e preferuara të internetit në „Favorites List“.

- 1 Shfaqni ekranin e materialeve të internetit.**
- 2 Zgjidhni ikonën e ofruesit të materialeve të internetit që dëshironi të regjistroni në Favorites List dhe shtypni TOOLS/ OPTIONS.**
- 3 Zgjidhni „Add to Favorites“ dhe shtypni .**

Për të hequr materiale nga Favorites List

- 1** Shtypni FAVORITES.
Shfaqet Favorites List.
- 2** Zgjidhni ikonën e ofruesit të materialeve të internetit që dëshironi të hiqni nga Favorites List dhe shtypni TOOLS/ OPTIONS.
- 3** Zgjidhni „Remove from Favorites“ dhe shtypni .

Opsionet e disponueshme

Artikulli	Të dhëna
Favorites List	Shfaq Favorites List.
Add to Favorites	Shton materiale të internetit te Favorites List.
Remove from Favorites	Heq materiale të internetit nga Favorites List.
IP Content Noise Reduction	Përshtat cilësinë e figurës së materialeve video të internetit.


FM/AM

Mund të dëgjoni transmetime FM dhe AM përmes sintonizuesit të integruar. Përpara përdorimit, sigurohuni të keni lidhur antenat FM dhe AM (ajrore) me marrësin (faqe 38).


- 1** Zgjidhni „Listen“ nga menyuja kryesore dhe shtypni .
- 2** Zgjidhni „FM/AM“ dhe shtypni .

Ekran FM/AM

Mund të zgjidhni dhe të komandoni çdo artikull në ekran duke shtypur , ,  dhe .



- 1** Ndërrimi i bandës (faqe 53)
- 2** Treguesi i frekuencës (faqe 53)
- 3** Lista e stacioneve të paravendosura (faqe 54)
- 4** Emri i stacionit të paracaktuar (faqe 54)



Ndërrimi midis radios FM dhe AM

- 1 Zgjidhni „Listen“ nga menya kryesore dhe shtypni $\oplus$.
- 2 Zgjidhni „FM/AM“ dhe shtypni $\oplus$.
Shfaqet ekrani FM/AM.
- 3 Zgjidhni ndërruesin e bandës.
- 4 Shtypni $\uparrow/\downarrow$ për të zgjedhur „FM“ ose „AM“ dhe shtypni $\oplus$.

Sintonizimi automatik i stacionit (Auto Tuning)

- 1 Zgjidhni treguesin e frekuencës në ekranin FM/AM.

2 Shtypni $\uparrow/\downarrow$.

$\uparrow$ skanon stacione nga frekuenca më e ulët në më të lartën dhe $\downarrow$ për skanime nga frekuenca më e lartë në më të ulët. Marrësi ndalon skanimin sa herë që kapet një stacion.

Në rast se ka marrje të dobët stereo FM

- 1 Sintonizohuni në stacionin që dëshironi të dëgjoni me anë të Auto Tuning, Direct Tuning ose zgjidhni stacionin e paravendosur që dëshironi (faqe 54).
 - 2 Shtypni TOOLS/OPTIONS.
Shfaqet menya e opsioneve.
- Shënim**
Mund të caktoni „FM Mode“ në menynë e opsioneve kur zgjidhet treguesi i frekuencës ose kur kërkohet në situatë tjetër.
- 3 Zgjidhni „FM Mode“ dhe më pas shtypni $\oplus$.
 - 4 Zgjidhni „Monaural“ dhe shtypni $\oplus$.

Sintonizimi drejtpërdrejt në stacion (Direct Tuning)

Jepni drejtpërdrejt frekuencën e stacionit me anë të butonave numerikë në telekomandë.

- 1 Shtypni SHIFT dhe shtypni D.TUNING në ekranin FM/AM.
- 2 Shtypni butonat numerikë për të futur frekuencën dhe shtypni $\oplus$.
Shembull 1: FM 102,50 MHz
Zgjidhni 1 $\rightarrow$ 0 $\rightarrow$ 2 $\rightarrow$ 5 $\rightarrow$ 0
Shembull 2: AM 1350 kHz
Zgjidhni 1 $\rightarrow$ 3 $\rightarrow$ 5 $\rightarrow$ 0

Këshilla

- Rregulloni drejtimin e antenës AM qarkore (ajrore) për marrje optimale kur sintonizoheni në stacion AM.

- Shkalla e sintonizimit për sintonizim të drejtpërdrejtë tregohet më poshtë.
 - Banda FM 50 kHz
 - Banda AM 9 kHz

Nëse nuk mund të sintonizoheni në një stacion

Shfaqet „---.--- MHz“ ose „--- kHz“ dhe ekrani kthehet në frekuencën aktuale. Sigurohuni të jepni frekuencën e duhur. Përndryshe, përsëritni hapin 2. Nëse ende nuk mund të lidheni me stacionin, frekuenca ka gjasë të mos përdoret në rajonin ku ndodheni.

Programimi i radiostacioneve FM/AM

Mund të programoni deri në 30 stacione FM dhe 30 AM si të preferuara dhe të paracaktuara.

1 Sintonizohuni në stacionin që dëshironi të programoni me anë të Auto Tuning (faqe 53) ose Direct Tuning (faqe 53).

Në rast sinjali të dobët stereo FM, ndërroni modalitetin e marrjes FM (faqe 53).

2 Shtypni TOOLS/OPTIONS.

Shfaqet menyyja e opsioneve.

Shënim

Mund të caktoni „Preset Memory“ në menyën e opsioneve kur zgjidhet treguesi i frekuencës ose kur kërkohet në situatë tjetër.

3 Zgjidhni „Preset Memory“ dhe shtypni .

4 Zgjidhni një numër të paracaktuar dhe shtypni .

Stacioni ruhet si numri i zgjedhur i paracaktuar.

5 Përsëritni hapat 1 deri 4 për të programuar një stacion tjetër.

Stacionet mund t'i ruani si më poshtë:

- Banda FM: FM1 në FM30
- Banda AM: AM1 në AM30

Sintonizimi në stacione të paravendosura

1 Zgjidhni „Listen“ nga menyja kryesore dhe shtypni .

2 Zgjidhni „FM/AM“ dhe shtypni .

3 Zgjidhni numrin e paracaktuar nga lista dhe shtypni .

Disponohen numra të paracaktuar nga 1 në 30.

Për të emërtuar stacione të paracaktuara (Name Input)

1 Zgjidhni numrin e paracaktuar që doni të emërtoni.

2 Shtypni TOOLS/OPTIONS.

Shfaqet menyyja e opsioneve.

3 Zgjidhni „Name Input“ dhe shtypni .

Në ekran shfaqet tastiera virtuale.

4 Shtypni /// dhe për të zgjedhur shkronjat një nga një për të futur emrin.

5 Zgjidhni „Enter“ dhe shtypni .

Emri që dhatë është i regjistruar.

Për të anuluar procesin e emërtimit

Shtypni RETURN/EXIT  ose HOME.

Marrja e transmetimeve RDS

Radio Data System (RDS) është shërbim transmetimi që u mundëson radiostacioneve të dërgojnë të dhëna shtesë bashkë me sinjalin e rregullt radiofonik. Ky sintonizues ofron funksione praktike RDS si p.sh. shfaqjen e emrit të stacionit. RDS ofrohet vetëm për stacione FM.*

* Jo të gjitha stacionet FM ofrojnë shërbim RDS, por as nuk ofrojnë të njëjtin lloj shërbimesh. Nëse nuk jeni të familjarizuar me sistemin RDS, kontrolloni radiostacionet lokale për hollësi rreth shërbimeve RDS në rajonin ku ndodheni.

Thjesht zgjidhni një stacion nga banda FM.

Kur sintonizoheni në stacion që ofron shërbime RDS, emri i stacionit* shfaqet në ekranin e televizorit dhe në dritaren në ekran.

* Nëse nuk merret transmetim RDS, emri i stacionit nuk do të shfaqet në dritaren në ekran.

Shënim

Disa shkronja që mund të shfaqen në dritaren në ekran mund të mos shfaqen në ekranin e televizorit.

Këshillë

Gjatë shfaqjes së emrit të stacionit, mund të kontrolloni frekuencën duke shtypur vazhdueshëm DISPLAY MODE në marrës.

Opsionet e disponueshme

Artikulli	Të dhëna
FM Mode	Ndërron modalitetin e marrjes FM në stereo ose mono.
Preset Memory	Ruan radiostacionin në një numër të paracaktuar.
Name Input	Emërton stacion të paracaktuar.

Zgjedhja e fushave zanore

- 1 Zgjidhni „Sound Effects“ nga menyuja kryesore dhe shtypni .
- 2 Zgjidhni „Sound Field“ dhe më pas shtypni .
- 3 Zgjidhni fushën zanore që dëshironi.

Luajtja me zë 2-kanalësh

Zërin në dalje mund ta kaloni në zë 2-kanalësh, pavarësisht formateve të regjistrimit të softuerit që përdorni, pajisjes së lidhur luajtëse apo cilësimeve të fushës zanore të marrësit.

2CH mode	Efekti
2ch Stereo	Marrësi nxjerr zërin vetëm nga altoparantët e përparmë majtas/djathtas. Nuk ka dalje të zërit nga basi. Burimet standarde stereo 2-kanalëshe e anashkalojnë plotësisht procesimin e fushës zanore dhe formatet shumëkanalëshe rrethuese miksohen në 2 kanale.
2ch Analog Direct	Audion e hyrjes së zgjedhur mund ta kaloni në hyrjen analoge 2-kanalëshe. Ky funksion mundëson burime analoge të cilësisë së lartë. Kur përdorni këtë funksion, mund të rregullohet vetëm volumi dhe niveli i altoparantëve të përparmë.

Dëgjimi i muzikës nëpërmjet kufjeve të lidhura në marrës

Fusha zanore	Efekti
Headphone (2ch)	Ky modalitet zgjidhet automatikisht nëse përdorni kufjet dhe kur zgjidhet një modalitet i ndryshëm nga „2ch Analog Direct“. Burimet standarde stereo 2-kanalëshe e anashkalojnë plotësisht procesimin e fushës zanore dhe formatet shumëkanalëshe rrethuese miksohen në 2 kanale.
Headphone (Direct)	Nxjerr sinjalet analoge pa procesim sipas tonit, fushës zanore etj. Ky modalitet zgjidhet automatikisht nëse zgjidhet opsioni „2ch Analog Direct“.

Luajtja me tingull rrethues shumëkanalësh

Modaliteti Auto Format Direct (A.F.D.) mundëson dëgjimin e audios në Hi-Fi më të lartë dhe zgjedhjen e modalitetit të dekodimit për dëgjim të tingullit stereo 2-kanalësh ose mono si tingull shumëkanalësh.

Modaliteti A.F.D.	Efekti
A.F.D. Auto	E paracakton zërin sipas regjistrimit/kodimit pa i shtuar efekte rrethuese.
Multi Stereo	Nxjerr sinjale 2-kanalëshe majtas/djathtas ose sinjale mono nga të gjithë altoparlantët.

Këshillë

Rekomandojmë „A.F.D. Auto“.

Shijimi i efektit rrethues në filma

Mund të keni tingull rrethues thjesht duke zgjedhur një prej fushave të paraprogramuara zanore të marrësit. Ato sjellin në shtëpinë tuaj audion emocionuese dhe të fuqishme të kinemasë.

Fusha zanore	Efekti
HD-D.C.S.	HD Digital Cinema Sound (HD-D.C.S.) është teknologjia e re novatore e kinemasë në shtëpi nga Sony, e cila përdor teknologjitë më bashkëkohore të procesimit të sinjaleve dixhitale dhe akustike. Bazohet në të dhënat e përpikta të matjes së reagimit nga studio masterizimi. Me HD-D.C.S., mund të shihni në shtëpi filma Blu-ray dhe DVD, jo vetëm me cilësi të lartë të zërit, por edhe me atmosferën e përshtatshme akustike, ashtu siç ka qenë qëllimi i inxhinierit të zërit të filmit në procesin e masterizimit. Mund të zgjidhni llojin e efektit për HD-D.C.S. Për hollësi shihni „Rreth llojit të efektit për HD-D.C.S.“ (faqe 58).
PLII Movie	Kryen dekodim të modalitetit Dolby Pro Logic II Movie. Ky cilësim është ideal për filmat e koduar me Dolby Surround. Përveç kësaj, ky modalitet mund të riprodhojë zë në format 5.1-kanalësh për të parë videot e filmave me dublim ose të filmave të vjetër.
PLIIx Movie	Kryen dekodim të modalitetit Dolby Pro Logic IIx Movie. Ky cilësim zgjeron 5.1-kanalëshin Dolby Pro Logic II Movie ose Dolby Digital në 7.1-kanalësh të përkushtuar për filma.
PLIIz Height	Kryen dekodim të modalitetit Dolby Pro Logic IIz. Ky cilësim mund të zgjerojë zërin burim deri në 7.1 kanale, të cilit i i aplikohet Component vertikal duke përfutur idenë e pranisë dhe të përmasave fizike. „PLIIz Height“ është e njëjta fushë zanore si ajo që përshkruhet në faqe 59. Mund të rregulloni nivelin e përforcimit për „PLIIz Height“. Për hollësi shihni „Rreth nivelit të përforcimit për PLIIz Height“ (faqe 60).
Neo:6 Cinema	Kryen dekodim të modalitetit DTS Neo:6 Cinema. Një burim i regjistruar në format me 2 kanale përforcohet deri në 7 kanale.

Rreth llojit të efektit për HD-D.C.S.

HD-D.C.S. ka tri lloje të ndryshme: Dynamic, Theater dhe Studio. Çdo lloj ka një pasqyrim dhe nivele të veçanta rezonance të përzierjes së zërit dhe është i optimizuar për t'iu përshtatur veçantisë së ambientit, shijes dhe humorit të dëgjuesit.

■ Dynamic

Cilësimi „Dynamic“ është i përshtatshëm për një ambient kumbues, por që i mungon ndjesia e hapësirës (ku përthithja e zërit nuk është e mjaftueshme). Ky cilësim thekson pasqyrimin e zërit dhe riprodhon zërin e një kinemaje të madhe klasike. Në këtë mënyrë, forcohet ndjesia e hapësirës së një studioje regjistrimi të zërit dhe krijohet një fushë e veçantë zanore.

■ Theater

Cilësimi i parazgjedhur i fabrikës. Cilësimi „Theater“ është i përshtatshëm për një dhomë të zakonshme ndenjeje. Ky cilësim riprodhon rezonancën e zërit si në kinema (studio regjistrimi). Është më i përshtatshmi për të parë materiale të regjistruara në Blu-ray Disc, kur dëshironi të krijoni atmosferë kinemaje.

■ Studio

Cilësimi „Studio“ është i përshtatshëm për dhomë ndenjeje me pajisjet e duhura akustike. Ky cilësim riprodhon rezonancën kur burimi zanor i filmit është miksuar për Blu-ray Disc në volum të përshtatshëm për përdorim në shtëpi. Niveli i pasqyrimin dhe i rezonancës së zërit mbahet në minimum. Megjithatë, dialogët dhe efektet zanore rrethuese riprodhohen në mënyrë të gjallë.

Shijimi i efektit rrethues në muzikë

Mund të keni zë rrethues thjesht duke zgjedhur një prej fushave të paraprogramuara zanore të marrësit. Ato sjellin në shtëpinë tuaj audion emocionuese dhe të fuqishme të sallave të koncerteve.

Fusha zanore	Efekti
Berlin Philharmonic Hall	Riprodhon veçoritë akustike të Sallës së Filarmonisë së Berlinit. Punon gjithashtu në mënyrë automatike së bashku me marrjen e shërbimit të internetit „The Berliner Philharmoniker’s Digital Concert Hall“.
Concertgebouw Amsterdam	Riprodhon veçoritë akustike të prodhuara nga aftësia kumbuese e një salle koncertesh në Amsterdam, Holandë, e cila ka një skenë të madhe.
Musikverein Vienna	Riprodhon veçoritë akustike të një salle koncertesh në Vjenë, Austri, e cila ka tingull unik rezonant e kumbues.
Jazz Club	Riprodhon akustikën e një klubi xhazi.
Live Concert	Riprodhon akustikën e një salle koncertesh me 300 vende.
Stadium	Riprodhon ndjesinë e një stadiumi të madh të hapur.
Sports	Riprodhon ndjesinë e transmetimeve sportive.
Portable Audio	Riprodhon një perceptim të qartë të përmirësuar të zërit nga pajisja portative audio. Ky modalitet është ideal për MP3 dhe llojet e tjera të muzikës me skedarë të kompresuar.
PLII Music	Kryeni dekodim të modalitetit Dolby Pro Logic II Music. Ky cilësim është ideal për burimet normale stereo, si p.sh. CD-të.
PLIIx Music	Kryen dekodim të modalitetit Dolby Pro Logic IIx Music. Ky cilësim është ideal për burimet normale stereo, si p.sh. CD-të.
PLIIz Height	Kryen dekodim të modalitetit Dolby Pro Logic IIz. Ky cilësim mund të zgjerojë zërin burim deri në 7.1 kanale, të cilit i i aplikohet Component vertikal duke përfutur idenë e pranisë dhe të përmasave fizike „PLIIz Height“ është e njëjta fushë zanore si ajo që përshkruhet në faqe 57. Mund të rregulloni nivelin e përforcimit për „PLIIz Height“. Për hollësi shihni „Rreth nivelit të përforcimit për PLIIz Height“ (faqe 60).
Neo:6 Music	Kryen dekodim të modalitetit DTS Neo:6 Music. Një burim i regjistruar në format me 2 kanale përforcohet deri në 7 kanale.

Breth nivelit të përforcimit për PLIIz Height

Mund të rregulloni nivelin e përforcimit të kanaleve të përparmë të lartësisë për modalitetin Pro Logic IIz (i zakonshëm për filma dhe muzikë).

■ Low

Nuk do të aplikohet asnjë përforcim.

■ Mid

Do të aplikohet përforcimi +3 dB (cilësimi i parazgjedhur i fabrikës).

■ High

Do të aplikohet përforcimi +5 dB.

Shënime për fushat zanore

- Në varësi të shtetit ose rajonit, shërbimi i internetit i „Berlin Philharmonic Hall“ mund të mos disponohet.
- Nuk mund të zgjidhni „2ch Analog Direct“ kur luani material nga pajisje USB, rrjet shtëpie apo video interneti.
- „Multi Stereo“ nuk punon kur merren sinjale audio shumëkanalëshe.
- Fushat zanore për filmat dhe muzikën mund të mos punojnë, në varësi të hyrjes ose të motivit të zgjedhur të altoparlantëve ose me formate audio.
- Marrësi mund të luajë sinjale në frekuencë më të ulët modulimi se frekuenca aktuale e modulimit të sinjaleve hyrëse, në varësi të formatit audio.
- „PLIIx Movie/Music“ dhe „PLIIz Height“ mund të mos shfaqen, në varësi të motivit të altoparlantëve që zgjidhni.
- Disa altoparlantë ose nën-vuferi mund të mos nxjerrin fare tingull në varësi të cilësimeve të fushës zanore.
- Nëse ka prani të ndonjë zhurme, zhurma mund të ndryshojë në varësi të fushës së zgjedhur zanore.

Përdorimi i funksionit Sound Optimizer

Funksioni Sound Optimizer krijon një ndjesi të pranisë dhe të intensitetit të zërit gjatë skenave me volum të lartë, pavarësisht nivelit të volumit në marrës.

Mund të përftoni zë të qartë e dinamik edhe në volumet e ulëta gjatë orëve të vona të natës.

Efekti optimal për t'iu përshtatur mjedisit tuaj arrihet duke shfrytëzuar funksionin „Auto Calibration“.

1 Zgjidhni „Settings“ nga menya kryesore dhe shtypni .

2 Zgjidhni „Audio Settings“ dhe shtypni .

3 Zgjidhni „Sound Optimizer“ dhe shtypni .

4 Zgjidhni „Normal“ ose „Low“ dhe shtypni .

Funksioni Sound Optimizer është aktiv. Për të rregulluar nivelin referencë të një filmi, zgjidhni „Normal“. Për ta rregulluar për CD ose softuer tjetër, niveli mesatar i trysnisë zanore të të cilit ka procesim të lartë, zgjidhni „Low“. Gjithashtu, mund ta caktoni funksionin Sound Optimizer në „Normal“ ose „Low“ dhe „Off“ me anë të SOUND OPTIMIZER në telekomandë.

Shënime


- Ky funksion nuk punon në rastet e mëposhtme.
 - Kur është në përdorim „2ch Analog Direct“.
 - Kur janë në përdorim kufjet.
- Marrësi mund të luajë sinjale në frekuencë më të ulët modulimi se frekuenca aktuale e modulimit të sinjaleve hyrëse, në varësi të formatit audio.

Këshillë

Me anë të funksionit të balancuesit dhe të rregullimit të të gjithë altoparlantëve në të njëjtën kohë, mund të bëni rregullime të imëta me Sound Optimizer.

Rregullimi i balancuesit

Mund të përdorni parametrat e mëposhtëm për të rregulluar cilësinë e tonalitetit (niveli bas/alto) të altoparlantëve të përparmë, rrethues/rrethues mbrapa dhe të përparmë lart.



- 1 Zgjidhni „Settings“ nga menyja kryesore dhe shtypni (+).
- 2 Zgjidhni „Audio Settings“ dhe shtypni (+).
- 3 Zgjidhni „Equalizer“ dhe shtypni (+).
- 4 Zgjidhni „Front“, „Center“, „SUR/SB“ ose „Front High“ dhe shtypni (+).
- 5 Zgjidhni „Bass“ ose „Alto“.
- 6 Rregulloni përforsimin dhe shtypni (+).

Shënime

- Ky funksion nuk punon në rastin e mëposhtëm.
 - Kur është në përdorim „2ch Analog Direct“.
- Kur frekuencat për Bass dhe Alto janë të fiksuara.
- Në varësi të formatit audio, marrësi mund të luajë sinjale në frekuencë më të ulët modulimi se frekuenca origjinale e modulimit të sinjaleve hyrëse.

Për të rregulluar të gjithë altoparlantëve në të njëjtën kohë (All EQ Adjustment)

Mund të rregulloni cilësinë e tonalitetit (bas/alto) të të gjithë altoparlantëve në të njëjtën kohë.

- 1 Zgjidhni „Settings“ nga menyja kryesore dhe shtypni (+).
- 2 Zgjidhni „Audio Settings“ dhe shtypni (+).
- 3 Zgjidhni „Equalizer“ dhe më pas shtypni (+).
- 4 Zgjidhni „All“ dhe shtypni (+).
- 5 Zgjidhni „Bass“ ose „Alto“ dhe shtypni (+).
- 6 Rregulloni përforsimin dhe shtypni (+).

Shënim

Në varësi të cilësimit të balancuesit për çdo kanal, nivelet aktuale të caktuar me All EQ Adjustment mund të jenë më të ulëta ose më të larta se vlerat e përcaktuara.

Përdorimi i funksioneve shumëzonëse

Çfarë mund të bëni me funksionin shumëzonësh

Mund të merrni figurë dhe zë nga pajisje të lidhura me marrësin në zonë të ndryshme nga zona kryesore. Për shembull, mund të shikoni DVD në zonën kryesore dhe të dëgjoni CD në zonën 2.


Kur përdorni repetitor infra të kuq (nuk jepet), mund të komandoni të dyja pajisjet në zonën kryesore dhe marrësin Sony në zonën 2 nga zona 3 me anë të telekomandës. Përdorni repetitor me infra të kuqe kur instaloni marrësin në vende ku nuk arrijnë sinjalet nga telekomanda.

Kryerja e një lidhjeje shumëzonëse

Sinjalet nga pajisjet e lidhura në foletë hyrëse analoge dalin përmes foleve të komponentëve ZONE 2 VIDEO/AUDIO OUT ose ZONE 2 OUT. Foletë e komponentëve ZONE 2 VIDEO/AUDIO OUT ose ZONE 2 OUT nuk mund të nxjerrin sinjale nga foletë HDMI IN. Për të nxjerrë sinjale HDMI, përdorni foletë HDMI ZONE 2 OUT.


Lidhjet e zonës 2

- ① Nxjerr zërin nga altoparlantët në zonën 2 me anë të terminaleve SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 të marrësit.



② Nxjerr zërin nga altoparlantët në zonën 2 me anë të marrësit dhe një amplifikatori tjetër.

Kërket konfigurimi i altoparlantëve në zonën 2 (faqe 65).



A Repetitor infra i kuq (nuk jepet)

B Altoparlantë


C Amplifikator/marrës tjetër

* Mund të lidhni gjithashtu folenë ZONE 2 COMPONENT VIDEO OUT.

③ Kryerja e një lidhjeje të zonës 2 me anë të HDMI

Nxjerr HDMI sinjalet hyrëse video/audio në zonën 2 me anë të folesë HDMI ZONE 2 OUT së marrësit.

Mund të kërket caktimi i daljes HDMI në zonën 2 (faqe 65).



A Repetitor infra i kuq (nuk jepet)

B Altoparlantë

C Amplifikator/marrës tjetër

Shënim

Mund të lidhni folenë HDMI ZONE 2 OUT drejtpërdrejt në televizorin e zonës 2 (pa amplifikator/marrës). Megjithatë, rekomandohet ta lidhni televizorin nëpërmjet një amplifikatori/marrësi për kapacitete më të larta audio/video, duke zvogëluar interferencën e mundshme në zonën kryesore. Kur zgjidhni të njëjtën hyrje HDMI për zonën kryesore dhe për zonën 2, kapacitetet audio/video në zonën kryesore do të kufizohen në përputhje me ato në zonën 2.

Konfigurimi i altoparlantëve në zonën 2

Kur altoparlantët në zonën 2 lidhen me termialet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 e marrësit (faqe 62), caktojeni në mënyrë që zëri i zgjedhur në zonën 2 të nxirret nga altoparlantët e lidhur me termialet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2.

Për hollësi shihni „Speaker Connection“ në menyën Speaker Settings (faqe 86).

Caktoni kontrollin e volumnit për zonën 2

Mund të caktoni kontrollin e volumnit për foletë e ndryshueshme ose fikse të ZONE 2 AUDIO OUT.

- 1 Zgjidhni „Settings“ nga menya kryesore dhe shtypni .
- 2 Zgjidhni „Zone Settings“ dhe shtypni .
- 3 Zgjidhni „Zone Setup“ dhe shtypni .
- 4 Zgjidhni „Line Out“ për „Zone2“ dhe shtypni .
- 5 Zgjidhni parametrin që dëshironi dhe shtypni .

Parametri	Shpjegimi
Variable	Komanda e volumnit është caktuar fillimisht në -40 dB. Kur zgjidhni këtë parametër volumni i terminaleve ZONE 2 AUDIO OUT dhe SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 mund të ndryshojnë së bashku. Rekomandohet kur përdorni amplifikator fuqie.

Parametri	Shpjegimi
Fixed	Kontrolli i volumnit është fiksuar në ± 0 dB. Rekomandohet kur përdorni pajisje me komandim të ndryshueshëm të volumnit.

Konfigurimi i daljes HDMI në zonën 2

Kur pajisje si televizorë ose amplifikatorë A/V lidhen me fole të HDMI ZONE 2 OUT, mund të nxirrni sinjale HDMI nga pajisja në zonën 2. Për hollësi shihni „③ Kryerja e një lidhjeje të zonës 2 me anë të HDMI“ (faqe 63).

Konfigurimi i daljes HDMI të Zone2

Mund t'i nxirrni sinjalet nga foletë HDMI IN në pajisjet e Zone2 nëpërmjet foleve HDMI ZONE 2 OUT si më poshtë:

- 1 Zgjidhni „Settings“ nga menya kryesore dhe shtypni .
- 2 Zgjidhni „HDMI Settings“ dhe shtypni .
- 3 Zgjidhni „Zone2 Out“ dhe shtypni .
- 4 Zgjidhni „On“ dhe shtypni .

Shënimi

- Kur aktivizohet funksioni „Zone2 Out“, çaktivizohen funksionet e mëposhtme:
 - Komandë për HDMI („BRAVIA“ Sync)
 - Fast View (Përfshin pamjen paraprake për HDMI: On)

Vendosja e prioritetit për zonën kryesore dhe zonën 2


Kur aktivizohet funksioni Zone2 Out dhe zgjidhni të njëjtën hyrje HDMI për zonën kryesore dhe për zonën 2, në sinjalet audio dhe video në zonën kryesore mund të ketë interferencë. Për të shmangur interferencën e mundshme, mund të caktoni prioritetin në zonën kryesore për zgjedhjen e hyrjes HDMI.

- 1 Zgjidhni „Settings“ nga menya kryesore dhe shtypni .**
- 2 Zgjidhni „HDMI Settings“ dhe shtypni .**
- 3 Zgjidhni „Priority“ dhe shtypni .**
- 4 Zgjidhni „Main Only“ dhe shtypni .**

Përdorimi i marrësit nga një zonë tjetër

(Veprimet për ZONE 2)

Mund ta përdorni marrësin nga zona 2. Procedurat në këtë seksion përshkruajnë veprimet kur lidhet një repetitor infra të kuq, i cili shërben për funksionet shumëzonëshe. Nëse repetitori infrakuq nuk është i lidhur, përdoreni marrësin në zonën kryesore.



1 Ndizni amplifikatorin në zonën 2.

Në rastin e figurës „Lidhjet e zonës 2“-① (faqe 62) anashkaloni këtë hap.

2 Shtypni ZONE.

Telekomanda kalon në zonën 2.

3 Shtypni I/🔊.

Aktivizohet funksioni i zonës.

4 Shtypni një nga butonat e hyrjes në telekomandë për të zgjedhur sinjalet e burimit që doni të nxirrni.

5 Përshtatni volumin.

- Në rastin e figurës „Lidhjet e zonës 2“ -
① (faqe 62), përshtatni volumin me anë të +/- në telekomandë.
- Në rastin e figurës „Lidhjet e zonës 2“ -
② (faqe 63), përshtatni volumin me anë të marrësit në zonën 2. Nëse caktoni „Line Out“ për „Zone2“ në „Variable“ mund ta përshtatni volumin në zonën 2 duke përdorur +/- në telekomandë (faqe 65).

¹⁾ Për zonën 2, nxirren sinjale HDMI, sinjale video komponent, sinjale video dhe sinjale audio analoge. Kur zgjidhni SOURCE, nxirren sinjalet e hyrjes aktuale në zonën kryesore.

²⁾ „TV“ mund të zgjidhet vetëm në zonën kryesore.

³⁾ Ju mund të zgjidhni „FM“ ose „AM“ nga zona kryesore ose zona 2. Kur zgjidhen programe të ndryshme në disa zona, përparësi ka hyrja që keni zgjedhur së fundi.

⁴⁾ Vetëm kur SOURCE zgjidhet në zonën 2 mund të hapni materiale nga zona kryesore në zonën 2.

Përfundimi i veprimeve të zonës 2

Shtypni ZONE dhe shtypni I/🔊.

Veprimet e mundshme të zonës 2

INPUT	ZONE 2 ¹⁾
SOURCE	☐
BD	☐
DVD	☐
GAME	☐
SAT/CATV	☐
VIDEO 1	☐
VIDEO 2	☐
VIDEO 3	☐
VIDEO 4	☐
TV ²⁾	
SA-CD/CD	☐
FM ³⁾	☐
AM ³⁾	☐
My Music ⁴⁾	☐
My Video ⁴⁾	☐
My Photo ⁴⁾	☐
Internet Contents ⁴⁾	☐

Përdorimi i veçorive të „BRAVIA“ Sync

Çfarë është „BRAVIA“ Sync?

„BRAVIA“ Sync është emri i një funksioni në produktet Sony që mundëson komandimin e përbashkët me telekomandë „BRAVIA“ të pajisjeve të pajtueshme të lidhura me kablo HDMI.

Ky komandim i përbashkët mundësohet nga komanda për funksionin HDMI me anë të HDMI CEC (Consumer Electronics Control), standardizuar për HDMI (High-Definition Multimedia Interface).

Duke lidhur me kablo HDMI (nuk jepet) pajisjet Sony që mbështesin „BRAVIA“ Sync, komandimi thjeshtohet si më poshtë:

- System Power-Off (faqe 69)
- One-Touch Play (faqe 69)
- Kontrolli i sistemit audio (faqe 69)
- Audio Return Channel (ARC) (faqe 70)
- Scene Select (faqe 70)
- Home Theater Control (faqe 70)
- Remote Easy Control (faqe 70)

Komanda për funksionin HDMI nuk punon në rastet e mëposhtme:

- Kur lidhni marrësin me pajisje që nuk përkon me komandën Sony për funksionin HDMI.
- Kur lidhni marrësin dhe pajisjen me lidhje të ndryshme nga HDMI.
- Komanda për funksionin HDMI nuk punon në pajisje të lidhur me folenë HDMI OUT B të marrësit.
- Kur caktoni „Zone2 Out“ në menunë „HDMI Settings“ në „On“, nuk mund ta përdorni funksionin „Control for HDMI“.

Rekomandojmë ta lidhni marrësin me produkte që kanë „BRAVIA“ Sync.

Shënime

- Veçoritë e mëposhtme mund të punojnë me pajisje jo Sony. Megjithatë, nuk garantohet mbështetja për të gjitha pajisjet jo Sony.
 - System Power-Off
 - One-Touch Play
 - Kontrolli i sistemit audio
- Veçoritë e mëposhtme janë funksione të patentuara nga Sony. Ato nuk punojnë me pajisje jo Sony.
 - Scene Select
 - Home Theater Control
- Pajisjet që nuk mbështesin „BRAVIA“ Sync nuk mund t'i aktivizojnë këto funksione.

Përgatitja për „BRAVIA“ Sync

Për të përdorur „BRAVIA“ Sync, ndizni komandën për funksionin HDMI të marrësit dhe pajisja e lidhur.

Ndizni individualisht komandën për funksionin HDMI të marrësit dhe të pajisjes së lidhur.

- 1 Zgjidhni „Settings“ nga menya kryesore dhe shtypni .**
- 2 Zgjidhni „HDMI Settings“ dhe shtypni .**
- 3 Zgjidhni „Control for HDMI“ dhe shtypni .**
- 4 Zgjidhni „On“ dhe shtypni .**

Komanda për funksionin HDMI të marrësit aktivizohet.

- 5 Ndizni komandën për funksionin HDMI të pajisjes së lidhur.**

Për hollësi rreth konfigurimit të pajisjes së lidhur, drejtojeni udhëzimeve të saj të përdorimit.

6 Përsërisni hapin 5 për të caktuar komandën për funksionin HDMI dhe për të shfaqur pamjen e të gjitha pajisjeve luajtëse që dëshironi të përdorni.

Shënim

Kur hiqni kabllon HDMI ose kur ndryshoni lidhjen, kryeni hapat e mësipërm.

Megjithatë, nuk ju duhet t'i kryeni këto hapa kur përdorni fole HDMI IN 1, IN 2 ose IN 3.

System Power-Off

Kur fikni televizorin me anë të butonit të energjisë në telekomandën e televizorit, marrësi dhe pajisja e lidhur fiken automatikisht.

Mund të përdorni gjithashtu telekomandën për të fikur televizorin.

Shtypni TV dhe shtypni I/⏻.

Televizori, marrësi dhe pajisja e lidhur fiken.

Shënime

- Aktivizoni funksionin e bllokimit të ushqimit të televizorit me energji përpara se të përdorni funksionin Fikja e sistemit. Për hollësi, drejtojeni udhëzimeve të përdorimit të televizorit.
- Në varësi të kushteve të pajisjes së lidhur, ajo mund të mos fiket. Për hollësi, drejtojeni udhëzimeve të përdorimit të pajisjeve të lidhura.
- Nëse përdorni funksionin Fikja e sistemit me një televizor jo Sony, programoni telekomandën sipas prodhuesit të televizorit.

One-Touch Play

Kur luani përmbajtje në pajisjen e lidhur me marrësin nëpërmjet një lidhjeje HDMI, edhe marrësi ndizet automatikisht dhe kalohet në hyrjen e duhur HDMI.

Kur e caktoni „Pass Through“ në „On“, ose „Auto“, zëri dhe imazhi mund të nxirren vetëm nga televizori ndërkohë që marrësi mbetet në modalitet pritjeje.

Nisni luajtjen në pajisjen e luajtjes.

Përdorimi i funksionit One-Touch Play në kamera

1 Ndizni komandën për funksionin HDMI te marrësi dhe te kamera.

2 Lidhni kamerën me një nga foletë HDMI IN 1, IN 2 dhe IN 3 (faqe 33).

Nëse përdorni një kamerë Sony, televizori ndizet bashkë me marrësin, pastaj kamera fillon të luajë automatikisht. Nëse përdorni një kamerë jo Sony, luajeni kamerën vazhdimisht.

Shënim

- Në varësi të televizorit, nisja e përmbajtjes mund të mos shfaqet.
- Lidhni pajisje të tilla si kamerën Sony, të pajisur me funksionin Luajtje me një prekje, thjesht duke u lidhur me HDMI në foletë HDMI IN 1, IN 2 dhe IN 3. Nëse përdorni fole HDMI IN të tjera, marrësi mund të mos kalojë në hyrjen e duhur. Në këtë rast, zgjidhni manualisht hyrjen me të cilën është lidhur kamera.

Kontrolli i sistemit audio

Mund të dëgjoni zërin e televizorit nga pajisjet e lidhura me marrësin nëpërmjet një veprimi të thjeshtë. Mund të përshtatni gjithashtu volumin dhe të fikni zërin e marrësit me anë të telekomandës së televizorit.

Mund të përdorni funksionin e kontrollit të sistemit audio si më poshtë.

- Kur zëri i televizorit nxirret nga altoparlantët e lidhur me marrësin kur ndizni marrësin ndërkohë që zëri nxirret nga altoparlanti i televizorit. Nëse e fikni marrësin, zëri nxirret nga altoparlanti i televizorit.
- Kur përshtatni volumin e televizorit, funksioni i kontrollit të audios së sistemit përshtat njëkohësisht volumin e marrësit. Mund ta përdorni këtë funksion me anë të menysë së televizorit. Për hollësi, drejtojeni udhëzimeve të përdorimit të televizorit.

Shënim

Kur „Control for HDMI“ është caktuar në „On“, cilësimet e „Audio Out“ në menyën HDMI Settings do të caktohen automatikisht, bazuar në cilësimet e sistemit të audios së sistemit.

Audio Return Channel (ARC)

Nëse televizori përshtatet me Audio Return Channel (ARC), lidhja me kabllo HDMI e dërgon gjithashtu sinjalin dixhital të audios nga televizori te marrësi. Nuk duhet të kryeni një lidhje të veçantë audio për dëgjimin e zërit të televizorit nga marrësi.

Për hollësi shihni „Kalimi mes audios dixhitale dhe analoge“ (faqe 72).

Scene Select

Cilësia optimale e figurës dhe fusha zanore zgjidhen automatikisht sipas skenës së zgjedhur në televizor.

Për hollësi rreth funksionimit, drejtojuni udhëzimeve të përdorimit të televizorit.

Shënim

Fusha zanore mund të mos ndryshojë në varësi të televizorit.

Tabela korresponduese

Kaktimi i skenës në televizor Fusha zanore	
Cinema	HD-D.C.S.
Sports	SPORTS
Music	Live Concert
Animation	A.F.D. Auto
Photo	A.F.D. Auto
Game	A.F.D. Auto
Graphics	A.F.D. Auto

Home Theater Control

Nëse një televizor i përshtatshëm me „Home Theater Control“ lidhet me marrësin, në televizorin e lidhur shfaqet një ikonë për aplikacionet e bazuara në internet.

Mund të ndërroni hyrjen e marrësit ose të ndërroni fushat zanore me anë të telekomandës së televizorit. Mund të rregulloni gjithashtu nivelin e altoparlantit qendror ose të nën-vuferit ose të rregulloni cilësimet e „Sound Optimizer“ (faqe 60), „Dual Mono“ (faqe 90) ose „A/V Sync“ (faqe 91).

Për të përdorur funksionin Home Theater Control, televizori duhet të jetë në gjendje të ketë akses në shërbimin e internetit me brez të gjerë.

Remote Easy Control

Mund ta përdorni telekomandën e televizorit për të përdorur menyne e marrësit.


Zgjidhni marrësin (AV AMP) e njohur nga televizori.

Shënime

- Marrësi njihet nga televizori si „Tuner (AV AMP)“.
- Televizori duhet të jetë i përputhshëm me menyne e lidhjes.
- Në varësi të llojit të televizorit, disa nga funksionet mund të mos jenë të disponueshme.

Ndërrimi i monitorëve që nxjerrin sinjale videoje HDMI

Kur keni dy monitorë të lidhur me foletë HDMI OUT A dhe HDMI OUT B, mund ta ndërroni daljen e këtyre monitorëve me anë të butonit HDMI OUTPUT në telekomandë.



- 1 Ndizni marrësin dhe dy monitorët.**
- 2 Shtypni HDMI OUTPUT.**

Sa herë që shtypni butonin, dalja do të ndryshohet si më poshtë:

HDMI A → HDMI B → OFF → HDMI A...

Mund të përdorni gjithashtu butonin HDMI OUT te marrësi.

Nxjerrja e sinjaleve HDMI edhe kur marrësi është në modalitet pritjeje

(Pass Through)

Mund t'i nxirrni sinjalet video dhe audio nga foleja HDMI IN në televizorin e lidhur me folenë HDMI OUT A edhe kur marrësi është në modalitet pritjeje.

Nëse përdorni këtë funksion ndërkohë që „Control for HDMI“ është caktuar në „On“, hyrja e marrësit ndërrohet në përputhje me përdorimin e pajisjes së lidhur, edhe kur marrësi është në modalitet pritjeje.

Kur e aktivizoni këtë funksion, kryeni cilësimet për „Pass Through“ duke ndjekur hapat e mëposhtëm.

- 1 Zgjidhni „Settings“ nga menyuja kryesore dhe shtypni .**
- 2 Zgjidhni „HDMI Settings“ dhe shtypni .**
- 3 Zgjidhni „Pass Through“ dhe shtypni .**
- 4 Zgjidhni parametrin që dëshironi dhe shtypni .**

Parametri	Shpjegimi
Auto	Kur televizori është i ndezur ndërkohë që marrësi është në modalitet pritjeje, marrësi nxjerr sinjale HDMI nga foleja e marrësit HDMI OUT A. Sony e rekomandon këtë cilësim nëse përdorni një televizor të përshtatshëm me „BRAVIA“ Sync. Ky cilësim kursen energji në modalitetin në pritje, krahasuar me cilësimin „On“.

- COAX

Shfaqet vetëm kur hyrjes i caktohet një fole koaksiale dhe që e zgjedh automatikisht folenë koaksiale të hyrjes.

- ANALOG

Specifikon hyrjen e sinjaleve analoge audio në folëtë AUDIO IN (L/R).

Shënime

- Bazuar në hyrjen, „-----“ shfaqet në dritaren e ekranit dhe modalitetet e tjera nuk mund të zgjidhen.
- Kur përdoret „2ch Analog Direct“ ose, hyrja audio vendoset në „Analog“. Nuk mund të zgjidhni modalitete të tjera.

Përdorimi i foleve të tjera të hyrjes video/audio

Mund të caktoni sërish sinjalet video dhe/ose audio në folëtë e tjera hyrëse.

Shembull) Lidhni folenë OPTICAL OUT e luajtësit të DVD-së me folenë OPTICAL IN 1 të marrësit kur doni të fusni sinjalet e vetme dixhitale optike audio nga luajtësi i DVD-së. Lidhni folenë video Component të luajtësit të DVD-së me folëtë COMPONENT VIDEO IN 1 ose COMPONENT VIDEO IN 2 të marrësit kur doni të fusni sinjalet video nga luajtësi i DVD-së.

- 1 Zgjidhni „Settings“ nga menyuja kryesore dhe shtypni .**
- 2 Zgjidhni „Input Settings“ dhe shtypni .**
- 3 Zgjidhni „Video Input Assign“ ose „Audio Input Assign“ dhe shtypni .**
- 4 Zgjidhni sinjalet audio dhe/ose video që doni t'i caktoni çdo hyrjeje.**

Shënime

- Nëse caktoni një hyrje në një nga folëtë HDMI IN 1 në IN 8 në „Video Input Assign“ ose „Audio Input Assign“, e njëjta fole hyrjeje HDMI i caktohet edhe hyrjes video, ashtu dhe audio. Nëse doni të caktoni një fole HDMI IN të hyrja video ose audio, caktoni në fillim një hyrje në ndonjë nga folëtë HDMI IN 1 në IN 8 në „Video Input Assign“ ose „Audio Input Assign“. Pastaj, caktoni një fole HDMI IN në „None“, ose në „Video Input Assign“, ose „Audio Input Assign“, për cilëndo që nuk doni t'i caktoni një fole HDMI IN.
- Kur e përdorni marrësin pa përdorur GUI, mund ta ndryshoni caktimin e një foleje HDMI IN me anë të „H.V. ASSIGN“ ose „H.A. ASSIGN“ në „INPUT“ (faqe 107).
- Nëse e ndryshoni caktimin e një foleje HDMI IN ndërkohë që komanda për funksionin HDMI po përdoret, ndërroni hyrjen e marrësit të hyrja në të cilën është lidhur pajisja HDMI. Në të kundërt, komanda për funksionin HDMI mund të mos funksionojë siç duhet.
- Nëse e caktoni një fole HDMI IN në „None“ tek të dyja „Video Input Assign“ dhe „Audio Input Assign“, nuk mund t'i zgjidhni sinjalet e hyrjes nëpërmjet hyrjes HDMI. Në këtë rast, komanda për funksionin HDMI funksionon vetëm në pajisje dhe jo te marrësi. Megjithatë, kjo nuk tregon defekt.

Emri i hyrjes		BD	DVD	GAME	SAT/CATV	VIDEO 1	VIDEO 2	VIDEO 3	VIDEO 4	SA-CD/CD
Foletë e caktueshme për hyrjen video	COMPONENT IN 1 (DVD)	○	○*	○	○	○	○	○	○	○
	COMPONENT IN 2 (SAT/CATV)	○	○	○	○*	○	○	○	○	○
	HDMI IN 1 (VIDEO 1)	○	○	○	○	○*	○	○	○	○
	HDMI IN 2 (BD)	○*	○	○	○	○	○	○	○	○
	HDMI IN 3 (SA-CD/CD)	○	○	○	○	○	○	○	○	○*
	HDMI IN 4 (GAME)	○	○	○*	○	○	○	○	○	○
	HDMI IN 5 (DVD)	○	○*	○	○	○	○	○	○	○
	HDMI IN 6 (SAT/CATV)	○	○	○	○*	○	○	○	○	○
	HDMI IN 7 (VIDEO 3)	○	○	○	○	○	○	○*	○	○
	HDMI IN 8 (VIDEO 4)	○	○	○	○	○	○	○	○*	○
Foletë e caktueshme të hyrjes audio	OPTICAL IN 1 (SAT/CATV)	○	○	○	○*	○	○	○	○	○
	OPTICAL IN 2 (TV)	○	○	○	○	○	○	○	○	○
	COAXIAL (DVD)	○	○*	○	○	○	○	○	○	○
	HDMI IN 1 (VIDEO 1)	○	○	○	○	○*	○	○	○	○
	HDMI IN 2 (BD)	○*	○	○	○	○	○	○	○	○
	HDMI IN 3 (SA-CD/CD)	○	○	○	○	○	○	○	○	○
	HDMI IN 4 (GAME)	○	○	○*	○	○	○	○	○	○
	HDMI IN 5 (DVD)	○	○*	○	○	○	○	○	○	○
	HDMI IN 6 (SAT/CATV)	○	○	○	○*	○	○	○	○	○
	HDMI IN 7 (VIDEO 3)	○	○	○	○	○	○	○*	○	○
	HDMI IN 8 (VIDEO 4)	○	○	○	○	○	○	○	○*	○

* cilësimi i parazgjedhur i fabrikës

Shënime


- Kur caktoni hyrjen dixhitale audio, cilësimi i INPUT MODE mund të ndryshojë automatikisht.
- Kur caktoni hyrjen video në hyrjen Component ose Composite dhe hyrjen audio në hyrjen HDMI, sinjalet e videos Component ose Composite nuk nxirren nga foletë HDMI OUT. Sinjalet e videos Component ose Composite nxirren nga foletë COMPONENT VIDEO MONITOR OUT ose nga foleja MONITOR VIDEO OUT.

- Mund të caktoni fole të ndryshme HDMI në fole të veçanta të hyrjes video dhe audio të një hyrjeje.
- Mund të caktoni shumë hyrje në të njëjtën fole HDMI IN. Sidoqoftë, nëse përdorni funksionin One-Touch Play në pajisjen e lidhur me folenë HDMI IN, zgjidhet në mënyrë të preferuar hyrja që është caktuar më së fundmi.

Pamje paraprake për HDMI

Mund të aktivizoni shikimin e një pamjeje paraprake figurë-në-figurë të hyrjeve HDMI të lidhura në këtë marrës. Shfaqen deri në katër dritare të pamjes paraprake për hyrjet HDMI IN 1/IN 2/IN 3/IN 4.

Çdo pamje paraprake të sinjalit hyrës HDMI mund ta zgjidhni me anë të telekomandës.



Këshilla

- Ky funksion nuk punon në kushtet e mëposhtme:
 - Pajisja HDMI nuk është e lidhur.
 - Është lidhur një pajisje specifike HDMI ndërkohë që është e fikur.
 - Ka hyrje në format video HDMI të pambështetur (p.sh. VGA, 480i, 576i, 4K, lloje specifike të sinjaleve 3D, ose sinjale nga një videokamera, etj.).
 - Hyrja aktuale nuk është hyrje HDMI.
 - Kur afshohet menyja GUI
 - Kur „Zone2 Out“ caktohet në „On“
 - Kur „Fast View“ caktohet në „Off“
- Dritarja e pamjes paraprake figurë-në-figurë të hyrjes HDMI do të tregojë një ekran të zi në kushtet e mëposhtme:
 - Ka hyrje sinjali në format HDMI të pambështetur (p.sh. 4K, llojet specifike të sinjaleve 3D, etj.)
- Funksioni mundësohet nga teknologjia Silicon Image InstaPrevue™.

1 Shtypni PREVIEW (HDMI).

Shfaqen deri në 4 dritare PIP, ku secila prej tyre tregon fotografi të futura nga foletë HDMI IN.

2 Për të ndërruar fotografitë në një dritare PIP me ato në ekranin kryesor, shtypni ↑/↓ për të zgjedhur dritaren e dëshiruar PIP dhe shtypni ⊕.

Hyrja HDMI e dritares së zgjedhur PIP afshohet në dritaren kryesore.

Përdorimi i marrësit me anë të një celulari smartphone


Marrësin mund ta komandoni me anë të një celulari smartphone me softuer aplikacioni „ES Remote“. Softueri i aplikacionit „ES Remote“ mund të shkarkohet nga App Store (për iPod touch/iPhone) ose Google Play (për telefon Android) falas.

Ruajtja e cilësimeve të ndryshme të marrësit dhe rikthimi i njëkohshëm i të gjitha atyre cilësimeve (Easy Automation)

Mund t'i ruani cilësimet e ndryshme të luajtësit ose monitorit, njësoj si cilësimet e funksioneve të marrësit. Mund t'i regjistroni këto cilësime për funksionimin e „one-touch“ dhe pastaj të riktheni lehtësisht gjendjen e krijuar me këto cilësime, në mënyrë që të keni zërin dhe pamjen e duhur në shtëpi.

Për shembull, kur i ruani cilësimet në skenën „1: Movie“ si më poshtë, mund t'i ndryshoni cilësimet e marrësit të gjitha njëkohësisht nëpërmjet një funksioni të thjeshtë, me një prekje, pa e ndërruar çdo cilësim individualisht për „Input“, „Calibration Type“, „Sound Field“ dhe „HDMI Out“.

Elementi i cilësimit	Vlera e caktuar për „1: Movie“
Input	BD
Calibration Type	No Change
Sound Field	HD-D.C.S.
HDMI Out	HDMI OUT B
Party Mode	ON



Elementet për të cilat mund t'i ruani ndryshimet dhe vlerat e parazgjedhura për secilin element janë si më poshtë.

Elementi i cilësimit	Vlera e parazgjedhur			
	1: Movie	2: Music	3: Party	4: Night
Input	BD	SA-CD/CD	No Change	No Change
Tuner Preset	–	–	–	–
Player Operation	Play	Play	Play	–
Interval	30s	10s	10s	–
Sound Field	HD-D.C.S.	Berlin Philharmonic Hall	Multi Stereo	No Change
Sleep	No Change	No Change	Off	30 min.
Volume	No Change	No Change	–10 dB	–30 dB
HDMI Out	No Change	No Change	No Change	No Change

Elementi i cilësimit	Vlera e parazgjedhur			
	1: Movie	2: Music	3: Party	4: Night
Party Mode	No Change	No Change	On	No Change
Calibration Type	No Change	No Change	No Change	No Change
Sound Optimizer	No Change	No Change	Off	Normal
Equalizer (All)	No Change	No Change	No Change	No Change
Equalizer (Front)	No Change	No Change	No Change	No Change
Equalizer (Center)	No Change	No Change	No Change	No Change
Equalizer (SUR/SB)	No Change	No Change	No Change	No Change
Equalizer (Front High)	No Change	No Change	No Change	No Change
Main Zone 12V Trigger	No Change	No Change	No Change	No Change

Rikthimi i cilësimeve të ruajtura në Scene

- 1 Zgjidhni „Easy Automation“ nga menyja kryesore dhe shtypni .
- 2 Zgjidhni një Scene që dëshironi dhe shtypni .

Rikthimi i cilësimeve në një Scene

- 1 Zgjidhni „Easy Automation“ nga menyja kryesore dhe shtypni .
- 2 Zgjidhni një Scene për të cilën doni të ruani cilësimet nga „1: Movie“, „2: Music“, „3: Party“ ose „4: Night“ dhe shtypni **TOOLS/OPTIONS**.
- 3 Zgjidhni menynë që dëshironi dhe shtypni .

Menyja	Shpjegimi
Edit a saved Scene	Ju lejon që të personalizoni dhe të ruani cilësimet që i përshtaten preferencave tuaja.
Import Current Settings	Ngarkon cilësimet aktuale të marrësit dhe i ruan këto cilësime të cilësimit në ekranin e redaktimit për të caktuar „No Change“.

Shënime


- Elementet e cilësimeve të ruajtura si „No Change“ nuk ndryshohen nga cilësimet aktuale, edhe kur riktheni Scene. Zgjidhni „Edit a saved Scene“, pastaj hiqni shenjën nga kutia e elementit të cilësimit në ekranin e redaktimit për të caktuar „No Change“.
- Kur riktheni Scene, cilësimet që nuk mund të aplikohen shpërfillen.
- Kur „Main Zone 12V Trigger“ vendoset në „ON“ ose „OFF“ në vend të „No Change“, „12V Trigger“ e Zone Setup do të ndryshohet automatikisht në „Ctrl“.

Këshillë

Mund ta riktheni cilësimin(cilësimet) e ruajtur për „1: Movie“ ose „2: Music“ drejtpërdrejt duke shtypur EASY AUTOMATION 1 ose EASY AUTOMATION 2 te telekomanda. Mund të mbivendosni gjithashtu „1: Movie“ ose „2: Music“ me cilësimet aktuale duke mbajtur shtypur EASY AUTOMATION 1 ose EASY AUTOMATION 2 për 3 sekonda, në të njëjtën mënyrë sikur zgjidhni „Import Current Settings“ nga menyja.

Përdorimi i kohëmatësit të fjetjes

Mund ta caktoni marrësin të fiket automatikisht në një kohë të specifikuar.



Shtypni SHIFT dhe shtypni SLEEP.

Sa herë që shtypni SLEEP, ekranin ndryshon në mënyrë ciklike si më poshtë:

0:30:00 → 1:00:00 → 1:30:00 → 2:00:00 → OFF

Kur është në përdorim kohëmatësi i fjetjes, SLEEP ndizet në dritaren e ekranit të marrësit. Për të kontrolluar kohën e mbetur përpara se marrësi të fiket, shtypni SLEEP. Koha e mbetur shfaqet në dritaren e ekranit. Nëse shtypni sërish SLEEP, kohëmatësi i fjetjes caktohet në „OFF“.

Regjistrimi me anë të marrësit

Mund të regjistroni nga një pajisje audio/video me anë të marrësit. drejtojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjen e regjistrimit.


- 1 Zgjidhni „Watch“ ose „Listen“ nga menyja kryesore dhe shtypni .**
- 2 Zgjidhni pajisjen e luajtjes dhe shtypni .**
- 3 Përgatitni pajisjen për luajtje.**
Për shembull, vendosni videokasetën që dëshironi të kopjoni në VCR.
- 4 Përgatitni pajisjen regjistruese.**
Futni një videokasetë bosh etj. në pajisjen regjistruese (VIDEO 1) për regjistrim.
- 5 Filloni regjistrimin në pajisjen regjistruese, më pas nisni pajisjen riprodhuese.**

Ndërrimi i modalitetit të komandës së marrësit dhe telekomandës

Mund ta ndërroni modalitetin e komandës (COMMAND MODE AV1 ose COMMAND MODE AV2) të marrësit dhe telekomandës. Ndërroni modalitetin e komandës nga cilësimi i parazgjedhur i fabrikës në cilësimin e përshtatshëm nëse është përdorur aksidentalisht një pajisje tjetër Sony nga e njëjta telekomandë, kur e përdorni marrësin me anë të telekomandës së dhënë për marrësin. Modalitetet e komandës për marrësin dhe telekomandën janë ato të cilësimeve të parazgjedhura të fabrikës (COMMAND MODE AV2).

Marrësi dhe telekomanda, në anën tjetër, duhet të përdorin të njëjtin modalitet të komandës. Nëse modalitetet e komandës së marrësit dhe telekomandës janë të ndryshme, nuk mund ta përdorni telekomandën për të përdorur marrësin.


Ndërrimi i modalitetit të komandës së marrësit



- 1 Shtypni I/⏻ për të fikur marrësin.**
- 2 Ndërkohë që mbani shtypur 2CH/A.DIRECT, shtypni I/⏻ për të ndezur marrësin.**

Kur modaliteti i komandës caktohet në „AV2“, në ekran shfaqet „C. MODE AV2“. Kur modaliteti i komandës caktohet në „AV1“, në ekran shfaqet „C. MODE AV1“.

Ndërrimi i modalitetit të komandës së telekomandës




- 1 Shtypni I/⏻ ndërkohë që shtypni RM SET UP.**
Butoni The SHIFT ndizet, dhe butoni RM SET UP pulson.
- 2 Shtypni butonin numerik 1 ose 2 ndërkohë që butoni RM SET UP pulson.**
Kur shtypni 1, modaliteti i komandës caktohet në COMMAND MODE AV1. Kur shtypni 2, modaliteti i komandës caktohet në COMMAND MODE AV2. Butoni RM SET UP ndizet.
- 3 Shtypni ENT/MEM.**
Butoni RM SET UP pulson dy herë dhe pas kësaj procesi i caktimit të modalitetit të komandës përfundon.

Përdorimi i veçorive të tjera

Përdorimi i një lidhjeje me dy amplifikatorë

Nëse nuk po përdorni altoparantë rrethues të pasmë dhe altoparantë të lartë të përparmë, mund të përdorni терминаlet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 për altoparantët përballë, që të përdoren me lidhjen me dy amplifikatorë.

Lidhja e altoparantëve



Lidhni foletë në anën Lo (ose Hi) të altoparantëve përballë me терминаlet FRONT A dhe lidhni foletë në anën Hi (ose Lo) të altoparantëve përballë me терминаlet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2. Sigurohuni që vrimat metalike Hi/Lo të ngjitura te altoparantët janë hequr, për të shmangur keqfunksionimin e marrësit.

Konfigurimi i altoparantëve


Për hollësi shihni „Speaker Connection“ në menynë Speaker Settings (faqe 86).

Shënime

- Kryeni cilësimet e dy amplifikatorëve përpara se të kryeni funksionin Auto Calibration.
- Nëse kryeni cilësimet e dy amplifikatorëve, niveli i altoparantëve, ekuilibri dhe cilësimet e barazuesit të altoparantëve rrethues të pasmë dhe altoparantëve të lartë të përparmë bëhen të pavlefshme dhe përdoren ato të altoparantëve të përparmë.
- Nëse modeli i altoparantëve është caktuar në mënyrë të tillë që të ketë altoparantë rrethues të pasmë dhe altoparantë të lartë të përparmë, nuk mund t'i caktoni терминаlet e SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 për lidhje me dy amplifikatorë.
- Kur e përdorni marrësin pa përdorur GUI, caktojeni „SB ASSIGN“ në „BI-AMP“ në „SPEAKER“ (faqe 106).

Kthimi në cilësimet e parazgjedhura të fabrikës

Mund të pastroni të gjitha cilësimet e memorizuara dhe ta ktheni marrësin në cilësimet e parazgjedhura të fabrikës duke kryer procedurën e mëposhtme. Kjo procedurë mund të përdoret gjithashtu për ta nisur marrësin, përpara se ta përdorni për herë të parë.



1 Shtypni I/⏻ për të fikur marrësin.

2 Ndërkohë që mbani shtypur TONE MODE dhe 2CH/A.DIRECT, shtypni I/⏻ për të ndezur marrësin.

3 Lëshoni TONE MODE dhe 2CH/A.DIRECT pas pak sekondash.

„CLEARING...” shfaqet për pak kohë në dritaren e ekranit, pastaj ndryshon në „CLEARED!”

Ndryshimet ose përshtatjet që i janë bërë cilësimeve, tani rikthehen në cilësimet e parazgjedhura.


Shënim

Pastrimi i plotë i memories zgjat pak minuta. Mos e fikni marrësin derisa në ekran të shfaqet „CLEARED!”.

Rregullimi i cilësimeve


Përdorimi i menysë së cilësimeve

Mund të rregulloni cilësimet e ndryshme për altoparlantët, efektet shumëkanalëshe, të zonës së shumëfishtë etj. me anë të menysë së cilësimeve.




1 Zgjidhni „Settings” nga menyja kryesore dhe shtypni për të hyrë në modalitetin e menysë.

Lista e menysë së cilësimeve shfaqet në ekranin e televizorit.



2 Zgjidhni elementin e menysë që dëshironi dhe shtypni për të hyrë tek elementi i menysë.

Shembull: Kur zgjidhni „Audio Settings”.



3 Zgjidhni parametrin që dëshironi dhe shtypni për të hyrë.


Për t'u kthyer në ekranin e mëparshëm

Shtypni RETURN/EXIT .

Për të dalë nga menyja

Shtypni HOME për të shfaqur menyën kryesore dhe shtypni përsëri HOME.

Lista e menysë së cilësimeve



— Network Settings (faq 98)	— Internet Settings
	— Connection Server Settings
	— Renderer Options
	— Renderer Access Control
	— External Control
	— Network Standby
— Internet Services Settings (faq 99)	— Parental Control Password
	— Parental Control Area Code
	— Internet Video Parental Control
	— Internet Video Unrated
— Zone Settings (faq 100)	— Zone Control
	— Zone Setup
— System Settings (faq 101)	— Language
	— Auto Standby
	— Settings Lock
	— RS232C Control
	— Software Update Notification
	— Initialize Personal Information
	— System Information
	— EULA
	— Software License
— Network Update (faq 102)	

Easy Setup

Riekzekuton Easy Setup për të kryer cilësimet bazë. Ndiqni udhëzimet në ekran (faqe 41).

Speaker Settings

Mund të caktoni automatikisht ose manualisht mjedisin tuaj të pamjes (me sistemin e altoparlantit që po përdorni).

Auto Calibration

Kryen funksionin D.C.A.C. (Digital Cinema Auto Calibration). Ky funksion ju lejon që të kryeni kalibrimin automatik, si p.sh. kontrollin e lidhjes mes secilit altoparlant dhe marrësit, rregullimin e nivelit të altoparlantit dhe matjen automatike të distancës së secilit altoparlant nga pozicioni juaj i ndenjes.

Calibration Matching

Kur ekzekutohet Auto Calibration, ky funksion punon automatikisht, duke përputhur distancën dhe nivelin e altoparlantëve djathtas dhe majtas. Mund ta caktoni këtë funksion pasi të ketë përfunduar procesi i matjes DCAC dhe të jenë ruajtur rezultatet e matjes DCAC. Cilësimi është i vlefshëm derisa ta ndryshoni.

Shënim

Rezultatet e matjes së mëparshme do të mbivendosen dhe për pozicionin e zgjedhur aktualisht ruhen rezultatet aktuale. Ju lutemi të lexoni „Shënime mbi Speaker Settings (Auto Calibration)“ në „7: Konfigurimi i marrësit me anë të Easy Setup“ (faqe 41).

Auto Calibration Setup

Ju lejon të regjistroni tre modele për „Position“, në varësi të pozicioneve të ndenjes, mjedisit të dëgjimit dhe kushteve të matjes. Mund të zgjidhni gjithashtu një lloj kalibrimi për të kompensuar çdo altoparlant.

Position

Mund të regjistroni më shumë se një grup cilësimesh për mjedisin e dëgjimit ose të riktheni grupin e cilësimeve.

Zgjidhni „Position“ për të cilin doni të regjistroni rezultatet e matjes në ekranin Auto Calibration Setup.

- Pos.1
- Pos.2
- Pos.3

Për të caktuar një lloj kompensimi për altoparlantët

Mund të zgjidhni llojin e kompensimit që do të përdoret për altoparlantët e secilit Position.

- 1 Zgjidhni „Position“ për të cilin doni të caktoni llojin e kompensimit të altoparlantëve dhe shtypni (+).
 - Full Flat
Kryen matjen e frekuencës nga çdo altoparlant në nivel.
 - Engineer
Cakton frekuencën që do të përshtatet me standardin e Sony për dhomën e dëgjimit.
 - Front Reference
Përshtat karakteristikat e të gjithë altoparlantëve, që t'u përputhen karakteristikave të altoparlantëve përballë.
 - Off
Fik EQ-në e Auto Calibration.

Shënim

Nuk mund ta caktoni „Calibration Type“ për „Position“, rezultatet e matjes të së cilës nuk janë regjistruar.

Për të emërtuar Position

- 1 Zgjidhni „Position“ të cilin doni ta emërtoni dhe shtypni (+).
- 2 Zgjidhni „Name In“ dhe shtypni (+).
Në ekran shfaqet tastiera virtuale.
- 3 Shtypni ▲/▼/◀/▶ dhe (+) për të zgjedhur nga një karakter.

Automatic Phase Matching

Ju lejon të caktoni funksionin A.P.M. (Automatic Phase Matching) në funksionin D.C.A.C. (Digital Cinema Auto Calibration) (faqe 85).

Kalibron karakteristikat e fazës së altoparlantëve dhe garanton një hapësirë të mirëkoordinuar shumëkanalëshe.

■ Off

Nuk e aktivizon funksionin A.P.M.

■ Auto

Fik ose ndez automatikisht funksionin A.P.M.

Shënime

- Ky funksion nuk punon në rastet e mëposhtme.
 - Kur është në përdorim „2ch Analog Direct“.
 - Kufjet janë lidhur.
 - „Auto Calibration“ nuk është kryer.
- Marrësi mund të luajë sinjale në frekuencë më të ulët modulimi se frekuenca aktuale e modulimit të sinjaleve hyrëse, në varësi të formatit audio.

Speaker Connection

Ju lejon të rregulloni manualisht çdo altoparlant. Mund të rregulloni gjithashtu nivelet e altoparlantit pasi të ketë përfunduar Easy Setup. Speaker Settings janë vetëm për „Position“ aktual.

Mund të kryeni cilësimet e mëposhtme me anë të ekspertit.

Speaker Pattern

Ju lejon të zgjidhni motivin e altoparlantëve për sistemin e altoparlantëve që po përdorni.

Surround Back Assign

Ju lejon të caktoni terminalet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 për dy amplifikatorët ose një lidhje të zonës 2.

■ Zone2 Speakers

■ Bi-Amplifier

■ Front B

■ No Assign

Shënim

Nëse modeli i altoparlantëve është caktuar në mënyrë të tillë që të ketë altoparlantë rrethues të pasmë ose altoparlantë të lartë të përparmë, nuk mund t'i caktoni termialet e SURROUND BACK/ FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 për lidhje me dy amplifikatorë ose me një zonë 2.

Center Speaker Lift Up

Me përdorimin e altoparlantëve lart përballë, mund të ngrini zërin e altoparlantit qendror në nivelin e duhur nga ekrani, duke lejuar shikimin e paraqitjes natyrale, pa shqetësime.

■ 1~10

■ Off

Shënim

- Ky funksion nuk punon në rastet e mëposhtme.
 - Kufjet janë lidhur.
 - Nuk ka altoparlant qendror.
 - Nuk ka altoparlantë të lartë të përparmë.
 - Përdoret fusha e tingullit me modalitetin 2CH.
 - Përdoret fusha e tingullit për muzikën.
 - Përdoret fusha e tingullit „Multi Stereo“.

Speaker Setup

Ju lejon të rregulloni manualisht çdo altoparlant në ekranin Konfigurimi manual. Mund të rregulloni gjithashtu nivelet e altoparlantit pasi të ketë përfunduar „Auto Calibration“.

Zgjidhni „Level/Distance/Size“ dhe shtypni (+).

Për të rregulluar nivelin e altoparlantëve

Mund të rregulloni nivelin e çdo altoparlantit (qendror, shumëkanalësh majtas/djathtas, shumëkanalësh mbrapa majtas/djathtas, përpara lart majtas/djathtas/bas).

1 Zgjidhni altoparlantin në ekranin që doni të rregulloni nivelin dhe shtypni (+).

2 Zgjidhni „Level“ dhe shtypni (+).
Mund ta rregulloni nivelin nga -20 dB në +10 dB në intervale 0,5 dB.
Mund të rregulloni nivelin përpara majtas nga FL-10,0 dB në FL+10,0 dB në intervale 0,5 dB. Mund të zgjidhni gjithashtu nivelin përpara djathtas nga FR-10,0 dB në FR+10,0 dB në intervale 0,5 dB.

Rregullimi i distancës nga pozicioni i ndenjes deri në secilin altoparlant

Mund të rregulloni distancën nga pozicioni i ndenjes në secilin altoparlant (përballë majtas/djathtas, qendror, shumëkanalësh majtas/djathtas, shumëkanalësh mbrapa majtas/djathtas, përpara lart majtas/djathtas, bas).

1 Zgjidhni altoparlantin në ekranin që doni të rregulloni distancën dhe shtypni (+).

2 Zgjidhni një „Distance“ dhe shtypni (+).
Mund ta rregulloni distancën në intervale nga 1,0 metër në +10,0 metra (3 këmbë 3 inç deri 32 këmbë 9 inç) në 1 cm (1 inç).

Për të rregulluar madhësinë e secilit altoparlant

Mund të rregulloni madhësinë e çdo altoparlantit (përballë majtas/djathtas, qendror, rrethues majtas/djathtas, rrethues mbrapa majtas/djathtas, përpara lart majtas/djathtas).

1 Zgjidhni altoparlantin në ekranin që doni të rregulloni madhësinë dhe shtypni (+).

2 Zgjidhni një „Size“ dhe shtypni (+).

• Large

Nëse lidhni altoparlantë të mëdhenj që do të riprodhojnë me efikasitet frekuencat e basit, zgjidhni „Large“. Normalisht, zgjidhni „Large“.

- Small

Nëse zëri është i deformuar ose nëse ndieni mungesën e efekteve shumëkanalëshe kur përdorni zë shumëkanalësh, zgjidhni „Small“ për të aktivizuar qarkun e ridrejtimt të basit dhe nxirrni frekuencat e basit për çdo kanal të altoparlantit bas ose altoparlantëve të tjerë „Large“.

Shënime

- Kur lidhen kufjet, Size dhe Distance nuk mund të caktohen.
- Altoparlantët shumëkanalësh mbrapa do të caktohen me të njëjtat cilësime si dhe altoparlantët shumëkanalësh.
- Kur altoparlantët përballë caktohen në „Small“, altoparlantët qendrorë, shumëkanalësh, shumëkanalësh mbrapa dhe altoparlantët përballë lart caktohen automatikisht në „Small“.
- Nëse nuk e përdorni basin, altoparlantët përballë caktohen automatikisht në „Large“.

Për të rregulluar frekuencën e kryqëzimit të secilit altoparlant

Ju lejon që të caktoni frekuencën e kryqëzimit të basit të altoparlantëve që janë caktuar në „Small“ në menynë Size. Frekuenca e matur e kryqëzimit të altoparlantëve është caktuar për çdo altoparlant pas „Auto Calibration“.

- 1 Zgjidhni „Crossover Frequency“ dhe shtypni (+).
- 2 Zgjidhni altoparlantin në ekranin që doni të rregulloni frekuencën e kryqëzimit.
- 3 Caktoni frekuencën e kryqëzimit të altoparlantit të zgjedhur.

Shënime

- Kur lidhen kufjet, ky funksion nuk punon.
- Altoparlantët rrethues të përparmë do të caktohen me të njëjtat cilësime si dhe altoparlantët rrethues.

Test Tone

Ju lejon të zgjidhni llojin e zërit të testimit në ekranin Test Tone.

Nxjerrja e zërit të testimit nga çdo altoparlant

Mund të nxirrni një zë testimi nga altoparlantët në sekuencë.

- 1 Zgjidhni „Test Tone“ dhe shtypni (+). Shfaqet ekрани Test Tone.
- 2 Rregulloni parametrin dhe shtypni (+).
 - Off
 - AutoTingulli i testimit nxirret nga çdo altoparlant në sekuencë.
 - L, C, R, SR, SL, SB*, SBL, SBR, LH, RH, SW * „SB“ shfaqet kur është lidhur vetëm një altoparlant shumëkanalësh mbrapa.Mund të zgjidhni se cilët altoparlantë do ta nxjerrin zërin e testimit.
- 3 Rregulloni „Level“ dhe shtypni (+).

Nxjerrja e një zëri testimi nga altoparlantët ngjitur

Mund të nxirrni një zë testimi nga altoparlantët ngjitur në mënyrë që të rregulloni ekuilibrin mes altoparlantëve.

- 1 Zgjidhni „Phase Noise“ dhe shtypni (+). Shfaqet ekрани Phase Noise.
- 2 Rregulloni parametrin dhe shtypni (+).
 - Off
 - FL/FR, FL/CNT, CNT/FR, FR/SR, SR/SBR, SR/SB*, SBR/SBL, SR/SL, SB/SL*, SBL/SL, SL/FL, LH/RH, FL/SR, SL/FR, FL/RH, LH/FR * „SR/SB“ dhe „SB/SL“ shfaqen kur lidhet vetëm një altoparlant shumëkanalësh mbrapa.Ju lejon të nxirrni zërin e testimit në sekuencë nga altoparlantët ngjitur. Disa elemente mund të mos shfaqen, në varësi të cilësimeve të modelit të altoparlantit.
- 3 Rregulloni „Level“ dhe shtypni (+).

Nxjerrja e zërit burim nga altoparlantët ngjitur

Mund të nxirrni zërin burim nga altoparlantët ngjitur në mënyrë që të rregulloni ekuilibrin mes altoparlantëve.

1 Zgjidhni „Phase Audio” dhe shtypni . Shfaqet ekrani Phase Audio.

2 Rregulloni parametrin dhe shtypni .

- Off
- FL/FR, FL/CNT, CNT/FR, FR/SR, SR/SBR, SR/SB*, SBR/SBL, SR/SL, SB/SL*, SBL/SL, SL/FL, LH/RH, FL/SR, SL/FR, FL/RH, LH/FR
- * „SR/SB” dhe „SB/SL” shfaqen kur lidhet vetëm një altoparlant rrethues të pasmë.

Ju lejon të nxirrni zërin burim dykanalësh përballë (në vend të zërit të testimit) në sekuencë nga altoparlantët ngjitur.

Disa elemente mund të mos shfaqen, në varësi të cilësimeve të modelit të altoparlantit.

3 Rregulloni „Level” dhe shtypni .

Distance Unit

Ju lejon të caktoni njësinë e matjes për caktimin e distancave.

■ meter

Distanca shfaqet në metra.

■ feet

Distanca shfaqet në këmbë.

Audio Settings

Mund të rregulloni cilësimet e audios që u përshtaten preferencave tuaja.

Digital Legato Linear (D.L.L.)

Funksioni D.L.L. është teknologji e vetë Sony që lejon luajtjen me zë me cilësi të lartë të sinjaleve dixhitale audio me cilësi të ulët dhe sinjaleve analoge audio.

■ Off

■ Auto 1

Ky funksion disponohet për formatet audio të ngjeshura dhe sinjalet audio analoge.

■ Auto 2

Ky funksion disponohet për sinjalet lineare PCM, si dhe për formatet audio të ngjeshura dhe sinjalet audio analoge.

Shënime

- Ky funksion mund të mos punojë, në varësi të përmbajtjes nëpërmjet një pajisjeje USB ose një rrjeti në shtëpi.
- Ky funksion punon kur zgjidhet „A.F.D. Auto”. Megjithatë, ky funksion nuk punon në rastet e mëposhtme.
 - Kur merren sinjale lineare PCM me frekuencë modulimi të ndryshme nga 44,1 kHz.
 - Kur merren sinjale Dolby Digital Plus, Dolby Digital EX, Dolby TrueHD, DTS 96/24, DTS-ES Matrix 6.1, DTS-HD Master Audio ose DTS-HD High Resolution Audio.

Sound Optimizer

Ju lejon të caktoni funksionin e optimizimit të zërit (faqe 60).

■ Off

■ Low

■ Normal

Equalizer

Ju lejon të rregulloni nivelin e basit dhe altos për çdo altoparlant (faqe 61).

Subwoofer Muting

Ju lejon të parandaloni nxjerrjen e sinjaleve nga foletë SUBWOOFER.

■ Off

Foletë SUBWOOFER nxjerrin sinjale.

■ On

Foletë SUBWOOFER nuk nxjerrin sinjale.

Shënim

- Ky funksion nuk punon në rastet e mëposhtme.
 - Kufjet janë lidhur.
 - Kur është zgjedhur „2ch Analog Direct“.
 - Kur është zgjedhur „2ch Stereo“.
 - Zgjidhet një motiv altoparlantësh pa basin.

Dual Mono

Ju lejon të zgjidhni gjuhën që dëshironi kur dëgjoni audion e dyfishtë të një transmetimi dixhital kur mundësohet. Kjo veçori funksionon vetëm për burimet Dolby Digital.

■ Main/Sub

Zëri i gjuhës kryesore do të nxirret nga altoparlanti përballë majtas dhe zëri i nëngjuhës do të nxirret njëkohësisht nga altoparlanti përballë djathtas.

■ Main

Do të dalë zëri i gjuhës kryesore.

■ Sub

Do të dalë zëri i nëngjuhës.

Dynamic Range Compressor

Ju lejon të ngjishni diapazonin dinamik të kolonës zanore. Kjo mund të jetë e dobishme kur dëshironi të shihni filma me volum të ulët natën vonë. Ngjeshja në diapazon dinamik mundësohet vetëm me burimet Dolby Digital dhe Dolby TrueHD.

■ Off

Diapazoni dinamik nuk ngjishet.

■ Auto

Diapazoni dinamik ngjishet automatikisht kur ka një flamur në burimin e zërit që rekomandon Dynamic Range Compressor.

■ On

Diapazoni dinamik ngjishet siç është planifikuar nga inxhinieri regjistruar.

Subwoofer Low Pass Filter

Ju lejon që të ndizni ose të fikni filtrin e kalimit të ulët për nën-vuferin. Mund të caktoni funksionin për çdo hyrje në të cilën është caktuar individualisht foleja e hyrjes së audios. Aktivizoni funksionin nëse lidhni një nën-vufer pa funksionin e kryqëzimit të frekuencës.

■ Off

Nuk e aktivizon filtrin e kalimit të ulët.

■ On

Aktivizon gjithmonë filtrin e kalimit të ulët me një frekuencë prerjeje prej 120 Hz.

Shënim

- Ky funksion nuk punon në rastin e mëposhtëm.
 - Kur është në përdorim „2ch Analog Direct“.

A/V Sync (Sinkronizon daljen audio dhe video)

Ju lejon të vononi daljen e audios për të minimizuar hapësirën kohore mes daljes audio dhe afishimit vizual.

Ky funksion është i dobishëm kur përdorni një monitor të madh LCD ose plazme ose një projektor.

Mund të caktoni individualisht funksionin për çdo hyrje.

■ HDMI Auto

Hapësira kohore mes daljes audio dhe afishimit vizual të monitorit të lidhur nëpërmjet një lidhjeje HDMI do të rregullohet automatikisht, bazuar në informacionin e televizorit. Kjo veçori disponohet vetëm kur monitori mbështet funksionin A/V Sync.

■ 0 ms – 300 ms

Mund ta rregulloni vonesën nga 0 ms në 300 ms në intervale 10 ms.

Shënim

Në varësi të formatit audio, marrësi mund të luajë sinjale në frekuencë më të ulët modulimi se frekuenca aktuale e modulimit të sinjaleve hyrëse.

Decode Priority (Prioritet i dekodimit të hyrjes së audios dixhitale)

Ju lejon të specifikoni modalitetin e hyrjes për hyrjen e sinjalit dixhital në folëtë DIGITAL IN ose në folëtë HDMI IN.

Mund të caktoni individualisht funksionin për çdo hyrje.

■ PCM

Kur zgjidhen sinjalet nga foleja DIGITAL IN, prioritet u jepet sinjaleve PCM (për të parandaluar ndërprerjen kur nis luajtja). Megjithatë, kur nxirren sinjale të tjera, mund të mos ketë zë, në varësi të formatit. Në këtë rast, caktojeni këtë element në „Auto“.

Kur zgjidhen sinjalet nga foleja HDMI IN, nga luajtësi i lidhur dalin vetëm sinjale PCM. Kur merren sinjale në format tjetër, caktojeni këtë element në „Auto“.

■ Auto

Ndërron automatikisht modalitetin e hyrjes mes Dolby Digital, DTS ose PCM.

Shënime

- Ky funksion nuk punon në rastet e mëposhtme.
 - Zgjidhet modaliteti i hyrjes analoge.
 - Kur është në përdorim „2ch Analog Direct“.
- Edhe kur „Decode Priority“ caktohet në „PCM“, fillimi i zërit mund të mos dalë për shkak të luajtjes së sinjaleve në CD.

Sound Field

Ju lejon të zgjidhni një efekt zanor që zbatohet për sinjalet e futura. Për hollësi shihni „Shijimi i efekteve zanore“ (faqe 56).

Mund të caktoni individualisht funksionin për çdo hyrje.

Video Settings

Mund të rregulloni cilësimet për videon.

Resolution (Konvertimi i sinjaleve video)

Ju lejon të konvertoni rezolucionin e sinjaleve të hyrjes analoge të videos dhe të nxirrni sinjalet e konvertuara.

■ Direct

Ju lejon të nxirrni direkt sinjalet e hyrjes analoge të videos.

■ 480p/576p

■ 720p

■ Auto

- Ky fenomen është specifik për këtë amplifikator. Kjo nuk tregon defekt. Nëse „Control for HDMI“ ose „Network Standby“ është vendosur te „On“, ose „Pass Through“ është vendosur te „On“, ose „Auto“, aktivizohet energjia për zonën 2 dhe pjesa e sipërme e marrësit mund të nxehtet edhe kur marrësi është në modalitet gatishmërie. Kjo gjendje

krijohet për shkak të qarkullimit të rrymës në qarqet e brendshme të marrësit dhe kjo është diçka normale.

Video

Në monitor ose në ekranin e televizorit nuk shfaqet figurë ose figura është e paqartë, pavarësisht llojit të figurës.

- Zgjidhni llojin e duhur të hyrjes në marrës (faqe 46).
- Vendosni televizorin në modalitetin e duhur të hyrjes.
- Zhvendosni televizorin larg nga pajisjet audio.
- Caktoni saktë hyrjen e videos komponent (faqe 73).
- Sinjali hyrës duhet i jetë i njëjtë me llojin e hyrjes kur ju konvertoni një sinjal hyrës me këtë marrës (faqe 19).
- Sigurohuni që kabllojt janë lidhur mirë dhe saktë me pajisjet.
- Në varësi nga lloji i pajisjes luajtëse, mund të jetë e nevojshme që pajisjet të konfigurohen. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjet.

Figura shfaqen më vonë se zëri përkatës i saj.

- Në varësi nga lloji i pajisjes së lidhur në folenë HDMI ose nga burimi i materialit të luajtur, figura mund të shfaqen më vonë se zëri përkatës i saj. Në këtë rast, ndryshoni cilësimin e „A/V Sync“ në menynë Audio Settings (faqe 91).

Regjistrimi nuk mund të kryhet.

- Kontrolloni nëse pajisja është lidhur saktë (faqe 28).
- Zgjidhni pajisjen e burimit (faqe 46).
- Kontrolloni lidhjen e anës së regjistrimit sipas sinjaleve video që dëshironi të regjistroni. Sinjalet hyrëse analoge (video e përbërë) mund të nxirren vetëm nga foletë dalëse analoge.
- Sinjalet hyrëse video që hyjnë nëpërmjet foleve HDMI IN nuk mund të regjistrohen.

vazhdon

- Burimet përmbajnë mbrojtje të të drejtave të autorit për të penguar regjistrimin. Në këtë rast, mund të mos jeni në gjendje të regjistroni nga burimet.
- Vendosni „Auto Standby“ në „Off“ (faqe 101). Ndërkohë që regjistrohen vetëm sinjale video të përbërë, mund të aktivizohet funksioni i pritjes automatike të marrësit dhe mund të ndërpresë regjistrimin.

Një lloj i veçantë figure nuk del ose del i dëmtuar.

Dalja Component video

- Rezolucioni i sinjaleve dalëse nga foleja COMPONENT VIDEO OUT mund të mos mbështetet nga televizori juaj. Në këtë rast, zgjidhni rezolucionin e duhur në marrës (faqe 92).
- Fole të COMPONENT VIDEO MONITOR OUT kanë kufizime për rezolucionin kur konvertohet rezolucioni i sinjaleve video që mbrohen nga teknologjia për të drejtën e autorit. Rezolucioni i daljes së sinjaleve në fole të COMPONENT VIDEO MONITOR OUT konvertohet deri në 480p/576p.

Dalja HDMI

- Dalja e sinjaleve video HDMI të marrësit mund të vendoset te „OFF“. Në këtë rast, zgjidhni „HDMI A“ ose „HDMI B“ me anë të butonit HDMI OUTPUT (faqe 71).
- Kur „Zone2 Out“ vendoset te „Off“, nga HDMI ZONE 2 nuk do të dalë asnjë sinjal.
- GUI sinjalet video me rritje të rezolucionit nuk do të dalin nga foleja HDMI ZONE 2 OUT.
- Sinjalet video dhe audio të foleve HDMI IN nuk do të dalin nga foleja HDMI ZONE 2 OUT kur edhe për zonën kryesore, edhe për zonën 2 është zgjedhur e njëjta hyrje dhe kur menyja GUI shfaqet në televizor në zonën kryesore.
- Kur aktivizohet funksioni Zone2 Out dhe zgjidhni të njëjtën hyrje HDMI për zonën kryesore dhe për zonën 2, në sinjalet audio dhe video në zonën kryesore dhe në zonën 2 mund të ketë interferencë.

Për të shmangur interferencën e mundshme në zonën kryesore, mund të caktoni prioritetin në zonën kryesore për zgjedhjen e hyrjes HDMI (faqe 66).

- Sigurohuni të përdorni një kablo bashkuese për folenë HDMI që përpunet me një kablo High Speed HDMI kur dëshironi të shihni figura ose të dëgjoni zërin, në veçanti për transmetimet 1080p, Deep Color, ose 3D ose 4K.

Figura 4K

- Në varësi të televizorit ose të videos, figurat 4K mund të mos shfaqen. Kontrolloni aftësinë video dhe cilësimin e televizorit ose të pajisjes video. Gjithashtu, sigurohuni që ta lidhni videon në një fole të disponueshme 4K HDMI IN të marrësit.

Figura 3D

- Në varësi të televizorit ose të videos, figurat 3D mund të mos shfaqen. Verifikoni formatet e figurës 3D që mbështeten nga marrësi (faqe 130).

VCR

- Nëse përdorni një VCR pa një qark për përmirësimin e figurës, si p.sh. TBC, figura mund të paraqitet e shtrembëruar.

Kur zgjidhni „My Video“, „My Music“, „My Photo“, „Internet Video“, „Internet Music“, „Network“, ose „Sony Entertainment Network“ nga menyja Watch/Listen, nuk ka asnjë dalje figure.

- Fillimisht zgjidhni „BD“ ose „DVD“ në marrës duke përdorur INPUT SELECTOR, pastaj vendoseni „Playback Resolution“ në „480i/576i“ ose „480p/576p“ në menyën Video Settings me anë të GUI (faqe 94) dhe pastaj zgjidhni përsëri përmbajtjen.

Funksioni Pass Through nuk funksionon.

- Është zgjedhur „HDMI B“ ose „Off“. Zgjidhni „HDMI A“ me anë të butonit HDMI OUTPUT.

- Kur „Control for HDMI“ është vendosur te „On“ dhe „Pass Through“ është vendosur te „Auto“, marrësi ul konsumin e energjisë në modalitetin e pritjes sipas statusit të televizorit. Për të aktivizuar kursimin e energjisë, „Control for HDMI“ në televizor duhet të jetë vendosur si efektiv. Nëse nuk është efektiv, vendoseni „Pass Through“ në marrës te „On“.

Audio

Nuk del zë ose dëgjohej një zë me nivel shumë të ulët, pavarësisht se cila pajisje zgjidhet.

- Kontrolloni nëse altoparlantët dhe pajisjet janë lidhur saktë.
- Kontrolloni që marrësi dhe të gjitha pajisjet të jenë ndezur.
- Kontrolloni që komanda MASTER VOLUME nuk është vendosur në $-\infty$ dB. Përpikuni ta vendosni atë te -40 dB.
- Kontrolloni që SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) nuk është vendosur te OFF (faqe 42).
- Shtypni  në telekomandë për të anuluar funksionin e heshtjes.
- Provoni të shtypni butonin e hyrjes në telekomandë ose INPUT SELECTOR në marrës për të zgjedhur pajisjen që dëshironi.
- Kontrolloni që të mos jenë lidhur kufje.
- Kur dëshironi që ta dëgjoni zërin nga altoparlanti i televizorit, vendoseni „Audio Out“ te „TV+AMP“ në menyën HDMI Settings. Nëse vendoset te „AMP“, zëri nuk del përmes altoparlantit të televizorit. Nëse ju merrni nga marrësi tingullin shumëkanalësh, vendoseni te „AMP“.
- Kur aktivizohet funksioni Zone2 Out dhe zgjidhni të njëjtën hyrje HDMI për zonën kryesore dhe për zonën 2, në sinjalet audio dhe video në zonën kryesore dhe në zonën 2 mund të ketë interferencë. Për të shmangur interferencën e mundshme në zonën kryesore, mund të caktoni prioritetin në zonën kryesore për zgjedhjen e hyrjes HDMI (faqe 66).

- Zëri mund të ndërpritet nëse ndërrohet frekuenca e modulimit, numri i kanaleve ose formati audio i sinjaleve audio që dalin nga pajisja luajtëse.
- Vendoseni cilësimin „EQ“ të iPod/iPhone te „Off“ ose „Flat“.

Ka gumëzhitje ose zhurmë të madhe.

- Kontrolloni nëse altoparlantët dhe pajisjet janë lidhur saktë.
- Kontrolloni që kabllo të lidhjes të jenë larg nga një transformator ose motor dhe të paktën 3 metra larg nga ndonjë televizor ose llambë fluoreshente.
- Zhvendosni televizorin larg nga pajisjet audio.
- Fishat dhe foletë janë të papastrat. Fshijini me një copë të lyer paksa me alkool.

Nuk ka asnjë tingull nga altoparlanti(ët) e veçantë.

Përballë

- Lidhni kufjet në folenë PHONES për të verifikuar që në kufje vjen zë. Nëse në kufje ka dalje vetëm nga një kanal, kontrolloni nëse të gjitha kabllo janë futur plotësisht në foletë e tyre, si në marrës, ashtu edhe në pajisje. Nëse në kufje ka dalje nga të dy kanalet, kontrolloni lidhjen e altoparlantit përballë, nga i cili nuk del asnjë tingull.
- Sigurohuni që t'i keni lidhur të dyja foletë L dhe R në një pajisje njëkanalëshe, pajisja analoge kërkon të dyja lidhjet e L dhe R. Përdorni një kablo stereo njëkanalëshe (nuk është dhënë). Megjithatë, në altoparlantin qendror nuk do të ketë fare zë kur zgjidhet një fushë zanore (Pro Logic, etj.).

Altoparlanti(ët) qendrorë/rrethues të pasmë/të përparmë të lartë/të përparmë B

- Kontrolloni nëse cilësimet e altoparlantëve janë ato të duhurat për konfigurimin me anë të „Auto Calibration“ ose „Speaker Connection“ në menynë Speaker Settings. Dhe më pas kontrolloni nëse zëri del si duhet nga çdo altoparlant, me anë të „Test Tone“ në menynë Speaker Settings.
- Zgjidhni fushën zanore „HD-D.C.S.“ (faqe 57).
- Rregulloni nivelin e altoparlantit (faqe 87).
- Sigurohuni që altoparlanti(ët) qendror(ë)/rrethues të pasmë/të përparmë të lartë ka/kanë cilësimin „Small“ ose „Large“.
- Për të përdorur altoparlantët e përparmë B lidhni altoparlantët e përparmë B me terminalet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 dhe vendoseni „Front B“ në menynë „Speaker Connection“.

Rrethues i pasmë

- Disa disqe nuk kanë asnjë informacion Dolby Digital Surround EX.

Nën-vuferi

- Kontrolloni nëse nën-vuferi është lidhur mirë dhe saktë.
- Sigurohuni që e keni ndezur nën-vuferin.

Nga një pajisje specifike nuk del asnjë zë.

- Kontrolloni nëse pajisja është lidhur saktë me foletë e hyrjes audio për atë pajisje.
- Kontrolloni nëse kabllo e përdorura për lidhjen janë futur plotësisht në foletë e marrësit dhe të pajisjes.
- Vendoseni INPUT MODE në „AUTO“ (faqe 72).

Hyrja HDMI

- Kur përdoret „2ch Analog Direct“ nuk ka dalje të zërit. Përdorni fushë tjetër zanore (faqe 56).
- Kontrolloni lidhjen e HDMI (faqe 28, 30, 31, 33).
- Kontrolloni nëse kablloja HDMI që po përdorni ka një logo HDMI të autorizuar nga HDMI Licensing LLC.

- Në varësi nga lloji i pajisjes luajtëse, mund të jetë e nevojshme që pajisjet të konfigurohen. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjet.
- Sigurohuni të përdorni një kablo bashkuese për folenë HDMI që përputhet me kabllo High Speed HDMI kur shihni figura ose të dëgjoni zërin gjatë një transmetimi 1080p, Deep Color ose gjatë transmetimeve 3D ose 4K.
- Nga marrësi mund të mos dalë fare zë kur në ekranin e televizorit shfaqet GUI. Shtypni HOME për ta çaktivizuar GUI.
- Sinjalet audio (formati, frekuenca e modulimit, numri i bitëve, etj.) që transmetohen nga një fole HDMI mund të ngjishen nga pajisja e lidhur. Kontrolloni konfigurimin e pajisjes së lidhur nëse cilësia e figurës është e dobët ose nëse zëri nuk del fare nga një pajisje e lidhur nëpërmjet kabllos HDMI.
- Kur pajisja e lidhur nuk përputhet me teknologjinë mbrojtëse të së drejtës së autorit (HDCP), figura dhe/ose zëri që del nga foleja HDMI OUT mund të shtrembërohet ose mund të ketë fare dalje të tyre. Në këtë rast, verifikoni specifikimet e pajisjes së lidhur.
- Vendoseni rezolucionin e figurës në luajtës më të madh se 720p/1080i për audio me shpejtësi të lartë transmetimi (DTS-HD Master Audio, Dolby TrueHD).
- Rezolucioni i figurës në luajtës mund të ketë nevojë që të bëhen disa cilësime përpara se të keni DSD dhe PCM lineare shumëkanalëshe. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të luajtësit.
- Sigurohuni që televizori është i përputhshëm me funksionin Kontrolli i audios së sistemit.
- Nëse televizori nuk e ka funksionin Kontrolli i audios së sistemit, vendosini cilësimet „Audio Out“ në menynë HDMI Settings te
 - „TV+AMP“ nëse dëshironi që ta dëgjoni zërin nga altoparlanti i televizorit dhe nga marrësi.

- „AMP“ nëse dëshironi që ta dëgjoni zërin nga marrësi. Kur e lidhni marrësin me një pajisje videoje (projektor etj.), zëri mund të mos dalë nga marrësi. Në këtë rast zgjidhni „AMP“.
- Nuk mund të dëgjoni zërin e një pajisjeje të lidhur me marrësin, kur në marrës është zgjedhur si burim hyrjeje një televizor.
 - Sigurohuni që ta ndryshoni në HDMI burimin e hyrjes në marrës kur dëshironi të shikoni një program në një pajisje të lidhur me marrësin.
 - Ndryshoni kanalën e televizorit kur dëshironi të shikoni një transmetim televiziv.
 - Sigurohuni të zgjidhni burimin e saktë të hyrjes ose pajisjen që dëshironi kur shikoni një program nga një pajisje e lidhur me televizorin.
- Kur përdorni funksionin Control for HDMI, nuk mund të komandoni pajisjen e lidhur me anë të telekomandës së televizorit.
 - Në varësi nga pajisja e lidhur dhe televizori, mund të nevojitet konfigurimi i cilësimit HDMI i pajisjes dhe i televizorit. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me pajisjet dhe televizorin.
 - Ndryshoni burimin e hyrjes së marrësit në hyrjen HDMI të lidhur me pajisjen.

Hyrja koaksiale/optike

- Kur përdoret „2ch Analog Direct“ nuk ka dalje të zërit. Përdorni fushë tjetër zanore (faqe 56).
- Kontrolloni INPUT MODE (faqe 72).
- Kontrolloni për t'u siguruar që fisha e zgjedhur e hyrjes së audios (dixhitale) nuk u është caktuar edhe hyrjeve të tjera te „Audio Input Assign“ në menynë Input Settings (faqe 73).

Hyrja analoge 2 kanalëshe

- Kontrolloni për t'u siguruar që fisha e zgjedhur e hyrjes së audios (analoge) nuk i është caktuar edhe hyrjeve të tjera te „Audio Input Assign“ në menynë Input Settings (faqe 73).

Zëri majtas dhe djathtas nuk është i ekuilibruar ose është në të kundërt.

- Kontrolloni nëse altoparantët dhe pajisjet janë lidhur saktë.
- Rregulloni parametrat e ekuilibrit me anë të „Speaker Setup“ në menynë Speaker Settings.
- Rregulloni nivelin e altoparantëve.

Tingulli shumëkanalësh Dolby Digital ose DTS nuk riprodhohet.

- Verifikoni nëse DVD-ja etj. që po luani është e regjistruar në format Dolby Digital ose DTS.
- Kur lidhni luajtësin DVD etj., në foletë e hyrjes dixhitale të këtij marrësi, sigurohuni për cilësimin e daljes së audios dixhitale në pajisjen e lidhur.
- High Bitrate Audio (DTS-HD Master Audio, Dolby TrueHD), DSD dhe PCM lineare shumëkanalëshe mund t'i përdorni vetëm me lidhje HDMI.

Nuk ka dalje të tingullit shumëkanalësh.

- Kur „Control for HDMI“ është vendosur te „On“, „Audio Out“ mund të vendoset automatikisht në „AMP“. Në këtë rast, vendoseni „Audio Out“ te „AMP“.

Nuk arrihet efekti i tingullit rrethues.

- Sigurohuni që funksioni i fushës zanore është i aktivizuar (shtypni MOVIE/HD-D.C.S. ose MUSIC).
- „PLII (Movie/Music)“, „PLIIX (Movie/Music)“, „PLIIZ Height“ dhe „Neo:6 (Cinema/Music)“ nuk funksionojnë kur modeli i altoparantëve është caktuar në 2/0 ose 2/0.1.

Regjistrimi nuk mund të kryhet.

- Kontrolloni nëse pajisja është lidhur saktë (faqe 35).
- Zgjidhni pajisjen e burimit (faqe 46).
- Sinjalet hyrëse audio që hyjnë nëpërmjet foleve HDMI IN nuk mund të regjistrohen.

- Kontrolloni lidhjen e anës së regjistrimit sipas sinjaleve audio që dëshironi të regjistroni. Sinjalet hyrëse analoge mund të nxirren vetëm nga foletë dalëse analoge.

Nga altoparantët nuk ka dalje të tingullit të testimit.

- Kabllot e altoparantëve mund të mos jenë lidhur mirë. Kontrolloni për të parë nëse ato janë lidhur mirë dhe nuk mund të shkëputen nëse tërhiqen lehtë.
- Kabllot e altoparantëve mund të kenë problem lidhjeje me qark të shkurtër.


Tingulli i testimit del nga një altoparant tjetër i ndryshëm nga ai i treguar në ekran.

- Konfigurimi i altoparantëve nuk është i saktë. Sigurohuni që ka një përputhje të saktë të lidhjeve të altoparantëve dhe konfigurimit të tyre.

Sintonizuesi

Marrja e sinjalit FM është e dobët.

- Përdorni një kabllo koaksiale 75-om (nuk jepet) për të lidhur marrësin me një antenë FM të jashtme (ajrore) siç tregohet më poshtë.



Stacionet e radios nuk mund të sintonizohen.

- Kontrolloni që antenat (ajrore) të jenë lidhur mirë. Rregulloni antenat (ajrore) dhe lidhni një antenë të jashtme (ajrore) nëse është e nevojshme.
- Fuqia e sinjalit të stacioneve është tepër e dobët me sintonizimin automatik. Përdorni sintonizimin direkt.

- Nuk është vendosur asnjë stacion ose stacionet e paravendosura janë fshirë (kur përdoret sintonizimi duke skanuar stacionet e paravendosura). Bëni vendosjen e stacioneve të paracaktuara (faqe 54).
- Shtypni DISPLAY MODE në marrës në mënyrë që në dritaren e afishimit të shfaqet frekuenca.

RDS nuk funksionon.

- Sigurohuni që jeni të sintonizuar në një kanal FM RDS.
- Zgjidhni një stacion FM më të fortë.
- Stacioni ku jeni sintonizuar nuk po transmeton sinjal RDS ose fuqia e sinjalit është e dobët.

Informacioni RDS që dëshironi nuk shfaqet.

- Kontaktoni me stacionin e radios dhe informohuni nëse e ofrojnë ose jo shërbimin në fjalë. Nëse po, shërbimi mund të jetë përkohësisht i padisponueshëm.

Pajisja USB

Pajisja USB nuk njihet.

- Fikeni marrësin dhe pastaj shkëputni pajisjen USB. Ndizeni përsëri marrësin dhe pastaj rilidhni pajisjen USB.
- Lidhni një pajisje USB që mbështetet.
- Pajisja USB nuk punon si duhet. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjes USB për mënyrat sesi ta zgjidhni këtë problem.

Përmbytja në pajisjen USB nuk afishohet.

- Hierarkia e dosjeve i ka kaluar 4 nivele. Marrësi mund të afishojë përmbytje vetëm deri në 4 nivele (përfshirë dosjen „ROOT“). Megjithatë, dosjet brenda një dosjeje me 4 nivele nuk mund të afishohen.

Nuk ka fare dalje të zërit.

- Fikeni marrësin dhe pastaj shkëputni pajisjen USB. Ndizeni përsëri marrësin dhe pastaj rilidhni pajisjen USB.
- Lidhni një pajisje USB që mbështetet.
- Shtypni ► për të nisur luajtjen.
- Kur përdoret „2ch Analog Direct“ nuk ka dalje të zërit. Përdorni fushë tjetër zanore (faqe 56).
- Vetë të dhënat e muzikës kanë zhurmë ose zëri është i shtrembëruar.
- Në varësi nga formati i skedarit, mund të ketë skedarë që ndonjëherë nuk mund të luhen. Për hollësi shihni „Rrjet/USB“ (faqe 21).
- Pajisjet USB të formatuara me sisteme skedarësh të ndryshëm nga FAT12/16/32, VFAT ose NTFS nuk mbështeten.*
- Nëse përdorni një pajisje USB të ndarë në disa particione, mund të luhen vetëm skedarët audio në ndarjen e parë.
- Luajtja është e mundur deri në 4 nivele (përfshirë dosjen „ROOT“).
- Numri i skedarëve brenda një dosjeje i ka kaluar 500 copë (përfshirë dosjet).
- Skedarët e enkriptuar ose të mbrojtur me fjalëkalime, etj. nuk mund të luhen.
- Nëse luani skedarë muzike të ruajtur në WALKMAN me anë të marrësit, lëvizini skedarët në WALKMAN nga kompjuteri me anë të funksionit „zvarrit dhe lësho“ dhe pastaj ruajini në WALKMAN në një format që mbështetet nga marrësi (p.sh., MP3).

* Ky marrës mbështet sistemet e skedarëve FAT12/16/32, VFAT, ose NTFS, por disa pajisje USB mund të mos i mbështetin të gjitha këto sisteme skedarësh.

Për hollësi, drejtojuni udhëzimeve të përdorimit të çdo pajisjeje USB ose kontaktoni me prodhuesin.

Pajisja USB nuk mund të lidhet në folenë (USB).

- Pajisja USB është lidhur me pjesën e sipërme të kthyer mbrapsht. Lidhjeni pajisjen USB drejtimin e duhur.

Afishim i gabuar.

- Të dhënat e ruajtura në pajisjen USB mund të jenë të dëmtuara.
 - Kodet e karaktereve që mund të shfaqen nga ky marrës janë si më poshtë:
 - Shkronjat e mëdha (A deri në Z)
 - Shkronjat e vogla (a deri në z)
 - Numrat (0 deri në 9)
 - Simbolet (' < > * + , - . / @ [\] _ ')
- Karakteret e tjera mund të mos shfaqen saktë.

Duhet shumë kohë përpara se të fillojë luajtja.

- Procesi i leximit mund të kërkojë një kohë të gjatë në rastet e mëposhtme.
 - Kur në pajisjen USB ka shumë dosje ose skedarë.
 - Kur struktura e skedarëve është jashtëzakonisht e ndërlikuar.
 - Kur kapaciteti i memories është shumë i madh.
 - Kur memoria e brendshme është e fragmentuar.
- Për këtë arsye rekomandojmë ndjekjen e udhëzimit.
- Nr. total i skedarëve për dosje: 500 ose më pak

iPod/iPhone

iPod/iPhone nuk mund të ngarkohet.

- Kontrolloni nëse marrësi është i ndezur.
- Sigurohuni që iPod/iPhone është lidhur mirë.

iPod/iPhone nuk mund të përdoret.

- Kontrolloni nëse e keni hequr kasën mbrojtëse të iPod/iPhone.
- Në varësi nga përmbajtjet në iPod/iPhone, mund të duhet pak kohë derisa të fillojë luajtja.
- Fikeni marrësin dhe pastaj shkëputeni iPod/iPhone. Ndizeni përsëri marrësin dhe pastaj rilidhni iPod/iPhone.

- Po përdorni një iPod/iPhone që nuk mbështetet. Shihni „Prodhuar për modelet iPod/iPhone“ (faqe 48) për llojet e pajisjeve që mbështeten.

Volumi i zileve të iPhone nuk ndryshohet.

- Rregullojeni volumin e zileve me anë të komandave në iPhone.

Rrjeti

Nuk mund të lidhet me rrjetin.

- Kontrolloni lidhjen me rrjetin (faqe 39) dhe menynë Network Settings (faqe 98).
- Kontrolloni për të parë nëse është e aktivizuar foleja që dëshironi të përdorni për të lidhur sistemin në një rrjet.

Nuk mund të gjëjë serverin.

- Kërkoni për serverin me anë të „Connection Server Settings“ në menynë Network Settings (faqe 98).
- Kontrolloni si më poshtë:
 - A është i ndezur ruteri?
 - Nëse ka ndonjë pajisje tjetër midis marrësit dhe ruterit kontrolloni nëse ajo pajisje është e ndezur.
 - A janë lidhur mirë dhe saktë të gjitha kabllo?
 - A janë cilësimet të tilla që garantojnë përputhjen me cilësimet e ruterit (DHCP ose adresa IP fikse)?
- Kur përdorni një kompjuter kontrolloni cilësimet e mëposhtme:
 - Cilësimet e murit mbrojtës të integruar të sistemit operativ të kompjuterit.
 - Cilësimet e murit mbrojtës të softuerit të sigurisë. Për të parë cilësimet e murit mbrojtës të softuerit të sigurisë, shihni seksionin „Help“ të softuerit tuaj të sigurisë.
- Regjistroni marrësin me serverin. Për më shumë detaje drejtojeni udhëzimeve të përdorimit të dhëna me serverin.
- Pritni për pak çaste, pastaj provoni të lidheni përsëri me serverin.

Përmbytja në server nuk mund të gjendet ose nuk mund të luhet.

- Në pamjen e ekranit „My Music“, „My Photo“ dhe „My Video“, nga e gjithë përmbytja që ofrohet nga serveri brenda udhëzimeve DLNA, marrësi luan vetëm ato përmbytje që mund të luhen me të.
- Mund të ketë përmbytje që nuk mund të luhet ose të shfaqen, edhe nëse përmbytja është e përcaktuar në udhëzimet DLNA.

Nuk mund të hyhet në marrës nga „ES Remote“ ose nga komanduesi DLNA.

- Sigurohuni që komanduesi që dëshironi të përdorni është vendosur te „Allow“ në „Renderer Access Control“ (faqe 98).
- Nëse e vendosni „Auto Access Permission“ te „On“ në „Renderer Options“ (faqe 98), çdo komandues që zbulohet mund të vihet automatikisht në dispozicion.
- A jepet i renditur komanduesi i rrjetit te „Renderer Options“ dhe a është caktuar ai te „Allow“?

Nëse kutia nuk është e zgjedhur, zgjidhni kutinë për „Auto Access Permission“ dhe rikthehuni në menynë kryesore. Pastaj, komandojeni marrësin duke përdorur vetëm një herë komanduesin e rrjetit dhe çzgjidhni kutinë për „Auto Access Permission“, nëse nevojitet.
- Nëse komanduesi i rrjetit është një softuer komandues kompjuterik, a filtrohet ai nga softueri i antivirusit apo i murit mbrojtës? Lejoni komunikimet UPnP midis softuerit dhe marrësit. Për hollësi, drejtojeni udhëzimeve të përdorimit të softuerit të antivirusit, të murit mbrojtës ose të softuerit komandues të rrjetit.

Video nga interneti

Figura/zëri është i dobët/disa programe shfaqen me mungesë detajesh, veçanërisht gjatë skenave me lëvizje të shpejta ose skenave në errësirë.

- Cilësia e figurës/zërit mund të jetë e dobët, në varësi nga ofruesit e përmbajtjeve në internet.
- Cilësia e figurës/zërit mund të përmirësohet duke ndryshuar shpejtësinë e lidhjes. Sony rekomandon një shpejtësi lidhjeje prej të paktën 2,5 Mbps për video me definicion standard dhe 10 Mbps për video me definicion të lartë.
- Jo të gjitha videot kanë zë.

Figura është e vogël.

- Shtypni **▲** për ta zmadhuar.

Përmbajtja nuk mund të luhet.

- Disa përmbajtje interneti kërkojnë regjistrim përmes një kompjuteri përpara se ato të luhen.

„BRAVIA“ Sync (Control for HDMI)

„Control for HDMI“ nuk mund të vendoset te „On“.

- Vendoseni „Zone2 Out“ te „HDMI Settings“ në „Off“.

Funksioni Control for HDMI nuk funksionon.

- Kontrolloni lidhjen e HDMI (faqe 26, 28, 30, 31).
- Sigurohuni që „Control for HDMI“ është vendosur te „On“ në menynë HDMI Settings.
- Kur „Zone2 Out“ është e vendosur te „On“, funksioni Control for HDMI nuk funksionon.
- Sigurohuni që pajisja e i lidhur të jetë e përputhshme me funksionin Control for HDMI.

- Kontrolloni cilësimet e Control for HDMI në pajisjen e lidhur. Referojuni udhëzimeve të përdorimit të pajisjeve të lidhura.
- Nëse ndryshoni lidhjen HDMI, lidhni/shkëputni kordonin elektrik (të rrjetit elektrik) ose nëse ndodh ndërprerje e energjisë, përsëritni procedurat te „Përgatitja për „BRAVIA“ Sync“ (faqe 68).
- Kur zgjidhni „HDMI OUT B“ ose „OFF“, funksioni Control for HDMI nuk funksionon si duhet.
- Nëse zgjidhni „HDMI OUT A“ pasi keni zgjedhur „HDMI OUT B“ ose „OFF“, funksioni Control for HDMI mund të mos funksionojë si duhet për pak kohë. Kjo për arsyen sepse pajisjet e lidhura në fole të HDMI OUT A duhet ta rinjohin marrësin që është i pajisur me funksionin Control for HDMI. Nëse funksioni Control for HDMI nuk funksionon si duhet për një kohë të gjatë, zbatoni hapat e dhënë te „Përgatitja për „BRAVIA“ Sync“ (faqe 68).
- Llojet dhe numri i pajisjeve që mund të komandohen nga veçoria „BRAVIA“ Sync janë të kufizuara në standardin HDMI CEC si më poshtë.
 - Pajisje regjistruese (regjistrues Blu-ray Disc, regjistrues DVD, etj.): deri në 3 pajisje
 - Pajisje luajtëse (luajtës Blu-ray Disc Player, luajtës DVD, etj.): deri në 3 pajisje
 - Pajisjet e lidhura me sintonizuesin: deri në 4 pajisje (marrësi përdor një prej tyre për operacionet e veta GUI)
 - Sistemi audio (marrës AV): deri në 1 pajisje

Kur përpiqeni të përdorni funksionin One-Touch Play, burimi i hyrjes nuk kalon në atë që synohet.

- Kontrolloni për të parë nëse „Zone2 Out“ është vendosur te „Off“.

- Kontrolloni caktimin e hyrjes HDMI (faqe 73). Kur caktoni disa hyrje në të njëjtën fole hyrëse HDMI, nëse përdorni funksionin One-Touch Play në pajisjen e lidhur në hyrjen HDMI, në mënyrë preferenciale përzgjidhet hyrja që ju keni caktuar të fundit.

Audio Return Channel (ARC) nuk punon.

- Sigurohuni që „Control for HDMI“ është vendosur te „On“ në menynë HDMI Settings.
- Sigurohuni që INPUT MODE për „TV“ është vendosur te „AUTO“ (faqe 72).

Telekomanda

Telekomanda nuk funksionon.

- Drejtojeni telekomandën drejt sensorit të komandimit në marrës (faqe 10).
- Largoni çdo pengesë mes telekomandës dhe marrësit.
- Zëvendësoni të gjitha bateritë në telekomandë me të reja, nëse ato janë të shkarkuara.
- Kur filloni të përdorni marrësin, sigurohuni që fillimisht të shtypni AMP në telekomandë. Përndryshe, veprimet pasuese mund të mos jenë për marrësin. Më pas zgjidhni pajisjet që dëshironi të përdorni duke shtypur një nga butonat e hyrjes.
- Sigurohuni që modalitetet e komandave të marrësit dhe të telekomandës janë të njëjta. Nëse modaliteti i komandës së marrësit dhe telekomandës janë të ndryshme, nuk mund ta përdorni marrësin me anë të telekomandës (faqe 78).
- Sigurohuni që të zgjidhni hyrjen e saktë në telekomandë.

Nëse problemi vjen nga shkaqe të ndryshme nga rastet e përshkruara më lart dhe ai nuk zgjidhet edhe nëse pritni për pak kohë, kryeni një prej veprimeve të mëposhtme.

- Shtypni I/⏮ në telekomandë për ta fikur marrësin dhe pastaj ndizeni përsëri.
- Mbani shtypur I/⏮ në marrës derisa llamba mbi buton të pulsojë në ngjyrë të gjelbër për ta rindezur/rifilluar marrësin.

Mesazhet e gabimit

Mund ta kontrolloni statusin e marrësit nëpërmjet mesazhit. Shihni pikat në vijim për ta zgjidhur problemin. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

PROTECTOR

Marrësi është i mbuluar dhe vrimat e ajrimit janë bllokuar. Marrësi do të fiket automatikisht pas pak sekondash. Hiqni objektin që mbulon panelin e sipërm të marrësit dhe ndizeni sërish.

FAN STOPPED

Kontrolloni që vrima e ajrimit në pjesën e sipërme të marrësit të mos jetë e bllokuar.

Në ekranin e televizorit shfaqet „A new software version is available. Please go to the „Setup“ section of the menu and select „Network Update“ to perform the update.“

Shihni „Network Update“ (faqe 102) për ta përditësuar marrësin në një version më të ri të softuerit.

Video cannot be output from this jack.

- Nëse e përdorni marrësin në zonën kryesore, lidhni marrësin me televizorin nëpërmjet një kablloje HDMI.
- Nëse e lidhni marrësin me televizorin me anë të një kablloje videoje, vendoseni „Playback Resolution“ në „480i/576i“ (faqe 94).
- Nëse e lidhni marrësin me televizorin me anë të një kablloje videoje komponent, vendoseni „Playback Resolution“ në një parametër të përshatshëm për televizorin tuaj (faqe 94).

Lista e mesazheve pas matjes Auto Calibration

Ekрани	Shpjegimi
Code 30	Kufjet janë lidhur. Hiqni kufjet dhe kryeni përsëri kalibrimin automatik.
Code 31	SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) është vendosur te OFF. Vendoseni në cilësimet e altoparlantëve të tjerë dhe ribëni matjen.
Code 32	Nuk është zbuluar asnjë prej altoparlantëve. Sigurohuni që fisha e mikrofonit të optimizuesit është futur plotësisht në folenë AUTO CAL MIC dhe pastaj përsëritni përsëri funksionin Auto Calibration.
Code 33	- Nuk është lidhur asnjë nga altoparlantët përballë ose është lidhur vetëm një altoparlant përballë. - Mikrofoni i optimizuesit nuk është lidhur. Sigurohuni që fisha e mikrofonit të optimizuesit është futur plotësisht në folenë AUTO CAL MIC dhe pastaj përsëritni përsëri funksionin Auto Calibration. - Altoparlanti rrethues majtas ose djathtas nuk është lidhur. - Altoparlantët shumëkanalësh mbrapa janë lidhur edhe pse nuk është menduar lidhja e tyre. Lidhni altoparlantin(ët) shumëkanalësh në terminalet SURROUND. - Altoparlanti shumëkanalësh mbrapa lidhet vetëm në terminalet SURROUND BACK/ FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2 R. Kur lidhni vetëm një altoparlant shumëkanalësh mbrapa, lidhni atë në terminalet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ ZONE 2 L. - Është lidhur vetëm një altoparlant lart përballë. Lidhni altoparlantin lart përballë në një nga terminalet SURROUND BACK/FRONT HIGH/FRONT B/ZONE 2. - Altoparlantët e përparmë të lartë janë lidhur edhe pse nuk të lidhur altoparlantë rrethues. Lidhni altoparlantin(ët) rrethues në terminalet SURROUND.
Warning 40	Procesi i matjes ka përfunduar me zbulimin e një niveli të lartë zhurme. Mund të jeni në gjendje që të arrini rezultate më të mira nëse e provoni përsëri në një ambient të qetë.
Warning 41	Hyrja nga mikrofoni është shumë e madhe.
Warning 42	- Ai mund të jetë shumë afër distancës midis altoparlantit dhe mikrofonit. Provoni përsëri me matjen pasi t'i keni larguar nga njëri-tjetri. - Kur e përdorni marrësin si para-amplifikator, mund të shfaqet njëri prej mesazheve në varësi të amplifikatorit të fuqisë që lidhni. Megjithatë, nuk do të ketë asnjë problem edhe nëse vazhdoni ta përdorni marrësin pa bërë ndryshime.
Warning 43	Distanca dhe pozicioni i nën-vuferit nuk mund të zbulohet. Ose nuk mund të zbulohet këndi i pozicionit të altoparlantit. Kjo mund të shkaktohet nga zhurma. Provoni ta kryeni matjen në një ambient të qetë.
NO WARNING	Nuk ka asnjë informacion paralajmërues.

Pastrimi i memories

Seksionet e referencave

Për të pastruar	Shihni
Të gjitha cilësimet e memorizuara	faqe 81
Memorien e telekomandës me shumë funksione	faqe 115

Rindezja e marrësit

Nëse butonat në marrës ose në telekomandë nuk funksionojnë për shkak të një keqfunksionimi në marrës, rindizeni marrësin.

Mbani shtypur I/⏻ për 10 sekonda.
Kur llamba mbi I/⏻ pulson në ngjyrë të gjelbër, nis rindezja.

Rreth informacionit për mbështetjen

Për hollësi rreth informacioneve më të fundit për marrësin vizitoni faqen e mëposhtme të internetit.
<http://support.sony-europe.com>

Specifikimet

Seksioni i amplifikatorit

FUQIA NË DALJE^{1) 2)}

Fuqia e vlerësuar në dalje në modalitetin stereo
(8 om 20 Hz – 20 kHz,
THD 0,09%):
100 W + 100 W

Fuqia referencë në dalje
(8 om 1 kHz, THD 0,7%)
FRONT:
110 W + 110 W
CENTER: 110 W
SURROUND:
110 W + 110 W
SURROUND BACK:
110 W + 110 W

- ¹⁾ Matur sipas kushteve të mëposhtme:
Kërkesat e ushqimit elektrik: 230 V AC, 50/60 Hz
- ²⁾ Në varësi të cilësimeve të fushës zanore dhe të burimit, mund të mos ketë fare dalje të zërit.

Reagimi në frekuencë³⁾

SA-CD/CD, TV,	10 Hz – 100 kHz
VIDEO 1/2, SAT/CATV	± 3 dB

Hyrjet (Analoge)

SA-CD/CD, TV,	Ndjeshmëria: 150 mV
VIDEO 1/2, SAT/CATV	Rezistenca: 50 kilo om S/N ³⁾ : 105 dB (A, 20 kHz LPF, 500 mV)

- ³⁾ Kur përdoret „2ch Analog Direct“.

Hyrjet (Dixhitale)

IN 1 (DVD) (Koaksiale)	Rezistenca: 75 om S/N: 96 dB (A, 20 kHz LPF)
IN 1 (SAT/CATV), IN 2 (TV) (Optik)	S/N: 96 dB (A, 20 kHz LPF)

Daljet

VIDEO 1, ZONE 2, (AUDIO OUT)	Tensioni: 150 mV Rezistenca: 1 kilo om
SUBWOOFER	Tensioni: 2 V Rezistenca: 1 kilo om

Seksioni i sintonizuesit FM

Diapazoni i sintonizimit

87,5 MHz – 108,0 MHz

Antena (ajrore) Antena FM me tel (ajrore)

Terminalet e antenës (ajrore)

75 om, të pabalancuara

Seksioni i sintonizuesit AM

Shkalla e sintonizimit

9 kHz hap

Diapazoni i sintonizimit

531 kHz – 1.602 kHz

Antena (ajrore) Antena në formë kornize
(ajrore)**Seksioni i videos**

Hyrjet/daljet

Video: 1 Vp-p, 75 om

COMPONENT VIDEO:

Y: 1 Vp-p, 75 om

 P_B : 0,7 Vp-p, 75 om P_R : 0,7 Vp-p, 75 om

80 MHz HD Pass Through

HDMI Video

Hyrja/dalja (HDMI Blloku i repetitorit)

Formati	2D	3D		
		Frame packing	Side-by-Side (Gjysmë)	Over-Under (Lart-dhe-poshtë)
4096 × 2160p @ 23,98/24 Hz	○	–	–	–
3840 × 2160p @ 29,97/30 Hz	○	–	–	–
3840 × 2160p @ 25 Hz	○	–	–	–
3840 × 2160p @ 23,98/24 Hz	○	–	–	–
1920 × 1080p @ 59,94/60 Hz	○	–	○	○
1920 × 1080p @ 50 Hz	○	–	○	○
1920 × 1080p @ 29,97/30 Hz	○	○	○	○
1920 × 1080p @ 25 Hz	○	○	○	○
1920 × 1080p @ 23,98/24 Hz	○	○	○	○
1920 × 1080i @ 59,94/60 Hz	○	○	○	○
1920 × 1080i @ 50 Hz	○	○	○	○
1280 × 720p @ 59,94/60 Hz	○	○	○	○
1280 × 720p @ 50 Hz	○	○	○	○
1280 × 720p @ 29,97/30 Hz	○	○	○	○
1280 × 720p @ 23,98/24 Hz	○	○	○	○
720 × 480p @ 59,94/60 Hz	○	–	–	–
720 × 576p @ 50 Hz	○	–	–	–
640 × 480p @ 59,94/60 Hz	○	–	–	–

Të përgjithshme

Kërkesat e ushqimit elektrik

230 V AC, 50/60 Hz

Konsumi i energjisë 290 W

Konsumi i energjisë (gjatë modalitetit të gatishmërisë)

0,5 W (Kur „Control for HDMI“ (faqe 96), „Pass Through“ (faqe 96), „Network Standby“ (faqe 98), dhe „RS232C Control“ (faqe 102) janë vendosur te „Off“ dhe energjia për zonën 2 është fikur).

Përmasat

430 mm × 162 mm × 383 mm
(gjerësia/lartësia/thellësia)
përfshirë pjesët e dala dhe kontrollet

Pesha (e përafërt)

12,7 kg

Aksesorët e dhënë

Udhëzimet e përdorimit (ky manual)

Udhëzuesi i shpejtë i konfigurimit (1)

Mikrofoni i optimizuesit ECM-AC2 (1)

Antena FM me tel (ajrore) (1)

Antena AM në formë kornize (ajrore) (1)

Kordoni elektrik (për rrjetin elektrik) (1)

Telekomanda (1)

Bateritë R6 (madhësia AA) (2)

Dizajni dhe specifikimet i nënshtrohen ndryshimit pa dhënë njoftim.

Indeksi

Identifikuesit numerikë

12V Trigger 100
2 kanale 56
2ch Analog Direct 56
2ch Stereo (mode) 56
3D Output Settings 95
5.1-kanalëshe 22
7.1-kanalëshe 22

A

A.F.D. (modaliteti) 57
A/V Sync 91
Alto 61
AM 52
Antenë (ajrore) 38
Audio Input Assign 73, 97
Audio Out 95
Audio Return Channel (ARC) 70, 72
Audio Settings 89
Auto Calibration 85
Auto Calibration Setup 85
Auto Standby 101
Automatic Phase Matching 86

B

Bas 61
Berlin Philharmonic Hall 59

C

Calibration Type 86
Center Speaker Lift Up 87
Concertgebouw Amsterdam 59
Connection Server Settings 98
Control for HDMI 96
Crossover Frequency 88

D

D.C.A.C. (Digital Cinema Auto
Calibration) 85
Decode Priority 91
Dekodues kabllor 31
Digital Legato Linear (D.L.L.) 89
Direct Tuning 53
Distance Unit 89
DLNA 49
Dual Mono 90
Dynamic Range Compressor 90

E

Easy Automation 76
Easy Setup 41, 85
Ekрани 11, 104
Equalizer 61, 90
ES Remote 76
External Control 98

F

Fast View 96
Favorites 45
Film 57
FM 52
FM Mode 53
Foletë VIDEO 2 IN 33

G

GUI (Graphical User Interface) 26, 44

H

HD-D.C.S. 57
HD-D.C.S. (Lloji i efektit) 58
HDMI Settings 95
Heshtja 46
Home Theater Control 70

I

Initialize Personal Information 102
Input Edit 97
INPUT MODE 72
Input Settings 97
Internet Services Settings 99
Internet Settings 98
Internet Video Parental Control 99
Internet Video Unrated 99
IP Content Noise Reduction 52
iPod/iPhone 48

J

Jazz Club 59

K

Kamerë-regjistrues 33
Kohëmatësi i fjetjes 78
Kontrolli i sistemit audio 69
Konvertim me rritje rezolucioni 19
Kordoni elektrik (rrjeti elektrik) 40

L

Language 101
Large 87
LFE (Efekti i frekuencës së ulët) 12
Lidhja me dy amplifikatorë 80
Lidhjet
 altoparlantët 24
 antenë (ajrore) 38
 monitori 26
 pajisjet audio 35
 pajisjet video 28
 Rrjeti 39
Line Out 65, 100
Listen 46
Live Concert 59
Luajtës Blu-ray Disc 28
Luajtës CD 35
Luajtës DVD 28
Luajtës Super Audio CD 35

LI

Lloji i efektit 58

M

MASTER VOLUME 10, 46
Materiale nga interneti 51
Menyja 45, 82
Menyja e cilësimeve 82
Mesazhet
 Auto Calibration 127
 Gabimi 126
Motivi i altoparlantëve 86
Multi Zone 62
Music 59
Musikverein Vienna 59

N

Name In 86
Name Input 54
Ndryshimi i afishimit 109
Neo:6 (Cinema) 57
Neo:6 (Music) 59
Network Settings 98
Network Standby 98
Network Update 102

O

One-Touch Play 69

P

Parental Control Area Code 99
Parental Control Password 99
Pass Through 71, 96
Pastrimi
 marrësi 81
 telekomanda 115
Phase Audio 89
Phase Noise 88
PHONES 10
Playback Resolution 94
PlayStation 3 30
PLII (Movie) 57
PLII (Music) 59
PLIIx (Movie) 57
PLIIx (Music) 59
PLIIz Height 57, 59, 60
Portable Audio 59
Position 85
Priority 96
PROTECTOR 126

R

Regjistrimi 78
Renderer Access Control 98
Renderer Options 98
Resolution 92
Rivendosja
 marrësi 81
 telekomanda 115
RS232C Control 102

S

Scene Select 70
Screen Format 95
Serveri
 Përgatitja 44
Settings 82
Settings Lock 101
Sintonizimi 53, 54
Sintonizimi automatik 53
Sintonizues satelitor 31
Small 88
Software License 102
Software Update Notification 102
Sound Effects 56
Sound Field 56, 91

Sound Optimizer 60, 89
Speaker Connection 86
Speaker Settings 85
Speaker Setup 87
SPEAKERS (OFF/A/B/A+B) 10, 42
Sports 59
Stacionet e paravendosura 54
Stadium 59
Subwoofer Level 95
Subwoofer Low Pass Filter 90
Subwoofer Muting 90
Surround Back Assign 86
System Information 102
System Power-Off 69
System Settings 101
SYSTEM STANDBY 111

T

Telekomanda 15–17, 41, 110–115
Test Tone 88
TONE MODE 10, 81
TV Type 95

U

USB 47

V

VCR 32
Video Input Assign 73, 97
Video nga interneti 51
Video Settings 92

W

WALKMAN 47
Watch 46

Z

Zone Control 100
Zone Settings 100
Zone Setup 100
Zone2 Out 96

<http://www.sony.net/>

©2013 Sony Corporation



* 4 4 2 9 1 1 3 3 1 * (3)